

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07  
**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon  
**Parashtrues:** Prokurori i Specializuar  
**Data:** 27 gusht 2021  
**Gjuha:** Anglishte  
**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i redaktuar publik i**

**‘Dosjes paraprake të Prokurorit të Specializuar në çështjen kundër**

**Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT’**

---

**Zyra e Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hysni Gucatit**

Xhonatan Elistan Ris

**Mbrojtësit të Nasim Haradinajt**

Tobi Kadman

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

## Përmbajtja

I. Hyrje .....	3
II. Paraqitje e fakteve.....	6
A. Konferenca e parë për shtyp dhe dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë .....	6
B. Ngjarjet që pasuan konferencën e parë për shtyp.....	9
C. Konferenca e dytë për shtyp dhe dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë .....	17
D. Ngjarjet që pasuan konferencën e dytë për shtyp.....	19
E. Konferenca e tretë për shtyp dhe dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë .....	28
F. Ngjarjet që pasuan konferencën e tretë për shtyp.....	32
III. Të akuzuarit kryen veprat penale të përshkruara në Aktakuzë.....	39
A. Të akuzuarit, me anë të kërcënimit të rëndë, penguan personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Pika 1).....	39
B. Duke vepruar bashkërisht në një grup, të akuzuarit penguan personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Pika 2) .....	61
C. Të akuzuarit frikësuan dëshmitarët gjatë procedurës penale (Pika 3) .....	64
D. Të akuzuarit kryen hakmarrje kundër dëshmitarëve (Pika 4) .....	67
E. Përmes nxjerrjes së paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare, të akuzuarit shkelën fshehtësinë e procedurave ligjore (Pika 5) .....	70
F. Përmes nxjerrjes së paautorizuar të identiteteve dhe të të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, të akuzuarit shkelën fshehtësinë e procedurave (Pika 6) .....	71
IV. Të akuzuarit mbajnë përgjegjësi penale individuale për veprimet e tyre.....	74
A. Të akuzuarit i kryen veprat penale .....	74
B. Të akuzuarit tentuan të kryenin veprat penale .....	74
C. Të akuzuarit i kryen veprat penale bashkërisht .....	74
D. Të akuzuarit ranë në marrëveshje për kryerjen e veprave penale .....	78
E. Të akuzuarit nxitën kryerjen e veprave penale .....	79
F. Të akuzuarit ndihmuan në kryerjen e veprave penale.....	80
V. Përfundim .....	80

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

## I. Hyrje

1. Më 7 shtator 2020, një person i paidentifikuar dorëzoi në selinë e Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL- UÇK) në Prishtinë, dokumente që përmbanin informacion konfidencial dhe jopublik në lidhje me hetimet konfidenciale të Task Forcës Hetimore Speciale (TFHS) dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) (“Dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë”).

2. Hysni GUCATI dhe Nasim HARADINAJ (bashkërisht, “të akuzuarit”), përkatësisht në cilësinë e kryetarit dhe nënkryetarit të OVL-UÇK-së, i këqyrën dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë. Ata më pas thirrën aq përfaqësues të mediave sa mundën për një konferencë shtypi të transmetuar në televizion, gjatë së cilës ata zbuluan dhe shpërndanë informacionin konfidencial dhe jopublik që përmbanin dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë. Më vonë po atë ditë, GUCATI u doli në një program televiziv gjatë të cilit ai zbuloi informacione të tjera konfidenciale dhe jopublike nga dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë, duke i përshkruar personat e identifikuar si bashkëpunëtorë me Dhomat e Specializuara (DHS) si tradhtarë dhe gënjeshtarë.

3. Më 8 shtator 2020, në selinë e OVL-UÇK-së u dorëzua një urdhër gjyqësor i cili, ndër të tjera, ndalonte GUCATIN dhe OVL-UÇK-në që të shpërndanin dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë dhe përmbajtjen e tyre. Të akuzuarit e shpërfillën këtë urdhër.

4. Në fakt, kur persona të paidentifikuar dorëzuan dokumente të tjera në selinë e OVL-UÇK-së më 16 dhe 22 shtator 2020, të akuzuarit përsëritën të njëjtat veprime të paligjshme për herë të dytë, dhe më pas, për herë të tretë.

5. Në veçanti, siç përshkruhet më poshtë, për një periudhë prej 19 ditësh, me anë të tre konferencave për shtyp, paraqitjeve në mbi pesëmbëdhjetë programe televizive

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

dhe postimeve të shumta në mediat sociale, të akuzuarit dhe disa persona të tjerë (“ndihmësit”), shpërndanë pa autorizim informacion konfidencial dhe jopublik që kishte lidhje me hetimet e TFHS-së dhe ZPS-së, inkurajuan të tjerë të shpërndanin më tej informacion konfidencial dhe jopublik dhe ndërmorën veprime të tjera për qëllimin e deklaruar të pengimit të punës së DHS-së/ZPS-së. Ky informacion konfidencial dhe jopublik përfshinte dokumente të shënuara si “konfidenciale” dhe emra, [REDAKTUAR] dëshmitarëve,<sup>1</sup> [REDAKTUAR].

6. Të akuzuarit organizuan dhe bashkërenduan shpërndarjen e paautorizuar të informacionit dhe veprime të tjera në lidhje me të, ndër të tjera përmes këqyrjes, me ndihmësit e tyre, të informacionit konfidencial dhe jopublik, pjesëmarrjes në vendime nëse dhe si të shpërndahej ai informacion, dhe organizimit e pjesëmarrjes në ngjarje në lidhje me të, duke përfshirë konferenca për shtyp dhe paraqitje publike në të cilat u shpërnda dhe diskutua publikisht informacioni konfidencial dhe jopublik dhe gjatë të cilave të akuzuarit denigruan dhe kërcënuan dëshmitarët.

7. Synimi i të akuzuarve për kryerjen e këtyre veprimeve të paligjshme shihet qartë, ndër të tjera, në deklaratat dhe veprimet e tyre midis datave 7 dhe 25 shtator 2020, si dhe gjatë viteve që u paraprijnë këtyre ngjarjeve, kur të akuzuarit ishin përpjekur haptas të pengonin punën e DHSK-së dhe ZPS-së dhe kishin këmbëngulur për shfuqizimin e tyre.

8. Provat do të vërtetojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se me veprimet e tyre ata kanë kryer veprat penale si vijon:

- a. **Pika 1: PENGIM TË PERSONAVE ZYRTARË NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARE**, me anë të kërcënimit të rëndë, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, **VEPËR PENALE KUNDËR RENDIT**

---

<sup>1</sup> Termi “dëshmitar” ose “dëshmitarë” në dosjen paraprake nënkupton të gjithë personat që ka gjasa të kenë informacion për një krim, kryesin e një krimi, ose për rrethana të rëndësishme që kanë lidhje me procedurat e DHSK-së. Shprehja “procedurat e DHSK-së” në dosjen paraprake i referohet procedurave zyrtare të DHSK-së, përfshirë hetimet e ZPS-së.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

PUBLIK, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 31, 32(1)-(3), 33, 35 dhe 401(1) dhe (5) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074 (2019) (KPK), dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;<sup>2</sup>

- b. **Pika 2: PENGIM TË PERSONAVE ZYRTARË NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARE**, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, VEPËR PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 32(1)-(3), 33, 35 dhe 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;
- c. **Pika 3: FRIKËSIM GJATË PROCEDURËS PENALE**, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 31, 32(1)-(3), 33, 35 dhe 387 të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;
- d. **Pika 4: HAKMARRJE**, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 31, 32(1)-(2), 33, 35 dhe 388(1) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;
- e. **Pika 5: SHKELJE TË FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS**, përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 31,

---

<sup>2</sup> Ligji nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, 3 gusht 2015 ("Ligji"). Nëse nuk përcaktohet ndryshe, kurdoherë që përmendet "neni" ose "nenet" fjala është për Ligjin.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

32(1)-(2), 33, 35 dhe 392(1) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;  
dhe

- f. **Pika 6: SHKELJE TË FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS**, përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, midis së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 31, 32(1)-(3), 33, 35, dhe 392(2)-(3) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

## II. Paraqitje e fakteve

### A. Konferenca e parë për shtyp dhe dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë

9. Më 7 shtator 2020, OVL-UÇK-së mbajti një konferencë për shtyp në të cilën GUCATI njoftoi se OVL e UÇK-së kishte lajme për mediat dhe publikun, përfshirë politikanët e Kosovës dhe Kuvendin e Kosovës (“Konferenca e parë për shtyp”).<sup>3</sup> GUCATI deklaroi se rreth orës 09:15 minuta të atij mëngjesi, në selinë e OVL-UÇK-së kishte mbërritur një pako me “afër 4000 dosje të Dhomave të Specializuara.”<sup>4</sup> Gjatë konferencës për shtyp, dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë ishin ekspozuar mbi një tavolinë.<sup>5</sup>

10. GUCATI më pas ia dha fjalën HARADINAJT, duke vënë në dukje se HARADINAJ i kishte analizuar dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë bashkë me “Fatonin”, duke e pasur fjalën për Faton KLINAKUN, dhe me të tjerë.<sup>6</sup> GUCATI sugjeroi që të pranishmit të fokusonin kamerat e tyre tek dokumentet, shpjegoi se

<sup>3</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.1; 081344-01, min.00:00:01-00:01:22; *Shih gjithashtu* 089984-02; 089984-02-TR-ET; 091925-01; 091925-02; 091925-03; 091925-04; 081926-02; 081926-04; 081979-14; 083991-01.

<sup>4</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.1; 081344-01, min.00:00:01-00:01:22.

<sup>5</sup> 081344-01; 089984-02.

<sup>6</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.1; 081344-01, min.00:00:01-00:06:30.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

HARADINAJ do t'i njoftonte të pranishmit për gjithçka që përmbanin dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë dhe ndenji aty gjatë kohës që HARADINAJ fliste.<sup>7</sup>

11. HARADINAJ deklaroi se ata kishin vënë re shumë gjëra në ato dokumente.<sup>8</sup> Ai deklaroi se OVL e UÇK-së ishte befasuar për të mirë nga marrja e dokumenteve sepse ato dëshmonin se ata të cilët kishin votuar për krijimin e Gjykatës ishin faqezinj renegatë dhe njerëzit më të dëmshëm që nuk ia duan të mirën Kosovës.<sup>9</sup> Ai deklaroi se katër kopje të dokumenteve ishin të disponueshme në konferencën për shtyp.<sup>10</sup> HARADINAJ tregoi dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë dhe deklaroi: “Këtu janë emnat e të gjithë dëshmitarëve që ata thonë se i kemi në mbrojtje. Të gjithëve”, duke theksuar se në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë përfshihen të gjitha “të dhënat sekrete” për dëshmitarët, me emra, mbiemra të shqiptarëve, romëve, serbëve, të çdo personi që ishte intervistuar dhe vendndodhja e intervistës, si edhe deklarata.<sup>11</sup>

12. Në veçanti, HARADINAJ deklaroi se: (i) dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë tregonin se [REDAKTUAR] kishin bashkëpunuar me ZPS-në;<sup>12</sup> (ii) dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë përmbanin një fletëthirrje për [REDAKTUAR], duke vënë në dukje vendin ku [REDAKTUAR] ka thënë se banon;<sup>13</sup> (iii) [REDAKTUAR], ishte kontaktuar dhe kishte bashkëpunuar, duke theksuar vendin ku [REDAKTUAR] banon tani sipas dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë;<sup>14</sup> (iv) kishte dokumente

<sup>7</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.1; 081344-01, min.00:00:01-00:06:30; *Shih gjithashtu* 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 5-8; 081344-01, min.00:13:21-00:14:32, 00:15:53-00:15:54 ku HARADINAJ dhe GUCATI ftojnë gjithashtu të pranishmit që të fokusojnë kamerat e tyre tek dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë.

<sup>8</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30.

<sup>9</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-2; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30.

<sup>10</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 2-3; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30; *Shih gjithashtu* 081979-05-TR-ET, f. 2-3; 081979-05, min.00:02:10-00:06:38; 081979-05-TR-ET, f. 6-8; 081979-05, min.00:14:21-00:17:28; SPOE00220724-00220752, f. SPOE00220748; SPOE00220724-SPOE00220752-ET, SPOE00220748.

<sup>11</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30.

<sup>12</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30.

<sup>13</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30.

<sup>14</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30; *Shih gjithashtu* 084015-084026, f.084016, para.10.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

që përmendnin [REDAKTUAR], duke treguar vendbanimin e tij;<sup>15</sup> (v) [REDAKTUAR] ishte biseduar, dhe jepej informacion për vendin e tij të punës;<sup>16</sup> dhe se (vi) [REDAKTUAR] kishte bashkëpunuar, duke përmendur punësimin e tij të mëparshëm.<sup>17</sup> [REDAKTUAR]. HARADINAJ vuri në dukje gjithashtu se në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë ishin emrat e shqiptarëve që ishin thirrur.<sup>18</sup>

13. HARADINAJ iu referua dokumenteve si “konfidenciale” dhe “top sekrete” dhe deklaroi se njerëzit e përmendur në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë tashmë duhet ta dinë “se janë emra të lexum dhe nuk po del këtu diçka që është dikush i fshehtë” sepse në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë jepen vendi i saktë, thirrja e saktë dhe deklaratat e dhëna.<sup>19</sup> HARADINAJ vuri në dukje se dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë përfshinin deklaratat e dhëna “[REDAKTUAR]”.<sup>20</sup> Duke iu referuar vetes dhe anëtarëve të tjerë të OVL-UÇK-së, HARADINAJ deklaroi se po dorëzonin dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë dhe se atyre iu duk se ishin të origjinalit.<sup>21</sup> Ai vuri sërish në dukje se dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë përfshinin deklarata që përmbanin emra, mbiemra, vendbanime të mëparshme e të tashme dhe disa numra telefoni e më tej pyeti: “si ju garantohet mbrojtja dëshmitarëve, kur këtu sot mund të lexon gjithkush”.<sup>22</sup> Gjithashtu, lidhur me dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë HARADINAJ më tej deklaroi se OVL e UÇK-së i kishte bërë ato publike që të dihen,

<sup>15</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30; *Shih gjithashtu* 084015-084026, f.084016, para.10.

<sup>16</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30; *Shih gjithashtu* 084015-084026, f.084016, para.10.

<sup>17</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30; *Shih gjithashtu* 084015-084026, f.084016, para.10.

<sup>18</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 2-3; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30.

<sup>19</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.3-4; 081344-01, min.00:06:31-00:09:09.

<sup>20</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 3-4; 081344-01, min.00:06:31-00:09:09.

<sup>21</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 4-5; 081344-01, min.00:09:43-00:11:21.

<sup>22</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 4-5; 081344-01, min.00:09:43-00:13:16.



KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

duke pyetur: “Pse mos të jua qesim?”<sup>23</sup> Ai deklaroi se pak e kishte dert punën e “dëshmitarëve të Hagës” duke shtuar se “me më vetë, unë kam qejf krejt me i qitë”.<sup>24</sup>

14. HARADINAJ tha gjithashtu se OVL-UÇK-ja do t’ia çonte një kopje të këtyre dokumenteve edhe “atyne faqezinjve” në parlament me qëllim që fëmijët e tyre ta dinin se për çfarë kishin votuar,<sup>25</sup> se ata do t’u jepnin atyre që ishin të pranishëm në konferencën e parë për shtyp kopje sa të donin dhe se të pranishmit mund të lexonin sa emra të donin në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë.<sup>26</sup> HARADINAJ u bëri thirrje të pranishmëve të merrnin një kopje të dokumenteve, duke thënë se do t’ua jepte të gjitha.<sup>27</sup>

15. HARADINAJ deklaroi se dokumentet dëshmuar se DHS-ja është selektive, raciste dhe është duke punuar me të njëjtët njerëz të cilët ishin në “aparatin e MILOSHEVIQIT”.<sup>28</sup> Ai shtoi se për OVL-UÇK-në, DHS-ja ishte “inekzistente” dhe se çmimin duhet ta paguajë kjo gjykatë.<sup>29</sup>

16. HARADINAJ pranoi se kishte qenë vendimi i tij, GUCATIT dhe i ndihmësve të tyre që dokumentet konfidenciale të bëheshin publike, duke deklaruar: “ne me pat dashtë si kishim bë publik hiç.”<sup>30</sup> Ai më pas inkurajoi të pranishmit me fjalët “këqyri emnat. Këqyri deklaratat!”<sup>31</sup>

### B. Ngjarjet që pasuan konferencën e parë për shtyp

17. Siç u parashikua nga HARADINAJ, shpërndarja e përmbajtjes së dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë nuk përfundoi me konferencën e parë për shtyp. Shpejt

<sup>23</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 4-5; 081344-01, min.00:09:43-00:13:16.

<sup>24</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.5; 081344-01, min.00:11:27-00:13:16.

<sup>25</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.3; 081344-01, min.00:06:31-00:09:09.

<sup>26</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 5-6; 081344-01, min.00:11:27-00:13:16.

<sup>27</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.6; 081344-01, min.00:13:21-00:14:41.

<sup>28</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30.

<sup>29</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 3-4, 6; 081344-01, min.00:06:31-00:09:09, 00:13:21-00:14:32.

<sup>30</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.8; 081344-01, min.00:16:02-00:16:11.

<sup>31</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.8; 081344-01, min.00:16:02-00:16:11.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

pas mbarimit të konferencës për shtyp, disa media kontaktuan ZPS-në me pyetje lidhur me dokumentet e nxjerra për herë të parë, duke vënë në dukje se, sipas OVL-UÇK-së, dokumentet në fjalë kishin rrjedhur nga DHS-ja dhe përfshinin emra të dëshmitarëve të mbrojtur.<sup>32</sup> Një numër artikujsh me lajme dhe videomateriale lidhur me dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë, të cilët i referoheshin gjerësisht përmbajtjes së tyre dhe që riprodhonin fotografi të tyre, dolën në Internet.<sup>33</sup> [REDAKTUAR].<sup>34</sup>

18. Gjatë një programi televiziv i cili u transmetua disa orë pas konferencës së parë për shtyp, lidhur me dokumentet, GUCATI deklaroi se ai dhe të tjerë nuk kishin mundur t'i shqyrtonin të gjitha dokumentet, por i kishin parë dhe u kishin dhënë një koje të dokumenteve KosovaPress-it dhe disa mediave.<sup>35</sup> Ai deklaroi se dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë përfshinin një letër të shkruar ku thuhej se në selinë e OVL-UÇK-së, do të silleshin mbi 7000 dosje.<sup>36</sup>

<sup>32</sup> 091909-091917 RED, ff.091909-091910, para. 2-5; 083999-083999; 091927-091930, ff.091929-091930, para. 14-20.

<sup>33</sup> *Shih* 081361-081378, f.081364-081368 (081364-081367-ET); 081361-081378, f. 081361-081363 (081361-081362-ET); 081915-081919, f. 081915-081916 (081914-081919-ET, f. 081915-081916); 081915-081919, f. 081917-081918 (081914-081919-ET, f. 081917-081918); 081915-081919, f.081919 (081914-081919-ET, f.081919); 081361-081378, f. 081369-081370 (081369-081370-ET); *Shih gjithashtu* 084015-084026, f. 084016-084018, para. 13-18; 081979-04-TR-ET, f.1; 081979-04. HARADINAJ postoi lidhje me këto artikuj dhe videomateriale në profilin e tij në Facebook, *shih* SPOE00220754-00220757, f.SPOE00220754; SPOE00220779-00220779 (SPOE00220779-SPOE00220779-ET Rishikuar); SPOE00220808-00220810; 081915-081919, f. 081917-081918 (081914-081919-ET, f. 081917-081918); SPOE00220754-00220757, f.SPOE00220755; SPOE00220780-SPOE00220780 (SPOE00220780-SPOE00220780-ET Rishikuar); SPOE00220811-00220812 (SPOE00220811-SPOE00220812-ET); SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220729 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220729); 081979-04-TR-ET, f.1; 081979-04. Pas konferencës së parë për shtyp, në media dolën artikuj ku theksohej se GUCATI kishte konfirmuar se dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë përmbanin emrat e dëshmitarëve të DHS-së, *shih* 081922-081926-ET, f. 081922, 081924; 081922-081925.

<sup>34</sup> 084015-084026, f.084017, para. 16-17, që i referohen 081915-081919, f. 081915-081916 (081914-081919-ET, f. 081915-081916), f. 081917-081919 (081914-081919-ET, f. 081917-081918).

<sup>35</sup> 081358-01-TR-ET, f. 6-13; 081358-01, min.01:01:00-01:02:33, 01:03:52-01:06:42, 01:07:54-01:10:49. Më 11 shtator 2020, gjatë një interviste në Skype të transmetuar në një program televiziv, HARADINAJ deklaroi se agjencia Kosova Press dhe shumë media të tjera kishin marrë kopje të dokumenteve, 081979-11-TR-ET Rishikuar, f. 3-4; 081979-11, min.00:07:17-00:09:17.

<sup>36</sup> 081358-01-TR-ET, f.4; 081358-01, min.00:57:54-00:59:42.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

19. GUCATI i tregoi kamerës televizive ekranin e telefonit të tij mobil dhe theksoi se ajo që ai po i tregonte kamerës lexonte se “Prokuroria Speciale ... pra Gjykata Speciale”, kërkon ndihmë nga Prokuroria e Serbisë për [REDAKTUAR].<sup>37</sup> [REDAKTUAR].

20. GUCATI deklaroi se në dokumente përmendeshin me emra një numër i madh njerëzish, ndër të cilët serbë, romë e turq dhe tregoi datën kur në [REDAKTUAR] ishte zhvilluar një intervistë, [REDAKTUAR] me një dëshmitar shqiptar, dhe se kishte edhe të tjerë që ishin intervistuar në [REDAKTUAR] dhe në [REDAKTUAR].<sup>38</sup> GUCATI deklaroi se ishte “e çuditshme” të shihte në dosje njerëz të cilët ai dhe të tjerët kishin besuar, që kishin bashkëpunuar me DHS-në, duke shtuar se ai besonte se disa prej dëshmitarëve e kishin bërë këtë për të fituar azil në Perëndim.<sup>39</sup> GUCATI i quajti personat e identifikuar në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë që bashkëpunonin me DHS-në si “shqipfolsa tradhtar t’kombit”<sup>40</sup> që gënjejnë, një term që ai e përdori për t’iu referuar personave që e kanë mbështetur Serbinë dhe vijnë ta bëjnë këtë, dhe të cilët nuk ia duan të mirën këtij vendi dhe UÇK-së,<sup>41</sup> të cilët ai i barazoi me tradhtarë<sup>42</sup>.

21. I pyetur nëse kishin bërë mirë që kishin shpërndarë dokumentet, GUCATI deklaroi se besonte se kishin bërë mirë, se kishin diskutuar me kryesinë dhe kishin folur me njerëz të tjerë.<sup>43</sup> Kur prezantuesi tha se mund të ndodhnin gjëra se në dokumente kishte emra, GUCATI u përgjigj se mund të ndodhnin gjëra.<sup>44</sup>

<sup>37</sup> 081358-01-TR-ET, f. 5-6; 081358-01, min.00:59:42-01:01:00.

<sup>38</sup> 081358-01-TR-ET, f. 6-7; 081358-01, min.01:01:00-01:03:52.

<sup>39</sup> 081358-01-TR-ET, f. 9-12; 081358-01, min.01:05:00-01:09:36; *Shih gjithashtu* 089185-06-TR-ET, f.1; 089185-06 min.08:01-08:54.

<sup>40</sup> 081358-01-TR-ET, f. 6-7, 12-13; 081358-01, min.01:01:00-01:02:33, 01:09:36-01:10:49; *Shih gjithashtu* 089185-06-TR-ET, f.1; 089185-06, min.08:01-08:54.

<sup>41</sup> 081358-01-TR-ET, f.6; 081358-01, min.01:01:00-01:02:33.

<sup>42</sup> 081358-01-TR-ET, f. 12-13; 081358-01, min.01:09:36-01:10:49.

<sup>43</sup> 081358-01-TR-ET, f.8; 081358-01, min.01:03:52-01:05:00.

<sup>44</sup> 081358-01-TR-ET, f. 8-9; 081358-01, min.01:03:52-01:05:00.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

22. Më 8 shtator 2020, në përputhje me një urdhër të DHS-së,<sup>45</sup> ZPS-ja sekuestroi dokumentet që ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë (“paketa 1”).<sup>46</sup> Pjesët përkatëse të urdhrin të parë iu lexuan KLINAKUT në anglisht e iu përkthyen në shqip, dhe atij iu dha një kopje e urdhrin të parë.<sup>47</sup>

23. Urdhri i parë i referohet, ndër të tjera, natyrës së ndjeshme të dokumenteve dhe rrezikut konkret që shpërndarja e tyre e mëtejshme nga GUCATI dhe/ose OVL-UÇK-së mund të rrezikonte sigurinë dhe mirëqenien e dëshmitarëve, si dhe integritetin e hetimeve të ZPS-së.<sup>48</sup> Në urdhrin e parë, Gjykatësi i Vetëm urdhëronte GUCATIN, OVL-UÇK-në dhe gjithë individët e tjerë që kishin në zotërim dokumente dhe/ose dinin përmbajtjen e tyre, që të mos kopjonin dhe shpërndanin më tej ato dokumente dhe përmbajtjen e tyre.<sup>49</sup>

24. Gjatë sekuestrimit, KLINAKU theksoi se dokumentet që iu dorëzuan ZPS-së ishin dokumente origjinale, të cilat ai pretendoi se persona të panjohur ia kishin dhënë OVL-UÇK-së një ditë më parë dhe se tri kopje të këtyre dokumenteve u ishin dhënë mediave, konkretisht KosovaPress-it, gazetës “Infokus” dhe kanalit televiziv T7.<sup>50</sup>

25. Paketa 1 përfshin kërkesa konfidenciale për ndihmë në hetimet penale (“kërkesat”) që TFHS-ja u kishte drejtuar autoriteteve kompetente serbe [REDAKTUAR], si edhe dokumente të autoriteteve serbe, ndër to edhe përgjigjet ndaj kërkesave (“dokumentet serbe”); si kërkesat, po ashtu edhe dokumentet serbe lidhen

---

<sup>45</sup> 091971-091980; 092028-092038 (“Urdhri i Parë”).

<sup>46</sup> 083988-083991 RED; 080449-080449; *Shih gjithashtu* 081926-03; 081979-13; KSC-BC-2020-07/F00008. Paketa 1 përmban gjithashtu një shënim të shkruar me dorë në shqip që përshkruan dorëzimin e paketës 1 ZPS-së më 8 shtator 2020 duke përmendur sekretarin Faton KLINAKU, si personin që dorëzoi dokumentet, 081340-081340 (081340-081340-ET); 091927-091930, f. 091927-091928, para. 8-10.

<sup>47</sup> 083988-083991 RED, f. 083988-083989, para. 3-6; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00008.

<sup>48</sup> 091971-091980, f.091979, para. 21; 092028-092038, f.092036, para. 21.

<sup>49</sup> 091971-091980, f.091979, para. 22(c); 092028-092038, f.092037, para. 22(c).

<sup>50</sup> 083988-083991 RED, f.083989, para. 7; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00008, para. 4.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

me hetimet konfidenciale dhe procedurat penale të TFHS/ZPS-së.<sup>51</sup> Paketa 1 përmban gjithashtu [REDAKTUAR].<sup>52</sup>

26. Paketa 1 përmban [REDAKTUAR] kërkesa, shumica dërmuese e të cilave përfshijnë shtojca të cilat janë të shënuara shprehimisht si konfidenciale.<sup>53</sup> Shtojcat konfidenciale rendisin [REDAKTUAR] emra dëshmitarësh dhe dëshmitarësh të mundshëm, të cilët nuk janë bërë asnjëherë publikë nga TFHS/ZPS-ja, dhe në lidhje me të cilët TFHS-ja kërkonte të merrte nga autoritetet kompetente serbe: (i) ndihmë për të kryer intervista me dëshmitarët; dhe/ose (ii) procesverbalet e deklaratave dhe dëshmime të mëparshme të dëshmitarëve.<sup>54</sup>

27. Paketa 1 përmban [REDAKTUAR] që [REDAKTUAR] jepen [REDAKTUAR] informacione të hollësishme për krime të rënda.<sup>55</sup>

28. Paketa 1 nuk përfshin<sup>56</sup> letrën të cilin e kishte përmendur GUCATI një ditë më parë, kur kishte pretenduar se në selinë e OVL-UÇK-së do të dorëzoheshin 7000 dosje me dokumente.<sup>57</sup>

29. Në veçanti, paketa 1 përfshin [REDAKTUAR],<sup>58</sup> dhe të cilën GUCATI e tregoi dhe diskutoi [REDAKTUAR].<sup>59</sup>

30. Brenda disa orësh nga sekuestrimi i paketës 1, HARADINAJ u vu në dijeni për sekuestrimin dhe atij iu dha një kopje e dokumentit që KLINAKU kishte nënshkruar,

---

<sup>51</sup> 084015-084026, f.084015, para. 7; 091791-091792, f. 091791-091792, para. 6-12; 093492-093590, f.093492, para. 3-4, shtojca 1.

<sup>52</sup> 091791-091792, f.091791, para. 8; 093492-093590, f.093492, para. 3-4, shtojca 1.

<sup>53</sup> 084015-084026, p.084016, para. 8-9; 093492-093590, f.093492, para. 3-4, shtojca 1.

<sup>54</sup> 084015-084026, f.084016, para. 9-12; 093492-093590, f.093492, para. 3-4, shtojca 1.

<sup>55</sup> 091791-091792, f.091792, para. 12; 093492-093590, f.093492, para. 3-4, shtojca 1.

<sup>56</sup> Për një përshkrim të përmbajtjes së paketës 1, *shih gjithashtu* 084015-084026, f. 084015-084016; 091791-091792; 093492-093590, f.093492, para. 3-4, shtojca 1.

<sup>57</sup> 081358-01-TR-ET, f.4; 081358-01, min.00:57:54-00:59:42.

<sup>58</sup> 081361-081378, f.081362.

<sup>59</sup> 084015-084026, f.084017, para. 15; 093492-093590, f.093509 (shënimi korrespondon me faqen me numër 116); 081358-01-TR-ET, f. 5-6; 081358-01, min.00:59:42-01:01:00.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

ku konfirmonte sekuestrimin e dokumenteve, dokument të cilin HARADINAJ e nxori në profilin e tij në Facebook.<sup>60</sup>

31. Gjatë një programi televiziv të transmetuar më 8 shtator 2020, pak pas sekuestrimit të paketës 1, KLINAKU pranoi se ai dhe persona të tjerë u kishin thënë hetuesve të DHS-së se ata u kishin shpërndarë mediave tri kopje të dokumenteve të dorëzuara nga personi i pidentifikuar dhe shtoi se ata u kishin thënë mediave se mund të bënin shumë kopje që të kishte për të gjithë, sepse për ata DHS-ja është inekzistente dhe nuk e kanë pranuar kurrë.<sup>61</sup>

32. Më 8 shtator 2020, HARADINAJ nxori në profilin e tij në Facebook disa pamje të incizuara prej kamerave të sigurisë, me shënimin se pamjet tregonin momentet e dorëzimit të dokumenteve në selinë e OVL-UÇK-së dhe sekuestrimin e tyre nga ZPS-ja, duke komentuar se OVL-UÇK-ja i mirëpriste të dy palët; Postimi i HARADINAJT u shpërnda nga GUCATI.<sup>62</sup> Në një koment të bërë nën postimin e tij në Facebook, HARADINAJ, duke iu referuar dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë deklaroi se “more nuk mund i zhdukin ata ato më kurr”.<sup>63</sup> Ai theksoi se ishin shpërndarë edhe tri kopje, se këto kopje ishin shpërndarë në dhjetë vende dhe se këto dhjetë vende kanë detyrë që të shpërndajnë edhe nga tri kopje secili.<sup>64</sup>

33. Më 9 shtator 2020, HARADINAJ postoi në profilin e tij në Facebook një foto të kopjes së legalizuar të urdhrit të parë, i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.<sup>65</sup>

---

<sup>60</sup> SPOE00220798-00220798 (SPOE00220798-SPOE00220798-ET Rishikuar); SPOE00220799-00220799 (SPOE00220799-SPOE00220799-ET Rishikuar). Postimet në Facebook të bëra nga HARADINAJ dhe GUCATI të përmendura në këtë dosje paraprake u bënë të gjitha si “publike”, siç tregohet nga figura e globit që paraqitet në postime të tilla, që do të thotë se ato mund të shiheshin jo vetëm nga një grup konkret personash.

<sup>61</sup> 081931-02-TR-ET Rishikuar, f.1; 081931-02, min.00:12:22-00:12:49.

<sup>62</sup> SPOE00220800-00220800 (SPOE00220800-SPOE00220800-ET); SPOE00222202-00222288, f.SPOE00222250 (SPOE00222202-SPOE00222288-ET, f.SPOE00222250); 081979-13; 081979-14.

<sup>63</sup> SPOE00220800-00220800 (SPOE00220800-SPOE00220800-ET).

<sup>64</sup> SPOE00220800-00220800 (SPOE00220800-SPOE00220800-ET).

<sup>65</sup> SPOE00222202-00222288, f.SPOE00222202.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

34. Në të njëjtën ditë, [REDAKTUAR].<sup>66</sup> [REDAKTUAR] gjatë konferencës së parë për shtyp, përfaqësuesve të kësaj qendre mediatike, ndër të tjera, u ishte dhënë një kopje e dokumenteve që ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë.<sup>67</sup> Më vonë atë ditë, anëtarët e personelit të ZPS-së morën këto dokumente [REDAKTUAR] ("paketa 4").<sup>68</sup>

35. Paketa 4 përmban 930 faqe.<sup>69</sup> Të gjitha dokumentet që përfshihen në paketën 1 janë të përfshira edhe në paketën 4, me përjashtim të një kërkesë dhe një shënimi të shkruar me dorë që përshkruan dorëzimin e paketës 1 ZPS-së më 8 shtator 2020.<sup>70</sup> Paketa 4 përmban gjithashtu edhe dokumentet si vijon, të cilat nuk janë pjesë e paketës 1: (i) një numër kërkesash dhe dokumentesh të tjera në gjuhën serbe të cilat, ndër të tjera, përmbajnë [REDAKTUAR] emra dëshmitarësh dhe dëshmitarësh të mundshëm të TFHS/ZPS-së, që nuk janë përmendur asnjëherë publikisht nga TFHS/ZPS-ja;<sup>71</sup> dhe (iii) një model dokumenti me dy faqe që duket se nuk ka lidhje me dokumentet e tjera të paketës 4.<sup>72</sup>

36. Një nga mesazhet elektronike që iu dërguan ZPS-së nga mediat pas konferencës së parë për shtyp kishte të bashkëngjitur, ndër të tjera, katër fotografi të dokumenteve që përmbante paketa 1 dhe dy fotografi të cilat ndodhen vetëm në paketën 4.<sup>73</sup> Dokumentet që tregohen në këto gjashtë fotografi të bashkëngjitura janë kërkesa dhe dokumente të autoriteteve serbe që, ndër të tjera, u referohen intervistave të dëshmitarëve; dy nga këto dokumente janë shënuar si rreptësisht konfidenciale

---

<sup>66</sup> 083988-083991 RED, f.083989 para. 7; 091909-091917 RED, f.091910, para. 5-6, f.091917; 083986-083987 RED, f.083986, para. 1; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00008, para. 4.

<sup>67</sup> 091909-091917 RED, f.091910, para. 5-6, f.091917; 083986-083987 RED, f.083986, para. 1.

<sup>68</sup> 083986-083987 RED; 078569-078569; 091927-091930, f.091927, para. 5. Më vonë po atë ditë, HARADINAJ u vu në dijeni se ZPS-ja mori dosjet me dokumente nga kjo media, *shih* SPOE00220813-0020813 (SPOE00220813-SPOE0020813-ET).

<sup>69</sup> 091927-091930, f.091927, para. 7.

<sup>70</sup> 091927-091930, f. 091927-091928, para. 8-10; 081340-081340 (081340-081340-ET).

<sup>71</sup> 091927-091930, f.091928, para. 11-12.

<sup>72</sup> 091927-091930, f.091929, para. 13; 078981-078982 (078981-078982-ET).

<sup>73</sup> 083999-083999; 091927-091930, f. 091929-091930, para. 14-20; *Shih gjithashtu* 084000-084001 RED.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

ndërsa dy prej dokumenteve u referohen dokumenteve të tjera të përshkruara si konfidenciale.<sup>74</sup>

37. Gjatë një programi televiziv që u transmetua më 9 shtator 2020,<sup>75</sup> HARADINAJ deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte marrë katër kopje të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë, dhe se ai e të tjerët i kishin këqyrur dokumentet për një periudhë prej katër orësh.<sup>76</sup> Ai deklaroi se ai dhe të tjerët u kishin dhënë kopje të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë gazetarëve, të cilët më tej u kishin shpërndarë kopje të tjera përfaqësuesve të tjerë të shtypit, duke shtuar se nuk mendonte që këto dosje mund të fshiheshin më në Kosovë.<sup>77</sup> Ai deklaroi: “ne ato si kemi pas ilegale, na e kemi bo përmes mediave, e kemi bo publike”, dhe se askush nuk mund të ndalonte tashmë publikimin e kopjeve të dokumenteve të nxjerra për herë të parë.<sup>78</sup>

38. HARADINAJ deklaroi se në mesin e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë ishte informacioni nga “[REDAKTUAR]”.<sup>79</sup> Ai theksoi se në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë përfshiheshin kërkesa drejtuar Serbisë për të treguar vendndodhjet e dëshmitarëve.<sup>80</sup>

39. HARADINAJ deklaroi se nëse do të merrte sërish një material të tillë, ai do ta bënte publik dhe, edhe nëse OVL-UÇK-ja do të bënte shkelje të ligjit, ajo kishte detyrë që të bënte çdo gjë që të provonte moskorrektësinë e DHS-së sepse është raciste dhe

---

<sup>74</sup> 091927-091930, f. 091929-091930, para. 14-20.

<sup>75</sup> Më vonë atë ditë, HARADINAJ nxori një lidhje me këtë intervistë në profilin e tij në Facebook, *shih* SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220752 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220752).

<sup>76</sup> 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f.7; 081991-01, min.00:13:10-00:13:47, 00:14:24-00:15:51; *Shih gjithashtu* SPOE00220813-0020813 (SPOE00220813-SPOE0020813-ET).

<sup>77</sup> 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 5-6; 081991-01, min.00:07:42-00:08:04, 00:08:42-00:08:58, 00:10:15-00:11:29.

<sup>78</sup> 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f.3; 081991-01, min.00:04:19-00:05:37.

<sup>79</sup> 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 7-8; 081991-01, min.00:14:24-00:15:51.

<sup>80</sup> 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f.8; 081991-01, min.00:14:24-00:15:51.



KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

selektive.<sup>81</sup> HARADINAJ përsëriti gjithashtu thirrjen e tij për përfaqësuesit e shtypit që t'i botonin dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë.<sup>82</sup>

40. Më 11 shtator 2020, gjatë një paraqitjeje në një program tjetër televiziv, HARADINAJ deklaroi sërish se ai dhe të tjerë i kishin shqyrtuar dokumentet për katër orë e gjatë asaj kohe kishin lexuar emra dëshmitarësh dhe ish-dëshmitarësh.<sup>83</sup> Ai deklaroi se të gjithë avokatët shqiptarë duhej të merrnin kopje të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë sepse do t'i ndihmonin në mbrojtjen e klientëve të tyre dhe në hedhjen poshtë të akuzave pasi të paraqiteshin aktakuzat para DHS-së.<sup>84</sup> HARADINAJ deklaroi se sa herë atij dhe të tjerëve t'u vinin dosje, ata do t'i bënin publike sepse këtë detyrë kishin meqenëse nuk e njohin DHS-në ose "Prokurorin Special", duke shtuar se nuk ishte detyrë e OVL-UÇK-së e as e dikujt tjetër që të kujdeset për sekretet e DHS-ose ose ZPS-së.<sup>85</sup>

### C. Konferenca e dytë për shtyp dhe dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë

41. Më 16 shtator 2020, OVL-UÇK-ja mbajti një konferencë tjetër për shtyp ("konferenca e dytë për shtyp") në të cilën GUCATI deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte marrë një sasi tjetër dokumentesh rreth orës 15:30 të asaj dite.<sup>86</sup> Ai u tha të pranishmëve se mund t'i merrnin dokumentet ("dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë").<sup>87</sup> Duke treguar njërin prej dokumenteve të paketës 2 me dokumente, GUCATI vuri në dukje se [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] kishin bashkëpunuar me

<sup>81</sup> 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 7-8; 081991-01, min.00:13:54-00:15:51.

<sup>82</sup> 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 3, 10; 081991-01, min.00:04:44-00:05:37, 00:20:23-00:21:06.

<sup>83</sup> 081979-11-TR-ET Rishikuar, f. 4-5; 081979-11, min.00:07:17-00:11:53.

<sup>84</sup> 081979-11-TR-ET Rishikuar, f. 3-5; 081979-11, min.00:06:03-00:06:55, 00:12:27-00:14:23.

<sup>85</sup> 081979-11-TR-ET Rishikuar, f. 3-5; 081979-11, min.00:06:03-00:06:55, 00:09:41-00:11:53. Më vonë atë ditë, HARADINAJ nxori një lidhje me këtë intervistë në profilin e tij në Facebook, *shih* SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220744 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220744).

<sup>86</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 1-2; 081344-02, min.00:00:01-00:02:31; *Shih gjithashtu* 089984-01; 091925-05; 091925-06; 091925-07; 091925-08; 081979-10; 081979-10-TR-ET.

<sup>87</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f.1; 081344-02, min.00:00:01-00:02:31.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

prokurorët serbë dhe DHS-në.<sup>88</sup> Pastaj ai ia dha fjalën HARADINAJT dhe qëndroi aty gjatë kohës që foli HARADINAJ.<sup>89</sup>

42. HARADINAJ vuri në dukje se dokumentet tregonin se Klint UILLIAMSON, ish-kryeprokurori i TFHS-së, kishte pasur mbi 57 komunikime me [REDAKTUAR], dhe se Dejvid SHVENDIMAN, ish-kryeprokuror i TFHS-së dhe Prokuror i Specializuar i ZPS-së, kishte pasur mbi 130 komunikime me [REDAKTUAR].<sup>90</sup> HARADINAJ deklaroi se komunikimet që ai dhe të tjerë kishin parë [REDAKTUAR] ishin bërë për [REDAKTUAR]<sup>91</sup> TFHS/ZPS-ja nuk kishte nxjerrë më parë publikisht ndonjë informacion në lidhje me vendet që paraqisnin interes për hetimet e saj.<sup>92</sup> HARADINAJ vuri gjithashtu në dukje se dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë përfshinin “aktakuza Ramusha, e kësisha” dhe iu referua aktakuzave kundër Fatmir LIMAJT dhe Ramush HARADINAJT.<sup>93</sup>

43. HARADINAJ u tha personave të pranishëm në konferencën e dytë për shtyp që t’i merrnin dosjet, duke theksuar “Ne i qesim qetu, për kush të ka qejf me i marrë.”<sup>94</sup> Kur një person nga të pranishmit pyeti nëse mund të bënte fotografi të dokumenteve, HARADINAJ u përgjigj: “Qysh s’guxon, guxon me i marr n’xhep krejt”.<sup>95</sup> HARADINAJ e përsëriti premtimin e tij për t’i bërë publike dokumentet sa herë që OVL e UÇK-së të merrte të tilla.<sup>96</sup> Duke iu referuar vetes dhe anëtarëve të tjerë të OVL-UÇK-së, HARADINAJ shtoi se ata nuk mbanin përgjegjësi, se ai nuk lodhej për atë punë e shtoi se ishte detyra e tyre të diskreditonin DHS-së.<sup>97</sup> Ai deklaroi se mbase

<sup>88</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f.1; 081344-02, min.00:00:01-00:02:31.

<sup>89</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 1-4; 081344-02, min.00:00:01-00:09:49.

<sup>90</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 2-3; 081344-02, min.00:02:40-00:09:49.

<sup>91</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f.3; 081344-02, min.00:02:40-00:09:49.

<sup>92</sup> Informacioni i disponueshëm publik tregon se një numër i këtyre vendndodhjeve po hetoheshin nga ZPS-ja, *shih* KSC-BC-2020-06/F0045/A03, para. 61, 63, 68-70, 75-76.

<sup>93</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 4-5; 081344-02, min.00:09:49-00:10:29.

<sup>94</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f.4; 081344-02, min.00:02:40-00:09:49.

<sup>95</sup> 089984-01-TR-ET, f.1; 089984-01, min.00:15:52-00:16:19.

<sup>96</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f.4; 081344-02, min.00:02:40-00:09:49.

<sup>97</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 2-4; 081344-02, min.00:02:40-00:09:49.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

arsyeja pse dokumentet i ishin dhënë OVL-UÇK-së ishte se ata kishin guxim që t'i nxirrnin dhe se nuk pajtoheshin me këtë Gjykatë.<sup>98</sup>

D. Ngjarjet që pasuan konferencën e dytë për shtyp

44. Ashtu siç bënë pas konferencës së parë për shtyp, HARADINAJ dhe GUCATI dolën në disa programe televizive pas konferencës së dytë për shtyp, duke mundësuar që përmbajtja e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë dhe të dytë të përhapej sa më shumë.

45. Gjatë një interviste më 16 shtator 2020,<sup>99</sup> HARADINAJ deklaroi se ai dhe të tjerë i kishin shfletuar dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë për tri orë, kohë gjatë se cilës ai dhe të tjerët kishin marrë çfarë u duhej.<sup>100</sup> HARADINAJ deklaroi se ai dhe të tjerë kishin thënë se do nxirrnin çdo material që komprometonte DHS-në dhe ZPS-në, duke shtuar se ai dhe të tjerë nuk e njohin DHS-në dhe kjo është arsyeja që do ta nxjerrin atë informacion, e gjithashtu theksoi “nuk është detyra jonë që të ruajmë sekretet.”<sup>101</sup> Ai më tej përmendi emra në dokumente, duke iu referuar “z.UILLIAMSON” që komunikonte me [REDAKTUAR].<sup>102</sup> Ai më tej përmendi [REDAKTUAR], dhe u zotua se do të nxirrte emra ndër të cilët [REDAKTUAR].<sup>103</sup> HARADINAJ deklaroi hapur, duke iu referuar dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë, se ai dhe të tjerë i bënë ato publike sepse ishte e dobishme për ta.<sup>104</sup> Në përgjigje të pyetjes nëse ishte i vetëdijshëm që kjo që po ndodhte mund të dëmtonte procesin gjyqësor, HARADINAJ deklaroi se këtë donte që të ndodhte.<sup>105</sup>

<sup>98</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 6-7; 081344-02, min.00:12:09-00:12:45.

<sup>99</sup> Më 19 shtator 2020, HARADINAJ nxori një lidhje me intervistën në profilin e tij në Facebook, *shih* SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220735 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220735).

<sup>100</sup> 081979-07-TR-ET, f. 3-4; 081979-07, min.25:32-26:20.

<sup>101</sup> 081979-07-TR-ET, f. 1-2; 081979-07, min.00:27-01:10.

<sup>102</sup> 081979-07-TR-ET, f..2-3; 081979-07, min.09:30-11:01.

<sup>103</sup> 081979-07-TR-ET, f. 2-3; 081979-07, min. 09:30-11:01, 24:45-25:32.

<sup>104</sup> 081979-07-TR-ET, f. 3-5; 081979-07, min.25:32-26:20.

<sup>105</sup> 081979-07-TR-ET, f..5-6; 081979-07, min.28:52-29:38.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

46. Gjatë një programi televiziv i cili u transmetua më 17 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte pasur kohë për t'i parë dokumentet që u kishte sjellë personi i panjohur.<sup>106</sup> HARADINAJ deklaroi se ndër dëshmitarët e ZPS-së [REDAKTUAR]<sup>107</sup> Ai u bëri sërish thirrje gazetarëve që t'i merrnin dokumentet nga OVL-UÇK-ja dhe t'i botonin,<sup>108</sup> dhe deklaroi se shpresonte që personi që i kishte sjellë dosjet, të sillte edhe të tjera.<sup>109</sup> HARADINAJ i quajti ata të cilët kishin bashkëpunuar me ZPS-në “çetnikë, kriminelë”.<sup>110</sup>

47. Më 17 shtator 2020, ZPS-ja sekuestroi disa dokumente që ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së dytë (“paketa 2”).<sup>111</sup> GUCATI konfirmoi sekuestrimin duke nënshkruar dokumentin.<sup>112</sup> Gjatë sekuestrimit, një anëtar i personelit të ZPS-së informoi GUCATIN, HARADINAJN dhe personat e tjerë të pranishëm se OVL-UÇK-ja nuk ishte e autorizuar të mbante materialin e klasifikuar të ZPS-së dhe se ata duhej t'ia dorëzonin atë material ZPS-së ose autoriteteve të tjera ligjore.<sup>113</sup> Një kopje e urdhrit të dytë,<sup>114</sup> që i referohej natyrës së ndjeshme dhe jopublike të dokumenteve që ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së dytë dhe përsëriste urdhrin për të mos shpërndarë më tej këtë material, iu dha GUCATIT; paragrafët përkatës të urdhrit u përkthyen në shqip dhe iu lexuan atij.<sup>115</sup>

48. Gjatë sekuestrimit, HARADINAJ deklaroi se e dinte që publikimi i emrave të dëshmitarëve mund të rrezikonte jetën e tyre.<sup>116</sup> HARADINAJ informoi anëtarët e personelit të ZPS-së se rreth 70% e dokumenteve të përmendura në konferencën e dytë

<sup>106</sup> 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f.3; 082106-06, min.00:05:02-00:07:52.

<sup>107</sup> 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f.2; 082106-06, min.00:00:19-00:03:50.

<sup>108</sup> 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f.3; 082106-06, min.00:05:02-00:07:52.

<sup>109</sup> 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f. 2-3; 082106-06, min.00:04:37-00:07:52.

<sup>110</sup> 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f. 1-2; 082106-06, min.00:00:19-00:03:50.

<sup>111</sup> 082010-082013 RED; 079512-080448 RED; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00028.

<sup>112</sup> 082010-082013 RED, f.082012, para. 12, 18; 079500-079500; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00028, para. 6.

<sup>113</sup> 082010-082013 RED, f.082011, para. 8; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00028, paragrafi.2.

<sup>114</sup> 092017-092027; 091981-091991 (“Urdhri i Dytë”).

<sup>115</sup> 082010-082013 RED, f.082012 para.12; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00028, para. 5.

<sup>116</sup> 082010-082013 RED, f.082011-082012, para. 9.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

për shtyp ishin marrë nga gazetarët; GUCATI e konfirmoi këtë.<sup>117</sup> HARADINAJ, GUCATI dhe të tjerët e përsëritën këtë edhe në raste të tjera,<sup>118</sup> ndër to edhe gjatë një paraqitjeje në një program televiziv ku HARADINAJ përshkroi atë çfarë kishte sekuestruar ZPS-ja nga dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë me fjalët “çka kanë tepru”.<sup>119</sup>

49. Paketa 2 përbëhet nga 937 faqe, gjashtë prej të cilave janë identike me ato nga kërkesat dhe dokumentet serbe tashmë të përfshira në paketën 1, ku përmenden [REDAKTUAR] dëshmitarë ose dëshmitarë të mundshëm dhe [REDAKTUAR].<sup>120</sup> 931 faqet e mbetura janë kopje të aktvendimeve gjyqësore dhe dokumenteve përkatëse të lëshuara nga gjykatat e Kosovës dhe institucione të tjera gjyqësore, duke përfshirë Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, lidhur me çështje të krimeve të luftës,<sup>121</sup> dhe, siç u përmend specifikisht nga HARADINAJ gjatë konferencës së dytë për shtyp,<sup>122</sup> kopje të aktakuzave, duke përfshirë ato kundër Fatmir LIMAJT dhe të tjerëve dhe kundër Ramush HARADINAJT dhe të tjerëve.<sup>123</sup> Kopjet e këtyre

<sup>117</sup> 082010-082013 RED, f.082012 para. 10, 13; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00028, para. 3. GUCATI e konfirmoi gjithashtu këtë gjatë një konference për shtyp të cilën ai e mbajti më vonë po atë ditë, 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.3; 081347-01, min.00:02:27-00:03:57.

<sup>118</sup> *Shih* 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 5-6; 082136-01, min.00:15:41-00:16:18; *Shih gjithashtu* 081344-03; 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 7, 10-11; 081355-03, min. 00:13:57-00:14:20, 00:18:22-00:19:40.

<sup>119</sup> HARADINAJ deklaroi se OVL UÇK-ja njoftoi një pjesëtar të personelit të ZPS-së se më 16 dhe 17 shtator, ata u kishin shpërndarë mbi 80% të dokumenteve që kishin marrë më 16 shtator 2020 të gjithë atyre që kishin dashur një kopje. Më vonë ai deklaroi se DHS-ja mori dokumentet pasi media kishte marrë pothuajse 50 ose 100 për qind të materialit dhe se më herët po atë ditë DHS-ja kishte marrë rreth 20 për qind të dokumenteve, sepse gazetarët kishin marrë pjesën tjetër të dokumenteve. 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f. 4-5, 17-18, 36; 081355-02, min.00:25:13-00:26:15, 00:37:33-00:38:23, 00:59:46-00:59:54.

<sup>120</sup> 084015-084026, .08018-08019, para. 22-27; 093492-093590, f. 093492-093493, para. 5-6, shtojca 3.

<sup>121</sup> 084015-084026, f.084018, para. 21; 079512-080448 RED. Gjatë një interviste në televizion, HARADINAJ pohoi se paketa 2 përmbante edhe aktgjykime “që i kan çu kta të tan atje”, 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f.30; 081355-02, min.00:52:33-00:53:07. Pas konferencës së dytë për shtyp në internet dolën artikuj me lajme, në të cilat, ndër të tjera, raportohej se dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë përfshinin aktvendime gjyqësore të lëshuara nga EULEX-i dhe TPNJ-ja, *shih* 081361-081378, f..081371-081373 (081371-081373-ET), që paraqet pamje të dy faqeve që janë gjithashtu pjesë e paketës 2. (079512-080448 RED, f. 080319, 080346) por në të cilat ishin bërë redaktime.

<sup>122</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 4-5; 081344-02, min.00:09:49-00:10:29.

<sup>123</sup> 079512-080448 RED, f. 080007-080030, 080032-080034, 080346-080441; 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 4-5; 081344-02, min.00:09:49-00:10:29.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

aktvendimeve nuk kanë ndonjë stemë ose shenjë tipike të dokumenteve të TFHS-së ose ZPS-së.<sup>124</sup>

50. Menjëherë pas sekuestrimit të paketës 2, GUCATI dhe të tjerë mbajtën një konferencë për shtyp në selinë e OVL-UÇK-së, gjatë së cilës GUCATI pohoi se anëtarët e personelit të ZPS-së i kishin dorëzuar atij një kopje të urdhrin të dytë dhe se i kishin thënë atij se këto dokumente nuk mund të shumëfishoheshin ose shpërndareshin dhe se nuk mund të publikoheshin emnat e dëshmitarëve.<sup>125</sup> GUCATI deklaroi se përfaqësuesit e OV-UÇK-së u kishin thënë anëtarëve të personelit të ZPS-së se çdo moment që atyre do t'u vinin dokumente nga DHS-ja, ata do t'i bënin publike për media".<sup>126</sup> GUCATI deklaroi se arsyeja pse ai dhe të tjerët do t'i bënin publike ishte se do të vërtetonin çka kishin thënë para tri vitesh, edhe ndaj pjesëtarëve të Ushtrisë dhe ndaj qytetarëve të Kosovës në mënyrë që të bindeshin edhe ata si edhe media, që DHS-ja është duke bashkëpunuar me autoritetet serbe kundër pjesëtarëve të UÇK-së.<sup>127</sup>

51. GUCATI deklaroi se "ne jemi të interesu me demasku Dhomat Speciale" duke shtuar se përmes informimit të personave për çdo material të marrë nga OV-UÇK-ja, kjo organizatë do të tregojë pse është kundër DHS-së dhe se "ne e kemi thënë me kohë që kjo Gjykatë është raciste, është e njëanshme. Për ne është e papranueshme dhe kjo është arsyeja pse ne i publikojmë të gjitha këto dokumentacione"<sup>128</sup> GUCATI më pas, lidhur me dokumentet që i ishin dorëzuar OVL-UÇK-së deklaroi se interesi i tyre ishte që t'i shpërndanin sa më shumë në media dhe të bindnin publikun dhe median se kjo Gjykatë është e papranueshme dhe theksoi se ai dhe të tjerët kanë qenë gjithmonë kundër saj.<sup>129</sup>

<sup>124</sup> 084015-084026, f.084018, para. 21; 079512-080448 RED.

<sup>125</sup> 081347-01-TR-ET Rishikuar, f. 3, 8; 081347-01, min.00:02:27-00:03:57, 00:16:42-00:17:19.

<sup>126</sup> 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.3; 081347-01, min.00:02:27-00:03:57.

<sup>127</sup> 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.3; 081347-01, min.00:02:27-00:03:57.

<sup>128</sup> 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.8; 081347-01, min.00:15:25-00:17:19.

<sup>129</sup> 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.8; 081347-01, min.00:17:26-00:17:40.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

52. Në një intervistë tjetër më 17 shtator 2020, HARADINAJ e falënderoi personin që dorëzoi dokumentet në OVL-UÇK-së dhe deklaroi se nëse ai person mund të sillte edhe materiale të tilla të tjera, ata e mirëprisnin.<sup>130</sup> HARADINAJ deklaroi se sa herë që OVL-UÇK-ja do të merrte materiale të tilla, ZPS-ja nuk do të mund t'i ndalonte dhe se ai nuk e njihnte këtë Gjykatë.<sup>131</sup> Për dokumentet e marra nga OVL-UÇK-ja, HARADINAJ deklaroi "Për kë o vlla sensitive janë? Janë për gjykatën e Hagës që bashkëpunon me Serbinë sensitive. Për mu s'janë".<sup>132</sup> Ai deklaroi se edhe nëse ai dhe të tjerë nxirrnin ndonjë emër, çdo deklaratë ishte dhënë nën tryzni, nuk ishte relevante dhe nuk kishte bazë për ngritje aktakuze, prandaj e kishin bërë publike.<sup>133</sup>

53. Gjatë një interviste tjetër atë ditë, HARADINAJ deklaroi se po ndërmerrnin veprime për të diskredituar profesionalizmin e pretenduar të gjykatës.<sup>134</sup>

54. Në një intervistë tjetër më 17 shtator 2020,<sup>135</sup> HARADINAJ deklaroi se dokumentet e marra nga OVL-UÇK-ja "kanë vulën origjinale" dhe shënimin "top sekret".<sup>136</sup> HARADINAJ përmendi bashkëpunimin e DHS-së me [REDAKTUAR].<sup>137</sup> Ai kritikoi median me fjalët "qyqarë" për "[mos]nxjerr[jen] e të vërtetës", dhe për hezitimin e botimit të materialeve të nxjerra publikisht nga OVL-UÇK-ja, duke theksuar se kjo bënte të nevojshme që HARADINAJ dhe të tjerët t'i nxirrnin këto dokumente për "mediat e huaja".<sup>138</sup> Kur intervistuesi tha se me aq sa ishte informuar, publikimi i një materiali të tillë është ligjërisht i ndaluar, HARADINAJ deklaroi: "Jo,

---

<sup>130</sup> 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f.4; 081355-02, min.00:24:24-00:25:12.

<sup>131</sup> 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f.14; 081355-02, min.00:34:18-00:35:13.

<sup>132</sup> 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f. 19-20; 081355-02, min.00:39:29-00:39:36.

<sup>133</sup> 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f. 25-26; 081355-02, min.00:46:29-00:47:54.

<sup>134</sup> 082106-07-TR-ET Rishikuar, f.2; 082106-07, min.00:06:24-00:08:04.

<sup>135</sup> Më 18 shtator 2020, HARADINAJ nxori në profilin e tij në Facebook një lidhje me intervistën e tij, *shih* SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220737 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220737).

<sup>136</sup> 081979-08-TR-ET, f.2; 081979-08, min.00:02:48-00:04:05.

<sup>137</sup> 081979-08-TR-ET, f. 1, 3-4; 081979-08, min.00:00:13-00:01:49, 00:06:33-00:08:53.

<sup>138</sup> 081979-08-TR-ET, f.2; 081979-08, min.00:04:24-00:05:16.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

jo, të lutem, nuk e kanë ligjërisht, sepse ne kemi këtu një ligj për mbrojtjen e burimeve”.<sup>139</sup>

55. [REDAKTUAR].<sup>140</sup> [REDAKTUAR].<sup>141</sup> [REDAKTUAR].<sup>142</sup> Në të njëjtën ditë, HARADINAJ nxori në profilin e tij në Facebook një lidhje me një artikull tjetër [REDAKTUAR].<sup>143</sup> [REDAKTUAR].<sup>144</sup>

56. Gjatë një interviste më 18 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se anëtarët e ZPS-së që sekuestruan materialin nga OVL-UÇK-ja konfirmuan “sensitivitetin” e një materiali të tillë.<sup>145</sup> Ai deklaroi se shpresonte që personi i cili kishte sjellë dokumentet në OVL-UÇK ta bënte sërish këtë dhe e cilësoi dorëzimin e dokumenteve në OVL-UÇK si “mrekulli”.<sup>146</sup> HARADINAJ deklaroi se ai dhe të tjerët u kishin thënë përfaqësuesve të ZPS-së të cilët sekuestruan materialin nga OVL-UÇK-ja, se nuk e njihnin DHS-në.<sup>147</sup>

57. Gjatë të njëjtës intervistë Tomë GASHI deklaroi se personi i paidentifikuar që kishte sjellë dokumentet në selinë e OVL-UÇK-së, kishte kryer një punë atdhetare për të mirën e përgjithshme, por posaçërisht në të mirë të atyre që do të jenë të akuzuar në DHS-në.<sup>148</sup> Ai vuri në dukje se dokumentet e sekuestruara nga DHS-ja kishin logon e tyre dhe ishin origjinale duke shtuar se këto ishin dokumente sensitive për ZPS-në.<sup>149</sup>

<sup>139</sup> 081979-08-TR-ET, f. 2-3; 081979-08, min.00:05:16-00:06:16.

<sup>140</sup> SPOE00220754-00220757, f.SPOE00220754; SPOE00220808-00220810; 081915-081919, f. 081917-081918 (081914-081919-ET, f. 081917-081918).

<sup>141</sup> SPOE00220808-00220810; 081915-081919, f. 081917-081918 (081914-081919-ET, f. 081917-081918); 084015-084026, f. 084017, para. 17.

<sup>142</sup> 084015-084026, f.084017, para.17.

<sup>143</sup> SPOE00220754-00220757, f.SPOE00220755; SPOE00220811-00220812 (SPOE00220811-SPOE00220812-ET).

<sup>144</sup> SPOE00220811-00220812 (SPOE00220811-SPOE00220812-ET).

<sup>145</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 2-3; 081355-03, min.00:01:20-00:01:58, 00:03:22-00:04:38; 081979-09; Më vonë atë ditë, HARADINAJ nxori në profilin e tij në Facebook një lidhje me këtë intervistë, *shih* SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220739 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, p.SPOE00220739).

<sup>146</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081355-03, min.00:01:59-00:03:22.

<sup>147</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 2-3; 081355-03, min. 00:03:27-00:04:38.

<sup>148</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 4-5; 081355-03, min.00:08:26-00:09:47.

<sup>149</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f.3; 081355-03, min.00:04:59-00:08:25.



KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

GASHI deklaroi se dokumentacioni ishte shumë i favorshëm për OVL-UÇK-në dhe për cilindo që mund të ketë probleme të natyrës juridike në DHS, duke shtuar se dokumentet mund të përdreshin për të sulmuar besueshmërinë e DHS-së dhe të disa provave.<sup>150</sup> Ky sugjerim pasqyroj ato që një apo dy ditë më parë kishte deklaruar HARADINAJ si arsye të tij dhe të OVL-UÇK-së për nxjerrjen e dokumenteve që u ishin dorëzuar atyre,<sup>151</sup> dhe do të përsëritej nga GASHI në një rast tjetër.<sup>152</sup>

58. GASHI deklaroi se publikimi i këtyre dokumenteve do të thotë se gjykatësi duhet të mendojë edhe njëherë para se të vendosë për konfirmimin apo jo të aktakuzës ndaj Presidentit THAÇI dhe të tjerëve dhe se shpresonte se rrjedhja e dokumentacionit do të ndihmonte në moskonfirmimin e aktakuzës kundër Presidentit THAÇI.<sup>153</sup> GASHI vlerësoi se po vërtetohej teoria se nuk është e mundshme që dëshmitarët të mbrohen në Kosovë dhe pyeti nëse me të vërtetë po u mbrohen në Hagë<sup>154</sup> Ai deklaroi se ai dhe të tjerë e dinin se dokumentet mund të përdreshin për të shantazhuar dikë dhe se keqpërdorimi i dokumenteve përbën vepër penale, por nuk ishte problem i GASHIT.<sup>155</sup>

59. [REDAKTUAR].<sup>156</sup> [REDAKTUAR].<sup>157</sup> [REDAKTUAR].<sup>158</sup> Artikulli tregonte edhe dy pamje të dokumenteve me paraqitjen tipike të kërkesave, [REDAKTUAR].<sup>159</sup>

60. Gjatë një interviste më 19 shtator 2020, HARADINAJ iu referua dosjeve të marra dhe të publikuara nga OVL-UÇK-ja me fjalët “si dëshmitar për ndërtimin e një

<sup>150</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 3-5; 081355-03, min.00:04:59-00:08:25.

<sup>151</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 2-4; 081344-02, min.00:02:40-00:09:49; 082106-07-TR-ET Rishikuar, f. 1-2; 082106-07, min.00:06:24-00:08:04.

<sup>152</sup> 081931-01-TR-ET, f.2; 081931-01, min.00:01:31-00:04:33.

<sup>153</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 16-17; 081355-03, min.00:27:52-00:28:49, 00:29:03-00:30:22.

<sup>154</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f.5; 081355-03, min.00:09:48-00:10:22.

<sup>155</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 8-9; 081355-03, min.00:15:33-00:16:08.

<sup>156</sup> SPOE00222202-00222288, f.SPOE00222247 (SPOE00222202-SPOE00222288-ET, f.SPOE00222247); 081915-081919, f. 081915-081916 (081914-081919-ET, f. 081915-081916).

<sup>157</sup> 081915-081919, f. 081915 (081914-081919-ET, f.081915).

<sup>158</sup> 084015-084026, f.084017, para. 16.

<sup>159</sup> 081915-081919, f. 081915-081916; 084015-084026, f. 084017, para. 16; 093492-093590, f.093498 (korrespondon me f. me numrat 15-16).

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

aktakuze kundër djemve të luftës” dhe i quajti ato konfidenciale.<sup>160</sup> HARADINAJ deklaroi se dokumentet tregonin se [REDAKTUAR], të cilin HARADINAJ e përshkruan si [REDAKTUAR], ishte përfshirë në mbledhjen e “dëshmive” prej dëshmitarëve, në emër të ZPS-së.<sup>161</sup> HARADINAJ vuri gjithashtu në dukje se dihej nga të gjithë që ai dhe të tjerët i kishin vënë dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë në dispozicion të mediave dhe se mediat kishin bërë kopje të tyre,<sup>162</sup> dhe deklaroi se kishte dëshirë që personi i cili i kishte sjellë dokumentet OVL-UÇK-se, të sillte më shumë dokumente dhe ishte i mirëpritur dhe kishte kryer detyrë kombëtare të rëndësishme.<sup>163</sup>

61. HARADINAJ tregoi para kamerës një version të legalizuar të urdhrin të dytë, i cili ishte klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, bashkë me një dokument të ZPS-së që konfirmonte marrjen e materialit të sekuestruar; duke iu referuar urdhrin të dytë, ai pranoi se urdhri përmbante detyrimin për të dhe të tjerët që të mos publikonin dokumentet, duke shtuar “ne s’kemi nevojë me i publiku. Ne i kemi dhanë kush i publikon. Tani janë kompetencat e atyne, a dojnë me i publiku apo s’dojnë me i publiku”<sup>164</sup> HARADINAJ deklaroi se ZPS-ja kishte marrë mbi 20 për qind të materialit të përgjithshëm që ishte në selinë e OVL-UÇK-së dhe gazetarët kishin marrë pjesën tjetër, duke shtuar “ndonjë sekret, d..th. që a mbetë pa dalë, s’ka mbetë”.<sup>165</sup> Ai deklaroi se mediat nuk duhej të fshihnin çfarë kishte bërë Zëvendësprokurori i

<sup>160</sup> 081979-05-TR-ET, f. 2-3, 9; 081979-05, min.00:02:10-00:06:38, 00:18:58-00:19:24.

<sup>161</sup> 081979-05-TR-ET, f. 2-3; 081979-05, min.00:02:10-00:06:38.

<sup>162</sup> 081979-05-TR-ET, f. 3-5; 081979-05, min.00:06:48-00:11:44.

<sup>163</sup> 081979-05-TR-ET, f.5; 081979-05, min.00:12:16-00:12:35. Fakti se HARADINAJ dhe GUCATI mirëpritën dorëzimin e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së dytë duket edhe më qartë nga postimet që ata bënë në profilet e tyre në Facebook, *shih* SPOE00220783-00220783 (SPOE00220783-SPOE00220783-ET Rishikuar); SPOE00222202-00222288, f.SPOE00222248 (SPOE00222202-SPOE00222288-ET, f.SPOE00222248).

<sup>164</sup> 081979-05-TR-ET, f.6; 081979-05, min.00:12:44-00:15:00; *Shih* 079500-079500; 092017-092027; 091981-091991.

<sup>165</sup> 081979-05-TR-ET, f.6; 081979-05, min.00:14:21-00:17:28.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

Specializuar i mëparshëm i ZPS-së duke përmendur mbi 130 komunikime me [REDAKTUAR] dhe të tjerë.<sup>166</sup>

62. Më vonë atë ditë, HARADINAJ nxori një lidhje me këtë intervistë në profilin e tij në Facebook.<sup>167</sup> Një përdorues në Facebook [REDAKTUAR] komentoi me fjalët se ky përdorues dhe të tjerë duhej të botonin libra me deklarata të “tradhtarëve që janë jashqitje”.<sup>168</sup>

63. Më 20 shtator 2020, gjatë një paraqitjeje tjetër në një program televiziv, HARADINAJ deklaroi se kishte lexuar dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë sa kishte mundur brenda orarit të punës së OVL-UÇK-së.<sup>169</sup> HARADINAJ tha se dokumentet ishin marrë prej depove sekrete.<sup>170</sup>

64. HARADINAJ deklaroi se DHS-ja është “selektive” dhe “raciste” dhe se dokumentet që ai dhe të tjerë kishin publikuar tregonin se Gjykata i bazonte akuzat e saj në informacionet e dhëna prej “kriminelëve, gjakpirësve”.<sup>171</sup> Ai i quajti këta persona spiunë, i akuzoi si tradhtarë të popullit të tyre dhe bëri të ditur se qëllimi i nxjerrjes së dokumenteve gjatë herës së parë ishte që t’u bënte të qartë këtyre personave se askush nuk i mbronte veç i shfrytëzonte dhe shtoi se personat të cilët kishin dhënë informacion nuk janë mbrojtur, por janë vrarë, diskredituar ose turpëruar.<sup>172</sup> HARADINAJ deklaroi se Gjykata do të rrëzohej krejt sepse njerëzit tashmë i njihnin dëshmitarët”.<sup>173</sup> Ai i përshkroi dokumentet që OVL-UÇK-së publikoi si “sukses kombëtar” dhe deklaroi se në OVL-UÇK ishin shumë të lumtur me faktin që kishin marrë dosjet dhe tha se njerëzit ishin të mirëpritur të sillnin më shumë.<sup>174</sup>

<sup>166</sup> 081979-05-TR-ET, f. 7-8; 081979-05, min.00:14:21-00:17:28.

<sup>167</sup> SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220731; SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220731.

<sup>168</sup> SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220731 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220731).

<sup>169</sup> 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f.9; 081355-04, min.00:37:46-00:37:48.

<sup>170</sup> 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f.24; 081355-04, min.00:49:08-00:49:27.

<sup>171</sup> 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f.7; 081355-04, min.00:34:44-00:35:22.

<sup>172</sup> 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f.26; 081355-04, min.00:50:33-00:51:07.

<sup>173</sup> 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f. 30-31; 081355-04, min.00:59:36-00:59:50.

<sup>174</sup> 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f. 2-4; 081355-04, min.00:32:25-00:33:30.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

65. Gjatë një programi tjetër televiziv që u transmetua në të njëjtën ditë, HARADINAJ deklaroi se ai dhe të tjerët do të bënin çdo gjë që komprometon ZPS-në, sepse nuk e njohin atë dhe se ai do të ishte krenar dhe i nderuar nëse do të arrestohej për veprimet e tij.<sup>175</sup>

66. Më 20 shtator 2020, HARADINAJ nxori një lidhje me një videomaterial të publikuar nga gazeta “Newborn” në profilin e tij në Facebook.<sup>176</sup> [REDAKTUAR].<sup>177</sup> [REDAKTUAR].<sup>178</sup>

67. Më 21 shtator 2020, në orën 08:21, GUCATI publikoi një postim në profilin e tij në Facebook në të cilin deklaronte se dosjet që iu dorëzuan OVL-UÇK-së ishin dokumente zyrtare të DHS-së që përfshinin emrat e shumicës së dëshmitarëve; ai shkruante se dokumentet kishin dalë nga zyrat e DHS-së, ishin “tepër sekrete dhe shumë të ndjeshme”.<sup>179</sup> GUCATI deklaroi se dosjet përfshinin dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët kundër UÇK-së, dhe ata që kishin zgjedhur OVL-UÇK për t'i lënë dosjet e kishin ngarkuar me një përgjegjësi të madhe, mirëpo OVL-UÇK-ja nuk ishte për të ndrequr gabimet e të tjerëve.<sup>180</sup>

E. Konferenca e tretë për shtyp dhe dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë

68. Rreth orës 10:35 të datës 22 shtator 2020, në selinë e OVL-UÇK-së në Prishtinë u dorëzuan dokumente të tjera.<sup>181</sup> GUCATI dhe të tjerë lexuan pjesë të dokumenteve, që ishin shpërndarë në katër grumbuj.<sup>182</sup> HARADINAJ u tregoi një nga dokumentet ushtarëve gjermanë të KFOR-it që ndodhën të pranishëm në atë kohë, dhe shprehu

<sup>175</sup> 081991-02-TR-ET, f.1-2, 9-10; 081991-02, min. 00:01:01-00:04:03, 00:14:17-00:15:48.

<sup>176</sup> SPOE00220724-00220752, f. SPOE00220729-SPOE00220730 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f. SPOE00220729-SPOE00220730); 081979-04.

<sup>177</sup> 081979-04-TR-ET, f.1; 081979-04, min.00:00:20-00:00:33.

<sup>178</sup> 093492-093590, p.093554 (i korrespondon faqes me numër 582).

<sup>179</sup> 081983-081988; 081983-081988-ET Rishikuar, f. 081983-081986.

<sup>180</sup> 081983-081988; 081983-081988-ET Rishikuar, f. 081983-081986.

<sup>181</sup> 093457-093458 (093457-093458-ET).

<sup>182</sup> 093457-093458 (093457-093458-ET).

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

besimin se nga ky incident dhe të tjerë do të përfitonin persona të caktuar që ishin akuzuar.<sup>183</sup>

69. Sipas një praktike tashmë të qartë dhe të njëjtë, në një konferencë për shtyp të mbajtur menjëherë pas dorëzimit të dokumenteve atë ditë (“konferenca e tretë për shtyp”), GUCATI deklaroi se dikush kishte sjellë dosje të tjera në zyrat e OVL-UÇK-së dhe se ai dhe të tjerët besonin se këto dosje kishin dale nga DHS-ja ose “Gjykata e Hagës”.<sup>184</sup> GUCATI ftoi personat e pranishëm të afroheshin për të parë dokumentet (“dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë”).<sup>185</sup> GUCATI më pas deklaroi se HARADINAJ i kishte lexuar rreth 30 minuta dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë.<sup>186</sup> Si në rastet e mëparshme, ai pastaj ia dha fjalën HARADINAJT dhe qëndroi aty i pranishëm gjatë kohës që fliste HARADINAJ.<sup>187</sup>

70. HARADINAJ deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte dy kopje të dokumenteve që u ishin dorëzuar atyre më herët gjatë asaj dite.<sup>188</sup> Ai deklaroi se në dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë shihte që ishte më tepër një projektaktakuzë për pesë persona që mund të akuzoheshin: “[REDAKTUAR], Hashim THAÇI, Jakup KRASNIQI, Kadri VESELI edhe Rexhep SELIMI”.<sup>189</sup> Aktakuza e konfirmuar kundër THAÇIT, VESELIT, KRASNIQIT dhe SELIMIT u bë publike nga DHS-ja vetëm më 5 nëntor 2020.<sup>190</sup>

71. HARADINAJ deklaroi se [REDAKTUAR], emri i të cilit doli më vonë edhe në versionin publik të aktakuzës kundër THAÇIT dhe të tjerëve,<sup>191</sup> përmendej në dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë bashkë me njerëz dhe vendngjarje të tjera

<sup>183</sup>093457-093458 (093457-093458-ET); *Shih gjithashtu* 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.9; 082136-01, min.00:20:25-00:20:41.

<sup>184</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 1-2; 082136-01, min.00:03:15-00:06:04; *Shih gjithashtu* 081344-03; 091925-09; 091925-10; 091925-11; 091925-12; 081979-03; 081979-03-TR-ET; 081926-01; 081926-01-TR-ET.

<sup>185</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 1-2; 082136-01, min.00:03:15-00:06:04.

<sup>186</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 1-2; 082136-01, min.00:03:15-00:06:04.

<sup>187</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 1-2; 082136-01, min.00:03:15-00:06:51.

<sup>188</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.2; 082136-01, min.00:06:54-00:10:28.

<sup>189</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.2; 082136-01, min.00:06:04-00:06:51.

<sup>190</sup> [REDAKTUAR].

<sup>191</sup> KSC-BC-2020-06/F0045/A03, para.15.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

[REDAKTUAR].<sup>192</sup> ZPS-ja zbuloi publikisht disa nga këto vende si vendngjarje krimesh vetëm kur publikoi aktakuzën më 5 nëntor 2020.<sup>193</sup>

72. HARADINAJ tha se në dokumente përmenden të dhënat personale të shumë njerëzve dhe se përmendej edhe emri i [REDAKTUAR], e emrat e shumë të tjerëve.<sup>194</sup> Ai deklaroi se në atë moment dokumentet ishin në disponim të të pranishmëve, u tha të bënin punën e tyre dhe i falënderoi që ishin aktivë dhe shtoi se mendonte se ai dhe ata duhej ta kryenin atë detyrë të gjithë së bashku.<sup>195</sup>

73. HARADINAJ theksoi se dokumentet e nxjerra gjatë herë së tretë kishin emblemën e ZPS-së dhe ishin kopje të origjinaleve.<sup>196</sup> Kur u pyet nëse OV-UÇK-ja i kishte njoftuar pesë njerëzit emrat e të cilëve ishin përmendur, HARADINAJ u përgjigj se këtë duhej ta bënte personi që bëri pyetjen, duke shtuar: “Për çka të thirrëm ty?”<sup>197</sup> Kur u pyet për më shumë detaje të përmbajtjes së dokumentit, HARADINAJ tha se personi që po e pyeste mund të afrohej dhe ta shihte dokumentin dhe deklaroi se për këtë arsye HARADINAJ kishte thirrur atë dhe të tjerët që të vinin atje, ndryshe ata do i kishin botuar vetë dokumentet.<sup>198</sup>

74. HARADINAJ tha se dokumentet që u ishin dorëzuar më herët atë ditë, ishin në dhomë dhe i ftoi të pranishmit t’i këqyrnin dokumentet, të merrnin nga një kopje dhe t’i fotografonin.<sup>199</sup> Kur u pyet nëse po sugjeronte se media duhej t’i publikonte dokumentet, HARADINAJ u përgjigj se media duhej të publikonte çka të mundte.<sup>200</sup> Kur një person që merrte pjesë në konferencën për shtyp tha se publikimi i

<sup>192</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.2; 082136-01, min.00:06:04-00:10:28.

<sup>193</sup> KSC-BC-2020-06/F0045/A03, para. 60-65, 68-70, 72.

<sup>194</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.3; 082136-01, min.00:06:54-00:10:28.

<sup>195</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.3; 082136-01, min.00:06:54-00:10:28. *Shih gjithashtu* 081991-04-TR-ET, f.1; 081991-04, min.00:06:23-00:07:10 ku HARADINAJ falënderoi mediat për punën që po bënin, deklaroi se shpresonte që mediat të mos e injoronin atë dhe të tjerët dhe se mediat duhej të ishin më të guximshme.

<sup>196</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 3-4; 082136-01, min.00:10:41-00:11:45.

<sup>197</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.4; 082136-01, min.00:12:02-00:12:10.

<sup>198</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.5; 082136-01, min.00:14:19-00:15:30.

<sup>199</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 6-7; 082136-01, min.00:16:57-00:17:59.

<sup>200</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.12; 082136-01, min.00:23:40-00:24:06.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

dokumenteve ishte i ndaluar me ligj dhe i dënueshëm me deri në dhjetë vjet burgim, HARADINAJ u përgjigj se nuk e dinte.<sup>201</sup> Kur personi që bëri këtë pyetje më tej deklaroi se kështu ishte ligji i DHS-së, HARADINAJ u përgjigj: “Në këtë rast po shkoj edhe unë në burg”,<sup>202</sup> duke shtuar më pas: “Tash ti je ka më tut me dhjetë vjet. 300 vjet të më japshin për qitë punë, unë e qes. Unë, unë, jam ka foli unë edhe ne Kryesia komplet [...] Na jena të përgatitun 300-vjet [...] Ne jemi kanë të përgatitun me vdek.”<sup>203</sup>

75. Të pyetur nëse në dokumente ishte përmendur edhe [REDAKTUAR], GUCATI dhe HARADINAJ deklaruan se personi i cili bëri pyetjen e kishte dokumentin dhe lirisht mund ta lexonte.<sup>204</sup>

76. Aty nga fundi i konferencës së tretë për shtyp, ndërsa personat e pranishëm u afruan tek tryeza e folësve ku ishin vendosur dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë, GUCATI tha se ishte kopja e dokumentit, një person tjetër tha se kishin marrë një kopje dhe një i tretë kërkoi një kopje.<sup>205</sup> Një numër personash u mblodhën rreth dokumenteve të nxjerra gjatë herës së tretë dhe bënë fotografi të tyre.<sup>206</sup>

77. HARADINAJ deklaroi se personi që kishte sjellë dokumentet kishte lënë porosinë se më tej do të sillte CD.<sup>207</sup> Ai deklaroi se ai dhe të tjerët e mirëprisnin atë, se OVL-UÇK-ja do të publikonte çdo gjë që do të merrte, se ata nuk mbanin përgjegjësi në lidhje me këtë.<sup>208</sup> HARADINAJ deklaroi se nuk do ta zbulonte identitetin e personit

<sup>201</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.12; 082136-01, min.00:24:06-00:24:10.

<sup>202</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.12; 082136-01, min.00:24:11-00:24:15.

<sup>203</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.13; 082136-01, min.00:24:44-00:25:16.

<sup>204</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 13-14; 082136-01, min.00:25:43-00:25:54.

<sup>205</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.15; 082136-01, min.00:26:46-00:26:59.

<sup>206</sup> 082136-01, min.00:26:45-00:27:18.

<sup>207</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 2-3; 082136-01, min.00:06:54-00:10:28.

<sup>208</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 2-3; 082136-01, min.00:06:54-00:10:28; *Shih gjithashtu* 082106-03-TR-ET, f. 2-4; 082106-03, min.00:01:33-00:04:16.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

që i kishte sjellë dokumentet OVL-UÇK-së, edhe sikur personi të mos mbante maskë.<sup>209</sup>

78. Kur u pyet nëse anëtarët e personelit të ZPS-së, në rastet e mëparshme kur kishin sekuestruar dokumentet nga OVL-UÇK-ja i kishin kërkuar HARADINAJT të mos ua jepte dokumentet mediave, HARADINAJ u përgjigj se ata persona nuk donin që media të informohej për dokumentet.<sup>210</sup>

F. Ngjarjet që pasuan konferencën e tretë për shtyp

79. Pak orë pas konferencës të tretë për shtyp, në prani të GUCATIT, HARADINAJT, KLINAKUT dhe të tjerëve, ZPS-ja i dorëzoi Tomë Gashit një urdhër të lëshuar nga ZPS-ja që udhëzonte GUCATIN dhe/ose OVL-UÇK-në të dorëzonin të gjitha dokumentet e ZPS-së dhe të mos incizonin, kopjonin dhe shpërndanin më tej ato dokumente.<sup>211</sup> HARADINAJ nënshkroi një dokument për pranim-dorëzimin e urdhrin në prani të GUCATIT dhe të tjerëve.<sup>212</sup> Anëtarët e personelit të ZPS-së morën dokumentet që përfshiheshin në dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë (“paketa 3”).<sup>213</sup>

80. Gjatë dorëzimit të dokumenteve, HARADINAJ u tha anëtarëve të personelit të ZPS-së se kur personi i panjohur kishte ardhur, dy oficerë të KFOR-it gjerman ishin në takim në selinë e OVL-UÇK-së dhe një nga oficerët kishte bërë fotografi të dokumenteve të dorëzuara nga njeriu i panjohur.<sup>214</sup> HARADINAJ deklaroi gjithashtu se ndërsa u kishte hedhur një sy shkurtimisht dokumenteve, kishte parë emrat e

<sup>209</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.10; 082136-01, min.00:21:28-00:21:38.

<sup>210</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.6; 082136-01, min.00:16:18-00:16:45.

<sup>211</sup> 082014-082016; SPOE00220914-00220914 (Urdhër i ZPS-së); *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00010/A01.

<sup>212</sup> 082014-082016, f.082015, par. 12; SPOE00220915-00220915; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00010/A01.

<sup>213</sup> 082014-082016, f.082016, para.17; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00010.

<sup>214</sup> 082014-082016, f.082015, para.6; *Shih gjithashtu* 093457-093458 (093457-093458-ET).



KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

[REDAKTUAR].<sup>215</sup> KLINAKU deklaroi se më herët gjatë po asaj dite, ai u kishte dërguar një mesazh elektronik të gjitha mediave të Kosovës, për mbajtjen e një konference për shtyp, pa përmendur arsyen.<sup>216</sup> GUCATI vlerësoi se në këtë konferencë për shtyp kishin marrë pjesë gazetarë nga 20-25 media të ndryshme.<sup>217</sup> GUCATI dhe HARADINAJ deklaruan se në fund të konferencës për shtyp, për afërsisht 5 minuta, disa nga gazetarët fotografuan faqet e para dhe disa faqe të tjera të katër grumbujve me dokumente të sjella nga personi i panjohur.<sup>218</sup>

81. Paketa 3 përfshin dy kopje jo të plota të një dokumenti konfidencial të ZPS-së që ka të bëjë me hetimet dhe procedurat zyrtare të ZPS-së, [REDAKTUAR].<sup>219</sup> Aty përfshihet një analizë e disa provave të caktuara ekzistuese dhe e dispozitave ligjore përkatëse [REDAKTUAR].<sup>220</sup> Ajo përmban edhe referenca për [REDAKTUAR] dëshmitarë (të mundshëm), [REDAKTUAR].<sup>221</sup>

82. Më 22 shtator 2020 dhe gjatë ditëve në vijim, përmbajtja e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së tretë, duke përfshirë emrat e dëshmitarëve dhe provat, u shpërndanë më tej, ndër të tjera edhe në organet e shtypit e Internet.<sup>222</sup> HARADINAJ kishte deklaruar më parë se, për shkak të hezitimit të disa mediave të caktuara për të

<sup>215</sup> 082014-082016, f.082015, para. 8.

<sup>216</sup> 082014-082016, f.082015, para. 9.

<sup>217</sup> 082014-082016, f.082015, para.10.

<sup>218</sup> 082014-082016, f.082015, para. 11; *Shih gjithashtu* 082136-01, min.00:26:45-00:27:18.

<sup>219</sup> 084015-084026, f. 084019-084020, paraagrafi29; 093492-093590, f. 093493-093495, para. 7-10, shtojca 5.

<sup>220</sup> 084015-084026, f. 084019-084020, para. 29; 093492-093590, f. 093493-093495, para. 7-9.

<sup>221</sup> 084015-084026, f.084020, para.31; 093492-093590, f. 093493-093495, para. 7-9.

<sup>222</sup> 081361-081378, f. 081374-081378 (081374-081377-ET); 081381-081391 (081381-081383-ET Rishikuar), përfshirë materialin filmik 081392-01 (081392-01-TR-ET Rishikuar); 081395-081404 (081395-081398-ET), përfshirë materialin filmik 081405-01 (081405-01-TR-ET Rishikuar); 081414-081422 (081414-081415-ET), përfshirë materialin filmik 081422-01 (081422-01-TR-ET); SPOE00220819-00220826 (SPOE00220819-SPOE00220826-ET); SPOE00220827-00220829 (SPOE00220827-SPOE00220829-ET); SPOE00220830-00220837 (SPOE00220830-SPOE00220837-ET); SPOE00220845-00220850 (SPOE00220845-SPOE00220850-ET); SPOE00220851-00220857 (SPOE00220851-SPOE00220857-ET); SPOE00220858-00220865 (SPOE00220858-SPOE00220865-ET); SPOE00220866-00220871 (SPOE00220866-SPOE00220871-ET); SPOE00220872-00220872 (SPOE00220872-SPOE00220872-ET); SPOE00220873-00220878 (SPOE00220873-SPOE00220878-ET); SPOE00220879-00220885 (SPOE00220879-SPOE00220885-ET); SPOE00220886-00220888 (SPOE00220886-SPOE00220888-ET); *Shih gjithashtu* 084015-084026, f. 084021-084025, para. 36-74.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

publikuar materialet e vëna në dispozicion nga OVL-UÇK-ja, ishte e nevojshme, sipas mendimit të HARADINAJT dhe të tjerëve, që këto dokumente t'u jepeshin "mediave të huaja".<sup>223</sup> [REDAKTUAR].<sup>224</sup>

83. Gjatë një konference për shtyp me përfaqësues të mediave të ndryshme të mbajtur në selinë e OVL-UÇK-së më 22 shtator 2020, pas dorëzimit ZPS-së të dokumenteve që ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së tretë, GUCATI konfirmoi se DHS-ja kishte marrë materialin dhe deklaroi se kjo donte të thoshte që materiali ishte i DHS-së.<sup>225</sup> Gjatë të njëjtës konferencë për shtyp, GASHI pranoi se GUCATI, HARADINAJT dhe të tjerët i kishin parë dokumentet e përmendura gjatë konferencës së tretë për shtyp "për çështje të veta".<sup>226</sup> GASHI theksoi se përfaqësuesit e mediave kishin pasur mundësinë e këqyrjes së materialit që ishte pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së tretë, nëse do të kishin dashur, duke shtuar se materiali është "origjinal", dhe "duket që është material me ndjeshmëri të lartë, ku ka të bëjë me hetimin penal të personave që janë hetuar nga Gjykata për vite të tëra".<sup>227</sup>

84. GASHI deklaroi se besonte që "kryetari, zoti GUCATI, zoti HARADINAJT dhe të tjerë kanë thënë gjithmonë se çfarëdo që të bjerë, a kushdo që t'i sjellë këtu, do t'i bëjnë publike, në kuptimin që opinionin shqiptar kudo që të jemi dhe të jenë, ta marrë vesh se çfarë është duke ndodhur me Dhomat e Specializuara", duke shtuar se "ne mendojmë që në të ardhmen, nëse aktakuzat e ngritura kundër pjesëtarëve të UÇK-së të konfirmohen, atëherë mund të jenë materiale që mund të përdoren dhe mund të dëmtohet dhe të sulmohet kredibiliteti i Dhomave të Specializuara".<sup>228</sup> GASHI pranoi

<sup>223</sup> 081979-08-TR-ET, f.2; 081979-08, min.00:04:24-00:05:16.

<sup>224</sup> 081381-081391 (081381-081383-ET Rishikuar), përfshirë materialin filmik 081392-01 (081392-01-TR-ET Rishikuar); 081395-081404 (081395-081398-ET), përfshirë materialin filmik 081405-01 (081405-01-TR-ET Rishikuar); 081414-081422 (081414-081415-ET), përfshirë materialin filmik 081422-01 (081422-01-TR-ET).

<sup>225</sup> 081931-01-TR-ET, f. 1-2; 081931-01, min.00:01:06-00:01:31.

<sup>226</sup> 081931-01-TR-ET, f.3; 081931-01, min.00:07:18-00:08:24.

<sup>227</sup> 081931-01-TR-ET, f.2; 081931-01, min.00:01:31-00:04:33.

<sup>228</sup> 081931-01-TR-ET, f.2; 081931-01, min.00:01:31-00:04:33; *Shih gjithashtu* 081931-01-TR-ET, f. 2-3, 081931-01, min.00:04:42-00:06:21.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

se gjatë konferencës së tretë për shtyp, HARADINAJ kishte përmendur emra dhe mbiemra të personave nën hetim që përmendeshin në dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë.<sup>229</sup> GASHI gjithashtu deklaroi se premtimi i OVL-UÇK-së “është gjithmonë, çfarëdo që marrin në raport me Dhomat e Specializuara, do ta njoftojnë opinionin sepse ne jemi kundër kësaj Gjykate”.<sup>230</sup>

85. Në të njëjtën konferencë për shtyp, HARADINAJ pretendoi se përfaqësuesit e ZPS-së kishin marrë çdo gjë më herët atë ditë sepse media nuk kishte marrë ndonjë kopje.<sup>231</sup> HARADINAJ deklaroi se ai dhe të tjerët u kishin thënë përfaqësuesve të ZPS-së se media “kanë shfletu” dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë, por “s’guxuan” me marrë kopje dhe se në konferencën e tretë për shtyp kishin marrë pjesë përfaqësues të më shumë se 25 mediave.<sup>232</sup> Gjithashtu, GASHI deklaroi se përfaqësuesit e mediave i kishin parë dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë, por nuk kishin marrë kopje të tyre.<sup>233</sup>

86. Gjatë një interviste më 22 shtator 2020, GUCATI deklaroi se personi i panjohur i cili kishte sjellë dokumentet në OVL-UÇK, u kishte thënë që në ditët në vijim do të dërgonte edhe CD të ndryshme me materiale; GUCATI deklaroi se OVL-UÇK-ja do t’i publikonte dokumente të tilla që t’u tregonte opinionit kosovar dhe shqiptarëve mbarë rruzullit tokësor se DHS-ja bashkëpunon me autoritetet serbe duke shtuar se ishte me rëndësi që t’i bindnin qytetarët e Kosovës dhe t’u tregonin që kjo Gjykatë është pa vlerë.<sup>234</sup>

87. Gjatë një interviste tjetër atë ditë, GUCATI, deklaroi se ishte e padrejtë që ai dhe të tjerë akuzoheshin se po tentonin të minonin administrimin e drejtësisë dhe se ai dhe të tjerët kishin ruajtur çdo emër të përmendur në dokumente dhe kishin mundësuar

---

<sup>229</sup> 081931-01-TR-ET, f.3; 081931-01, min.00:07:18-00:08:24.

<sup>230</sup> 081931-01-TR-ET, f.4; 081931-01, min.00:09:45-00:13:18.

<sup>231</sup> 081931-01-TR-ET, f.7; 081931-01, min.00:17:43-00:18:05.

<sup>232</sup> 081931-01-TR-ET, f.7; 081931-01, min.00:17:43-00:18:05.

<sup>233</sup> 081931-01-TR-ET, f.7; 081931-01, min.00:18:05-00:18:06.

<sup>234</sup> 082106-02-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 082106-02, min.00:03:29-00:04:17.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

që të ishin të ruajtur.<sup>235</sup> Ai deklaroi se ai dhe të tjerët e dinin se nuk kishin shkelur ligjin, sepse nuk kishin treguar emrat dhe mbiemrat e dëshmitarëve, kishin treguar vetëm dokumentacionin.<sup>236</sup>

88. GUCATI deklaroi se dokumentet e marra nga OVL-UÇK-ja përmbanin vula zyrtare, numra protokolli, nënshkrime të prokurorëve ndërkombëtarë dhe emblemën e DHS-së.<sup>237</sup> I pyetur nga një gazetar se pse po vazhdonin t'i publikonin këto dokumente, GUCATI deklaroi se ai vazhdon të publikojë dokumente sepse ai dhe të tjerët donin të tregonin realitetin dhe ata ishin në konflikt me DHS-në për tre vjet sepse DHS-ja është duke bashkëpunuar ngushtë me autoritetet e Serbisë.<sup>238</sup> GUCATI theksoi se ai dhe të tjerët kanë protestuar kundër DHS-së që prej krijimit të saj më 2015.<sup>239</sup> GUCATI deklaroi se do t'i publikonte të gjitha dosjet që mund t'i vinin dhe ai e të tjerët janë kundër DHS-së sepse është raciste, e njëanshme dhe nuk vlente fare, duke theksuar se ruajtja e dokumenteve nuk ishte detyrë e tij.<sup>240</sup> GUCATI deklaroi se dokumentet i kishin ardhur në zyrë dhe përgjegjësi e tij ishte të minonte DHS-së.<sup>241</sup> Ai shtoi se nëse do të ishte e mundshme për atë dhe të tjerët, ata do ta hiqnin dhe do ta shpërbënin DHS-në.<sup>242</sup>

89. I pyetur nëse konsideronte se ai kishte ndonjë përgjegjësi lidhur me çfarë ndodhi duke pasur parasysh faktin që ai publikoi dokumentet, GUCATI deklaroi se ai dhe të tjerët nuk kishin përgjegjësi sepse nuk kishin bërë publik emra dëshmitarësh dhe nuk kishin deklaruar çfarë shkruhej në dokumente.<sup>243</sup> I pyetur nëse do të pendohej për publikimin e dokumenteve nëse do të kishte pasoja penale, GUCATI deklaroi se nuk

<sup>235</sup> 082106-01-TR-ET, f. 1-2; 082106-01, min.00:00:00-00:03:08.

<sup>236</sup> 082106-01-TR-ET, f.2; 082106-01, min.00:00:00-00:03:08.

<sup>237</sup> 082106-01-TR-ET, f.14; 082106-01, min.00:17:50-00:19:36.

<sup>238</sup> 082106-01-TR-ET, f.2; 082106-01, min.00:01:36-00:03:08.

<sup>239</sup> 082106-01-TR-ET, f.2; 082106-01, min.00:01:36-00:03:08.

<sup>240</sup> 082106-01-TR-ET, f. 7-8; 082106-01, min.00:08:55-00:10:20.

<sup>241</sup> 082106-01-TR-ET, f. 8-9; 082106-01, min.00:10:20-00:13:16.

<sup>242</sup> 082106-01-TR-ET, f.11; 082106-01, min.00:14:47-00:16:12.

<sup>243</sup> 082106-01-TR-ET, f. 10-11; 082106-01, min.00:13:16-00:14:47.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

do t'i vinte aspak keq edhe sikur të dënohej me pesë vjet burgim.<sup>244</sup> GUCATI deklaroi se ai dhe të tjerët nuk dinin si mund t'i akuzonte DHS-ja, si mund të ngrinte aktakuzë kundër tyre kur ata nuk kishin nxjerrë asnjë emër dëshmitari.<sup>245</sup>

90. Gjatë një programi televiziv i cili u transmetua më 22 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se ai dhe të tjerët ua kishin dhënë mediave të gjitha dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë.<sup>246</sup> I pyetur nga një gazetar nëse kishte mbajtur kopje të dokumenteve të nxjerra për herë të tretë, HARADINAJ u përgjigj se nuk kishte mbajtur dhe ai e të tjerët po ua jepnin dokumentet personave të pranishëm.<sup>247</sup> Kur u pyet nëse dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë po mbaheshin në arkivat e OVL-UÇK-së, HARADINAJ deklaroi se jo, sepse media ishte forca e katërt në Kosovë dhe se OVL-UÇK-ja mbështetej te media, duke shtuar se OVL-UÇK-ja ua dha dokumentet mediave që kishin arkivuar sa kishin dashur dhe se mediat mund të merrnin sa dokumente të donin.<sup>248</sup> HARADINAJ deklaroi se nëse mediat nuk kishin marrë aq kopje të dokumenteve sa kishin dashur nga OVL-UÇK-ja, mediave duhej t'u vinte turp<sup>249</sup>, dhe se ai shpresonte që OVL-UÇK-së mos t'i kishte shkuar munda dëm sepse OVL-UÇK-ja mendonte se duke ua dorëzuar dokumentet mediave, mediat do t'i ruanin dokumentet.<sup>250</sup> HARADINAJ deklaroi se OVL-UÇK-ja gjithmonë ka qenë dhe është kundër Gjykatës dhe do të bëjnë çdo gjë që ta diskreditojnë këtë gjykatë raciste, selektive, politike.<sup>251</sup> Ai deklaroi se e rëndësishme ishte që materiali i ardhur në OVL-UÇK dekonspiron punën pesëvjeçare të Gjykatës.<sup>252</sup> I pyetur se çfarë donte ai që të

---

<sup>244</sup> 082106-01-TR-ET, f.12; 082106-01, min.00:14:47-00:16:12.

<sup>245</sup> 082106-01-TR-ET, f. 12-13; 082106-01, min.00:16:12-00:17:50.

<sup>246</sup> 082106-03-TR-ET, f. 3-4; 082106-03, min.00:01:33-00:04:16.

<sup>247</sup> 082106-03-TR-ET, f.5; 082106-03, min.00:04:16-00:06:36.

<sup>248</sup> 082106-03-TR-ET, f. 5-6; 082106-03, min.00:05:34-00:06:36.

<sup>249</sup> 082106-03-TR-ET, f. 5-7; 082106-03, min.00:05:34-00:07:28.

<sup>250</sup> 082106-03-TR-ET, f. 8-9; 082106-03, min.00:08:22-00:09:39.

<sup>251</sup> 082106-03-TR-ET, f.15; 082106-03, min.00:15:02-00:18:18.

<sup>252</sup> 082106-03-TR-ET, f. 17-18; 082106-03, min.00:21:08-00:22:51.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

bënte media, HARADINAJ deklaroi se ai donte që mediat të publikonin sa dokumente të guxonin.<sup>253</sup>

91. Prezantuesi i një programi tjetër televiziv në të cilin HARADINAJ mori pjesë më 22 shtator 2020 theksoi se HARADINAJ kishte përmendur disa emra më herët atë ditë dhe HARADINAJ u përgjigj se kishte përmendur një emër dhe se do ta përmendte atë emër sërish, duke deklaruar: “është [REDAKTUAR], ja kam pa emrin”.<sup>254</sup> HARADINAJ deklaroi që materiali po publikohej i konvenonte atij dhe të tjerëve sepse vërtetonte atë që kishin thënë gjithmonë në lidhje me bashkëpunimin e Gjykatës me serbët<sup>255</sup> dhe, duke iu referuar DHS-së tha se “edhe rrjedhja e dosjeve, [ishte] diskreditim [për] ta”.<sup>256</sup>

92. Duke iu drejtuar një gazetari i cili deklaroi se nuk i kishte dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë, HARADINAJ deklaroi se në konferencën e shtypit, dokumentet ishin në tavolinë që gazetari t’i merrte dhe gazetari mund t’i kishte marrë.<sup>257</sup> HARADINAJ deklaroi se OVL-UÇK-ja nuk i publikoi dokumentet sepse media është “forca e katërt në këtë shtet”, dhe kur prezantuesi i programit tha se publikimi i dokumenteve do të ishte kundërligjshëm, HARADINAJ u përgjigj me pyetjen se pse duhej t’i publikonte ai e nëse prezantuesi donte që ai të shkelte ligjin.<sup>258</sup>

93. Gjatë një programi televiziv më 24 shtator 2020, KLINAKU tha se shpërndarja e dokumenteve ishte një skandal për DHS-në,<sup>259</sup> pranoi se ai dhe të tjerë kishin publikuar emrin e VUKÇEVIÇIT<sup>260</sup> dhe e quajti DHS-në “pseudo-Gjykata Speciale”.<sup>261</sup>

<sup>253</sup> 082106-03-TR-ET, f. 20-21; 082106-03, min.00:24:30-00:25:41.

<sup>254</sup> 081358-03-TR-ET Rishikuar, f.30; 081358-03, min.00:39:20-00:39:58.

<sup>255</sup> 081358-03-TR-ET Rishikuar, f. 3-6; 081358-03, min.00:04:16-00:05:55.

<sup>256</sup> 081358-03-TR-ET Rishikuar, f.56; 081358-03, min.01:14:00-01:14:06.

<sup>257</sup> 081358-03-TR-ET Rishikuar, f. 7-8; 081358-03, min.00:10:54-00:12:41.

<sup>258</sup> 081358-03-TR-ET Rishikuar, f. 28-29; 081358-03, min.00:37:46-00:38:13.

<sup>259</sup> 081981-02-TR-ET Rishikuar, f.2; 081981-02, min.00:07:53-00:07:56.

<sup>260</sup> 081981-02-TR-ET Rishikuar, f.6; 081981-02, min.00:10:04-00:10:07.

<sup>261</sup> 081981-02-TR-ET Rishikuar, f.7; 081981-02, min.00:10:57-00:11:04.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

94. Gjatë një interviste më 25 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi: “Detyra e tyne është t’i ruajn sekretet e veta. Nuk i kam faj unë atje pse kanë shti ata njerëz pa shkollë, kanë shti naiva, dhe kan rrejt kta naivat tonë që ne e mbajmë sekretin. Asht dasht me i rujt ata arkivat e veta”.<sup>262</sup> HARADINAJ gjithashtu deklaroi: “Sa të jetojmë e të jemi me frymë ne jemi kundër kësaj gjykate. Fund. Kena me punu kundër kësaj gjykate. Fund {...} Ne na i ka prit ai që na i ka sjell ato. Ishallah na bjen apet”, duke shtuar se kjo nuk do të thoshte se vetëm HARADINAJ, GUCATI, ose KLINAKU do t’i jepnin dokumente medias, meqenëse edhe anëtari me rang më të ulët i UÇK-së mund ta bënte këtë dhe se: “Kemi me e qit në media”.<sup>263</sup>

95. Gjatë një interviste tjetër më 25 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se ai nuk do t’i zbatonte urdhrat e kësaj Gjykate dhe nuk e njihte dhe se ai dhe të tjerë kishin detyrë të punonin kundër Gjykatës.<sup>264</sup> Pa asnjë pendim të dukshëm, pak para arrestimit të tij, HARADINAJ deklaroi se nëse do të merrte më shumë dokumente, ai do t’ia jepte medias.<sup>265</sup>

### **III. Të akuzuarit kryen veprat penale të përshkruara në Aktakuzë**

96. Pjesët e paraqitura më poshtë shtjellojnë secilën pikë të Aktakuzës<sup>266</sup> sipas renditjes së paraqitjes në të.

#### A. *Të akuzuarit, me anë të kërcënimit të rëndë, penguan personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Pika 1)*

97. Provat e parashtruara në paraqitjen e fakteve,<sup>267</sup> siç shtjellohet në Pikat 2-6,<sup>268</sup> të Aktakuzës vërtetojnë se midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të akuzuarit dhe

<sup>262</sup> 081931-04-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081931-04, min.00:03:24-00:04:59.

<sup>263</sup> 081931-04-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081931-04, min.00:03:24-00:04:59.

<sup>264</sup> 081991-03-TR-ET Rishikuar, f. 2, 4-5; 081991-03, min.00:06:32-00:07:30, 00:09:29-00:10:50.

<sup>265</sup> 081991-03-TR-ET Rishikuar, f. 4-5; 081991-03, min.00:09:29-00:10:50.

<sup>266</sup> KSC-BC-2020-07/F00075/A01 (“Aktakuza”).

<sup>267</sup> *Shih* Pjesa II.

<sup>268</sup> *Shih* Pjesa III B-F.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

ndihmësit e tyre, ndër të cilët Faton KLINAKU, sekretar i OVL-UÇK-së, dhe Tomë GASHI, këshilltar ligjor i OVL-UÇK-së, përmes veprimeve të përshkruara në Aktakuzë, të cilat të marra veçmas apo bashkërisht, përbënin kërcënime të rënda, penguan ose tentuan të pengonin procedurat e DHS-së. Këto veprime u kryen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me anë të kërcënimeve të rënda të drejtuara ndaj ZPS-së dhe në mënyrë të tërthortë, me anë të kërcënimeve të rënda ndaj dëshmitarëve dhe të tjerëve, ndaj zyrtarëve të ZPS-së, duke përfshirë prokurorët, hetuesit dhe anëtarët e tjerë të personelit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare, konkretisht hetimeve penale në vazhdim të ZPS-së. Më tej, në përputhje me synimin e tyre të deklaruar,<sup>269</sup> veprimet e GUCATIT dhe HARADINAJT u drejtuan gjithashtu kundër zyrtarëve të DHS-së, duke përfshirë gjykatës dhe të tjerë.

98. Në veçanti, provat tregojnë se gjatë tri konferencave për shtyp,<sup>270</sup> në organizimin e të cilave morën pjesë të akuzuarit dhe KLINAKU, në mbi pesëmbëdhjetë paraqitje në media në lidhje me dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë, herës së dytë dhe/ose herës së tretë, në të cilat morën pjesë të akuzuarit, KLINAKU dhe/ose GASHI, në disa raste së bashku, dhe në postimet e bëra në mediat sociale, të akuzuarit në mënyrë të përsëritur vunë në dispozicion të përfaqësuesve të shtypit, teleshikuesve dhe publikut informacionin konfidencial<sup>271</sup>, dhe/ose përmendën përmbajtjen e tij, duke përfshirë identitetet, të dhënat personale dhe dëshmitë e dëshmitarëve.<sup>272</sup>

<sup>269</sup> *Shih* Pjesa II A(i)(b).

<sup>270</sup> Termi “Tri konferencat për shtyp” i referohet konferencave për shtyp të mbajtura në selinë e OVL-UÇK-së më 7, 16 dhe 22 shtator 2020, të përshkruara në transkriptet 081344-01, 089984-02, 081344-02, 089984-01, 082136-01 dhe 081344-03.

<sup>271</sup> Dokumentet konfidenciale dhe jopublike të shpërndara gjatë nxjerrjes së parë, të dytë dhe të tretë të dokumenteve më tej do të përmenden si “informacioni konfidencial”.

<sup>272</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-3; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30; 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 1-3; 081344-02, min.00:00:01-00:02:31; 081979-07-TR-ET, f. 2-3; 081979-07, min.09:30-11:01, 24:45-25:32; 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f. 1-2; 082106-06, min.00:00:19-00:03:50; 081979-08-TR-ET, f. 1, 3-4; 081979-08, min.00:00:13-00:01:49, 00:06:33-00:08:53; 081979-05-TR-ET, f. 6-7; 081979-05, min.00:14:21-00:17:28; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 1-3; 082136-01, min.00:03:15-00:10:28; 081358-03-TR-ET Rishikuar, f. 29-30; 081358-03, min.00:39:20-00:39:58; 082014-082016, f.082015, para. 9-11; 093457-093458 (093457-093458-ET); 081358-01-TR-ET, f. 5-8; 081358-01, min.00:59:42-01:03:52; Pjesa II, para. 55, 59, 66; *Shih gjithashtu*: (i) SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220752 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET,



KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

99. Më tej, të akuzuarit kërcënuan në mënyrë të përsëritur se do të vazhdonin të shpërndanin informacionin e hetimeve konfidenciale, duke përfshirë identitetet e dëshmitarëve, dhe se do të pengonin zbatimin e mandatit të DHS/ZPS-së.<sup>273</sup> Ata u përpoqën të mundësonin shpërndarjen më të madhe të mundshme të informacionit konfidencial dhe ushtruan trysni të vazhdueshme ndaj mediave për të vijuar me publikimin e tij.<sup>274</sup> Të akuzuarit dhe GASHI lavdëruan publikisht burimet e pidentifikuara që i dhanë dokumentet OVL-UÇK-së dhe/ose mirëpritën nxjerrje të tjera dokumentesh nga këto burime në të ardhmen.<sup>275</sup>

100. Gjithashtu, të akuzuarit dhe GASHI bënë komente nënçmuese dhe/ose kërcënime ndaj dëshmitarëve.<sup>276</sup> Të akuzuarit bënë të qartë se dokumentet që ata po bënin

---

f.SPOE00220752) që tregon se HARADINAJ nxori një lidhje me incizimin e një programi televiziv ku ai ishte i ftuar dhe gjatë të cilit ai deklaroi se ndërmjet dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë ishte edhe informacioni nga [REDAKTUAR], 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f.8; 081991-01, min.00:14:24-00:15:51; dhe (ii) SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220731 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220731) që tregon se HARADINAJ nxori një lidhje me incizimin e një programi televiziv ku ai ishte i ftuar dhe gjatë të cilit ai deklaroi se dokumentet tregonin se [REDAKTUAR], të cilin HARADINAJ e përshkroi si [REDAKTUAR], ishte përfshirë në marrjen e “dëshmive” nga dëshmitarët në emër të ZPS-së, 081979-05-TR-ET, f. 2-3; 081979-05, min.00:02:10-00:06:38.

<sup>273</sup> 081979-11-TR-ET Rishikuar, f. 3-5; 081979-11, min.00:06:03-00:06:55, 00:09-41-00:11:53; 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 2-4; 081344-02, min.00:02:40-00:09:49; 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f.4; 081355-02, min.00:24:40-00:25:12; 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.3; 081347-01, min.00:02:27-00:03:57; 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f. 3-4; 081355-04, min.00:32:59-00:34:11; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 1-3; 082136-01, min.00:03:15-00:11:45; 081991-03-TR-ET Rishikuar, f. 4-5; 081991-03, min.00:09:29-00:10:50.

<sup>274</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 5-6, 11-13; 082136-01, min.00:14:19-00:15:30, 00:23:40-00:25:41; 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 3, 10; 081991-01, min.00:04:44-00:05:37, 00:20:23-00:21:06; 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f.3; 082106-06, min.00:05:02-00:07:52; 081979-08-TR-ET, f.2; 081979-08, min.00:04:24-00:05:16; 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.8; 081347-01, min.00:17:26-00:17:40; SPOE00220800-00220800 (SPOE00220800-SPOE00220800-ET); 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f. 6, 15; 081355-02, min.00:27:21-00:27:53, 00:35:33-00:35:48; 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f.21; 081355-04, min.00:44:46-00:45:53; *Shih gjithashtu* 081358-03-TR-ET Rishikuar, f. 4-5; 081358-03, min.00:05:55-00:07:34; 081931-02-TR-ET Rishikuar, f.1; 081931-02, min.00:12:22-00:12:49.

<sup>275</sup> 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f.4; 081355-02, min.00:24:40-00:25:12; 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f. 3-4; 081355-04, min.00:32:59-00:33:30; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 2-3, 7-8; 082136-01, min.00:06:54-00:10:28, 00:19:14-00:19:30; 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f.7; 081991-01, min.00:13:54-00:15:51; 082106-07-TR-ET Rishikuar, f.2; 082106-07, min.00:06:24-00:08:04; 082106-01-TR-ET, f. 12-13; 082106-01, min.00:16:12-00:17:50; 082106-04-TR-ET Rishikuar, f.2; 082106-04, min.0:28:46-0:30:37; 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 4-5; 081355-03, min.00:08:26-00:09:47.

<sup>276</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-6; 081344-01, min.00:01:26-00:09:09, 00:11:27-00:13:16; 081358-01-TR-ET, f. 6-7, 9-13; 081358-01, min.01:01:00-01:02:33, 01:05:00-01:10:49; 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f. 7, 11, 26; 081355-04, min.00:34:48-00:35:22, 00:38:39-00:38:51, 00:50:33-00:51:07; 081355-03-TR-ET

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

publike përmbanin emra konkretë dëshmitarësh, vendbanimet e tyre si dhe të dhëna të tjera personale<sup>277</sup> dhe se tani njerëzit do të mësonin se kush ishin dëshmitarët.<sup>278</sup>  
Këtij kërcënimi i bëri jehonë edhe GASHI.<sup>279</sup>

101. Për shkak të ndikimit ose ndikimit të mundshëm të veprimeve të të akuzuarve ndaj dëshmitarëve, u vu në rrezik aftësia e ZPS-së për hetimin dhe ndjekjen penale të efektshme të veprave penale, përfshirë nëpërmjet marrjes dhe ruajtjes së provave të rëndësishme. Në veçanti, dëshmitarët u ndjenë të kërcënuar dhe frikësuar si rezultat i veprimeve të të akuzuarve,<sup>280</sup> dhe ZPS-së devijoi kapacitete e kohë për trajtimin e pasojave aktuale dhe të mundshme, duke përfshirë dëshmitarët dhe procedurat e DHS-së.<sup>281</sup>

---

Rishikuar 1, f. 5-6; 081355-03, min.00:09:48-00:10:22; *Shih gjithashtu* 089185-06-TR-ET, f.1; 089185-06 min.08:01-08:54.

<sup>277</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-6; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30, 00:09:43-00:13:16; 081358-01-TR-ET, f. 6-8; 081358-01, min.01:01:00-01:03:52; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 2-3; 082136-01, min.00:06:54-00:10:28.

<sup>278</sup> 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f. 11, 26, 30-31; 081355-04, min.00:38:39-00:38:51, 00:50:33-00:51:07, 00:59:42-00:59:50; 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 3-4; 081344-01, min.00:06:31-00:09:09.

<sup>279</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 5, 8-9; 081355-03, min.00:09:48-00:10:22, 00:15:33-00:16:08; 081931-01-TR-ET, f.2; 081931-01, min.00:01:31-00:04:33.

<sup>280</sup> *Shih* Pjesën III D.

<sup>281</sup> 084008-084010; 090142-090143; 078313-078315 RED; 082102-082103 RED; 083959-083960 RED; 084231-084231 RED; 084232-084233 RED; 084236-084242 RED; 084243-084244 RED; 084245-084246 RED; 084247-084248 RED; 084249-084250 RED; 085880-085883 RED; 088300-088300 RED; 088301-088301 RED; 088302-088302 RED; 088303-088303 RED; 088304-088304 RED; 089196-089196 RED; 089908-089908 RED; 089909-089909 RED; 089910-089910 RED; 089934-089935 RED; 089936-089937 RED; 089938-089939 RED; 089940-089941 RED; 089942-089943 RED; 089944-089945 RED; 089946-089947 RED; 089948-089949 RED; 089950-089950 RED; 089951-089952 RED; 089953-089954 RED; 089955-089956 RED; 089988-089988 RED; 089989-089989 RED; 089990-089990 RED; 089991-089992 RED; 089997-090000 RED; 090001-090003 RED; 090004-090005 RED; 090006-090007 RED; 090024-090024 RED; 090025-090025 RED; 090026-090026 RED; 090028-090028 RED; 090031-090031 RED; 090033-090033 RED; 090040-090040 RED; 090041-090042 RED; 090048-090048 RED; 090049-090049 RED; 090050-090051 RED; 090052-090053 RED; 090054-090055 RED; 090056-090057 RED; 090058-090059 RED; 090062-090063 RED; 090066-090067 RED; 090121-TR-ET Pjesa 1 RED; 090125-TR-ET Pjesa 1 RED; 090125-TR-ET Pjesa 2 RED; 090128-TR-ET Pjesa 1 RED; 090131-TR-ET Pjesa 1 RED; 090134-TR-ET Pjesa 1 RED; 090138-TR-ET Pjesa 1 RED; 090138-TR-ET Pjesa 2 RED; 090141-TR-ET Pjesa 1 RED; 090175-090176 RED; 090177-090177 RED; 090178-090179 RED; 090263-090263 RED; 090264-090264 RED; 091203-091203 RED; 091216-091217 RED; 091813-091814 RED; 091815-091816 RED; 091817-091818 RED; 091819-091820 RED; 091821-091822 RED; 091823-091825 RED; 091826-091827 RED; 091828-091829 RED; 091830-091831 RED; 091832-091833 RED; 091834-091835 RED; 091836-091837 RED; 091838-091839 RED; 091840-091841 RED; 091842-091843 RED; 091844-091845 RED; 091846-091847 RED; 091848-091849 RED; 091850-091851 RED; 091852-091853 RED; 091854-091855 RED; 091856-091858 RED;

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

*i. Të akuzuarit i kryen veprimet e tyre me synimin e nevojshëm*

102. Faktorët e mëposhtëm demonstrojnë vetëdijen dhe dëshirën e të akuzuarve për të përdorur kërcënimin e rëndë për të penguar personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare. Si alternativë, këta faktorë tregojnë se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm, që, veprimet e tyre mund të pengonin personat zyrtarë në kryerjen e detyrave të tyre zyrtare dhe se ata u pajtuan me shkaktimin e kësaj pasoje të ndaluar me ligj.

*a. Të akuzuarit shpërndanë dokumente konfidenciale dhe jopublike që përmbanin identitetet dhe të dhënat personale të dëshmitarëve, dhe i bënë publike këto identitete dhe të dhëna*

103. Veprimet e të akuzuarve ndërmjet datave 7 dhe 25 shtator 2020, siç shtjellohet në paraqitjen e fakteve, tregojnë qartë se ata shpërndanë informacionin konfidencial që përmbante identitetet dhe të dhënat personale të dëshmitarëve dhe i bënë publike këto identitete dhe të dhëna. Praktika e njëjtë e sjelljes bën të qartë se veprimet e tyre ishin të qëllimshme gjatë gjithë kohës. Vetë HARADINAJ pranoi se nëse ai dhe të tjerët do të kishin dashur, ata nuk do t'i kishin bërë publike dokumentet.<sup>282</sup>

*b. Të akuzuarit deklaruan publikisht synimin e tyre për të penguar punën e DHS/ZPS-së me anë të publikimit të dokumenteve*

104. Të akuzuarit dhe të tjerët e bënë të qartë synimin e tyre për të penguar punën e DHS/ZPS-së shumë kohë përpara shtatorit 2020.

105. Në dhjetor 2017, u raportua se GUCATI konfirmoi se OVL-UÇK-ja kishte mbledhur nënshkrime nga qytetarët për t'i paraqitur një kërkesë Kuvendit për të

---

091865-091866 RED; 091867-091867 RED; 091899-091900 RED; 091901-091901 RED; 091902-091902 RED; 091903-091903 RED; 091904-091905 RED; 091906-091906 RED; 091907-091908 RED; 084303-084303 RED; 089886-089886 RED; 092911-092912 RED; 092913-092913 RED; 092914-092915 RED; 092916-092917 RED; 092918-092919 RED; 092922-092924 RED; 092925-092925 RED; 092945-092945 RED; 093383-093383 RED; 093386-093387 RED; 093388-093388 RED.

<sup>282</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.8; 081344-01, min.00:16:02-00:16:11.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

ndryshuar ligjin për DHS-së; i njëjti artikull raportonte se nënshkrimet e mbledhura për këtë qëllim në fakt u përdorën për të kërkuar shfuqizimin e DHS-së.<sup>283</sup>

106. Në të njëjtin muaj, në profilin e tij në Facebook, HARADINAJ nxori një pamje që i referohej një programi televiziv ku do të diskutohej shfuqizimi i DHS-së, bashkë me një shënim i cili tregonte se ai program televiziv do të transmetohej atë mbrëmje; nën atë pamje HARADINAJ kishte komentuar se DHS-ja duhet të bjerë dhe do të bjerë.<sup>284</sup>

107. [REDAKTUAR].<sup>285</sup> [REDAKTUAR],<sup>286</sup> [REDAKTUAR].<sup>287</sup>

108. Në dhjetor 2018 dhe janar 2019, GUCATI u bëri thirrje publikisht njerëzve që të mos u përgjigjeshin fletëthirrjeve të DHS-së.<sup>288</sup>

109. Në dhjetor 2019, GUCATI deklaroi publikisht se ai dhe të tjerët do të bisedonin me grupet parlamentare për përfundimin e mandatit të DHS-së në qershor 2020 dhe theksoi se ai dhe të tjerët kishin diskutuar me persona të tjerë, duke përfshirë përfaqësuesit ligjorë të OVL-UÇK-së, lidhur me mënyrat për ta bllokuar DHS-në.<sup>289</sup>

110. Në prill të vitit 2020, HARADINAJ dhe GUCATI denoncuan një figurë publike që kishte shprehur mbështetje për hetimet e ZPS-së si “antikombëtar”<sup>290</sup> dhe si “avokat të Serbisë”,<sup>291</sup> duke lënë të kuptohet se ai merrej me spiunazh.<sup>292</sup>

111. Gjatë një programi televiziv i cili u transmetua më 24 qershor 2020, GUCATI deklaroi se lajmi për aktakuzën e paraqitur kundër THAÇIT dhe VESELIT i kishte

<sup>283</sup> SPOE00234630-00234631 (SPOE00234630-SPOE00234631-ET); *Shih gjithashtu* 082733-02-TR-ET Rishikuar, f. 3-4; 082733-02, min.01:01:38-01:03:16.

<sup>284</sup> SPOE00222243-SPOE00222244 (SPOE00222243-SPOE00222244-ET).

<sup>285</sup> SPOE00222202-00222288, f. SPOE00222241-SPOE00222242 (SPOE00222202-SPOE00222288-ET, f. SPOE00222241-SPOE00222242).

<sup>286</sup> 082014-082016, f.082015, para. 8.

<sup>287</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.3; 082136-01, min.00:06:54-00:10:28; 081358-03-TR-ET Rishikuar, f.30; 081358-03, min.00:39:20-00:39:58.

<sup>288</sup> 089185-02-TR-ET, f.1; 089185-02, min.02:35-04:12; 089185-03-TR-ET, f.1; 089185-03, min.10:23-10:57.

<sup>289</sup> 089185-05-TR-ET, f. 1-3, 089185-05, min.13:28-15:42.

<sup>290</sup> SPOE00222219-SPOE00222219 (SPOE00222219-SPOE00222219-ET).

<sup>291</sup> SPOE00222268-SPOE00222268 (SPOE00222268-SPOE00222268-ET).

<sup>292</sup> SPOE00222264-SPOE00222267 (SPOE00222264-SPOE00222267-ET).

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

befasuar atë dhe të tjerët dhe i karakterizoi aktakuzat si kryekëput politike.<sup>293</sup> Gjatë të njëjtit program, HARADINAJ konfirmoi se aktakuzat ishin ngritur dhe deklaroi se iniciativën për zhbërjen e DHS-së e kishte nisur OVL-UÇK-ja e udhëhequr nga kryesia e saj duke theksuar se kishin mbledhur më shumë se 13.000 nënshkrime në një përpjekje për ta zhbërë DHS-në.<sup>294</sup> HARADINAJ deklaroi se Gjykata ishte njëetnike dhe raciste e ata që ishin pro kësaj gjykate ishin bashkëpunëtorë, spiunë dhe tradhtarë kundër UÇK-së.<sup>295</sup>

112. Gjatë një programi tjetër televiziv më 24 qershor 2020, GUCATI theksoi se pritej që mandati i DHS-së të vazhdohej në gusht 2020, por ai dhe të tjerët do të bisedonin me deputetët e Kuvendit se si mund të arrinin të shfuqizonin DHS-në dhe të kërkonin këshillë juridike për këtë çështje.<sup>296</sup> Gjatë daljes në një program tjetër televiziv të transmetuar atë ditë, GUCATI deklaroi se gjatë 20 viteve pas luftës, ai nuk kishte dëgjuar asnjë dëshmitar në Kosovë që të dilte e të thoshte se e kishin kërcënuar.<sup>297</sup> GUCATI deklaroi se ai dhe të tjerë dinin se ka dëshmitarë jashtë vendit që kanë dalë që kanë gënjyer për me marrë dokumente në vende të tjera, duke shtuar se ka me qindra dëshmitarë të tillë.<sup>298</sup>

113. Më 25 qershor 2020, HARADINAJ përsëriti kërkesën e tij dhe të OVL-UÇK-së për zhbërjen e Gjykatës, të cilën ai e përshkroi si njëetnike dhe raciste dhe deklaroi se DHS-ja nuk ishte as një grimë më pak e dëmshme se dhënia e territoreve shteteve të tjera.<sup>299</sup>

114. Më 30 qershor 2020, HARADINAJ e quajti aktakuzën e ngritur nga ZPS-ja kundër Hashim THAÇIT “vetëm një pamflet i Gjykatës, që është jashtë normave ligjore” dhe

---

<sup>293</sup> 082733-02-TR-ET Rishikuar, f. 1-2; 082733-02, min.00:34:20-00:35:42, 00:36:02-00:36:57.

<sup>294</sup> 082733-02-TR-ET Rishikuar, f. 3-4; 082733-02, min.01:01:38-01:03:16.

<sup>295</sup> 082733-02-TR-ET Rishikuar, f. 4-5, 16-17; 082733-02, min.01:03:57-01:05:30, 01:44:49-01:45:23.

<sup>296</sup> 089185-10-TR-ET, f.1; 089185-10 min.18:48-19:33.

<sup>297</sup> 082733-01-TR-ET, f.1; 082733-01, min.0:19:57-0:21:22.

<sup>298</sup> 082733-01-TR-ET, f.1; 082733-01, min.0:19:57-0:21:22.

<sup>299</sup> 083985-01-TR-ET, f. 1-2, 083985-01 min.28:21-28:58, 36:39-37:51.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

e cilësoi “shantazh”.<sup>300</sup> HARADINAJ deklaroi se OVL-UÇK-ja do të punonte për zhbërjen e DHS-së.<sup>301</sup>

115. Gjatë konferencës së parë për shtyp, HARADINAJ deklaroi se OVL-UÇK-ja ishte befasuar për të mirë me marrjen e dokumenteve, sepse dokumentet dëshmonin se ata që kishin votuar për krijimin e gjykatës ishin faqezinj, renegatë dhe njerëzit më të dëmshëm që nuk ia donin të mirën Kosovës.<sup>302</sup> HARADINAJ deklaroi se dokumentet dëshmuan që DHS-ja është selektive, raciste dhe bashkëpunojnë më të njëjtët njerëz të cilët ishin në “aparatin e MILLOSHEVIQIT”.<sup>303</sup> Ai shtoi se për OVL-UÇK-në, DHS-ja ishte “inekzistente” dhe se Gjykata duhej të paguante çmimin.<sup>304</sup>

116. Më 8 shtator 2020, KLINAKU deklaroi se për atë dhe të tjerët DHS-ja është inekzistente dhe nuk e kanë pranuar asnjëherë.<sup>305</sup>

117. Më 11 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se sa herë t’u vinin dosje, ai dhe të tjerët do t’i bënin publike, sepse këtë detyrë kishin meqenëse nuk e njohin as Gjykatën, as ZPS-në.<sup>306</sup>

118. Gjatë konferencës së dytë për shtyp, HARADINAJ deklaroi se arsyeja e OVL-UÇK-së për nxjerrjen e dokumenteve është diskreditimi i Gjykatës.<sup>307</sup> Në lidhje me arsyen e mundshme pse dokumentet i ishin dorëzuar OVL-UÇK-së, ai deklaroi se ata kishin guximin për publikimin e tyre dhe se nuk pajtohen me Gjykatën.<sup>308</sup>

119. Gjatë një interviste më 16 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se ai dhe të tjerët kanë thënë publikisht se ata do të nxjerrin çdo material që komprometon DHS-në dhe ZPS-në, duke shtuar se ai dhe të tjerët nuk e njohin DHS-në dhe prandaj ata do ta

---

<sup>300</sup> 083985-03-TR-ET, f.2; 083985-03 min.05:34-06:43.

<sup>301</sup> 083985-03-TR-ET, f.3; 083985-03 min.07:48-08:50.

<sup>302</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-2; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30.

<sup>303</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 2-3; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30.

<sup>304</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 3, 6; 081344-01, min.00:06:31-00:09:09, 00:13:21-00:14:32.

<sup>305</sup> 081931-02-TR-ET Rishikuar, f.1; 081931-02, min.00:12:22-00:12:49.

<sup>306</sup> 081979-11-TR-ET Rishikuar, f. 3-5; 081979-11, min.00:06:03-00:06:55, 00:09-41-00:11:53.

<sup>307</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 2-4; 081344-02, min.00:02:40-00:09:49.

<sup>308</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 6-7; 081344-02, min.00:12:09-00:12:45.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

nxjerrin këtë informacion, duke theksuar “nuk është detyra jonë që të ruajmë sekretet”.”<sup>309</sup>

120. Më 17 shtator 2020, HARADINAJ u paraqit në një program televiziv gjatë të cilit ai deklaroi se edhe nëse ai dhe të tjerë do të nxirrnin ndonjë emër, çdo dëshmi ishte dhënë në trysni, nuk ishte relevante dhe nuk mund të përdoret si bazë për ngritjen e një aktakuze, prandaj i kishin bërë publike.<sup>310</sup> Gjatë një interviste që u transmetua të njëjtën ditë, HARADINAJ deklaroi se ai dhe të tjerët po i kryenin këto veprime në mënyrë që të diskreditonin profesionalizmin e pretenduar të Gjykatës.<sup>311</sup>

121. Në një konferencë për shtyp më 17 shtator 2020, GUCATI deklaroi se arsyeja pse ai dhe të tjerët do t'i bëjnë publike dokumentet ishte që të vërtetonin çfarë u kishin thënë para tri vjetësh pjesëtarëve të Ushtrisë dhe qytetarëve të Kosovës, që media dhe qytetarët të bindeshin se DHS-ja është duke bashkëpunuar me autoritetet serbe kundër pjesëtarëve të UÇK-së.<sup>312</sup> GUCATI deklaroi se ai dhe të tjerët “janë të interesu me demasku Dhomat Speciale”, duke shtuar se përmes informimit të njerëzve për materialet që i kishin ardhur, OVL-UÇK-ja do të tregojë pse është kundër DHS-së dhe se : “ne e kemi thënë me kohë që kjo Gjykatë është raciste, është e njëanshme. Për ne është e papranueshme dhe kjo është arsyeja pse ne i publikojmë të gjitha këto dokumentacione”.<sup>313</sup> GUCATI më pas lidhur me dokumentet e dorëzuara tek OVL-UÇK-ja deklaroi se ishte në interesin e tyre t'i shpërndanin sa më shumë në media, dhe të bindnin publikun dhe median se kjo Gjykatë është e papranueshme, duke theksuar se ai dhe të tjerët kanë qenë gjithmonë kundër saj.<sup>314</sup>

122. Gjatë një interviste më 18 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se ai dhe të tjerët u kishin thënë përfaqësuesve të ZPS-së që kishin sekuestruar materialin nga OVL-UÇK-

<sup>309</sup> 081979-07-TR-ET, f. 1-2; 081979-07, min.00:27-01:10.

<sup>310</sup> 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f. 25-26; 081355-02, min.00:46:29-00:47:54.

<sup>311</sup> 082106-07-TR-ET Rishikuar, f.2; 082106-07, min.00:06:24-00:08:04.

<sup>312</sup> 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.3; 081347-01, min.00:02:27-00:03:57.

<sup>313</sup> 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.8; 081347-01, min.00:15:25-00:17:19.

<sup>314</sup> 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.8; 081347-01, min.00:17:26-00:17:40.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

ja se ata nuk e njohin DHS-në.<sup>315</sup> Gjatë së njëjtës intervistë, GASHI deklaroi se personi i pidentifikuar që kishte sjellë dokumentet në selinë e OVL-UÇK-së kishte kryer një punë atdhetare, në të mirë të përgjithshme, por posaçërisht në të mirë të atyre që do të jenë të akuzuar në DHS.<sup>316</sup> Ai theksoi se dokumentacioni i sekuestruar nga ZPS-ja përbëhej nga dokumente sensitive për ZPS-në, por që sigurisht ishin shumë të favorshëm për OVL-UÇK-në dhe për cilindo që mund të kishte probleme të natyrës juridike me DHS-në duke shtuar se ato dokumente mund të përdreshin për të sulmuar besueshmërinë e DHS-së dhe të disa provave.<sup>317</sup> GASHI deklaroi se publikimi i dokumenteve do të thotë se gjykatësi duhet të mendojë edhe njëherë para se të vendosë për konfirmimin apo jo të aktakuzës ndaj Presidentit THAÇI dhe të tjerëve dhe se ai shpresonte që me ndihmën e rrjedhjeve të dokumentacionit të mos konfirmohej aktakuza kundër Presidentit THAÇI.<sup>318</sup> GASHI deklaroi se po vërtetohet teoria që nuk është mundshme të mbrohen dëshmitarët në Kosovë dhe pyeti nëse me të vërtetë po mbrohen në Hagë.<sup>319</sup>

123. Më 20 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se gjykata është “selektive” dhe “raciste” dhe se dokumentet që ai dhe të tjerët i bënë publike tregojnë se gjykata i kishte bazuar akuzat e saj mbi informacionin e siguruar prej “kriminelëve”, “gjakpirësve”.<sup>320</sup> Gjatë një programi tjetër televiziv i cili u transmetua në të njëjtën ditë, HARADINAJ deklaroi se ai dhe të tjerët do të bëjnë gjithçka që e komprometon ZPS-në sepse ata nuk e njohin ZPS-në.<sup>321</sup>

124. Më 22 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se OVL-UÇK-ja është kundër Gjykatës, ka qenë gjithmonë kundër saj dhe do të bëjë çdo gjë për ta turpëruar këtë Gjykatë

---

<sup>315</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f.3; 081355-03, min. 00:03:27-00:04:38.

<sup>316</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 4-5; 081355-03, min.00:08:26-00:09:47.

<sup>317</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 3-5; 081355-03, min.00:04:59-00:08:25.

<sup>318</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 16-17; 081355-03, min.00:27:52-00:28:49, 00:29:03-00:30:22.

<sup>319</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f.5; 081355-03, min.00:09:48-00:10:22.

<sup>320</sup> 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f.7; 081355-04, min.00:34:48-00:35:22.

<sup>321</sup> 081991-02-TR-ET, f. 9-10; 081991-02, min.00:14:17-00:15:48.



KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

raciste, selektive, politike".<sup>322</sup> Ai më pas deklaroi se ajo që kishte rëndësi ishte se dokumentet që i ishin dhënë OVL-UÇK-së minonin punën e kryer nga Gjykata për pesë vjet.<sup>323</sup>

125. Gjatë një programi tjetër televiziv që u transmetua më 22 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se materiali që po vihej në dispozicion të publikut u konvenonte atij dhe të tjerëve sepse vërtetonte ato që kishin thënë ata për bashkëpunimin e gjykatës me serbët,<sup>324</sup> dhe, duke përmendur DHS-në tha se rrjedhja e dokumenteve e diskreditonte atë.<sup>325</sup>

126. Gjatë një interviste më 22 shtator 2020, GUCATI deklaroi se personi i panjohur i cili kishte sjellë dokumentet në OVL-UÇK, u kishte thënë që në ditët në vijim do të dërgonte edhe CD të ndryshme me materiale; GUCATI deklaroi se OVL-UÇK-ja do t'i publikonte dokumente të tilla që t'u tregonte opinionit kosovar dhe shqiptarëve mbarë rruzullit tokësor se DHS-ja bashkëpunon me autoritetet serbe duke shtuar se ishte me rëndësi që t'i bindnin qytetarët e Kosovës dhe t'u tregonin që kjo Gjykatë është pa vlerë.<sup>326</sup>

127. Gjatë një interviste tjetër atë ditë, GUCATI deklaroi se ai vazhdon të publikojë dokumente sepse ai dhe të tjerët donin të tregonin realitetin dhe ata ishin në konflikt me DHS-në për tre vjet sepse DHS-ja është duke bashkëpunuar ngushtë me autoritetet e Serbisë<sup>327</sup> GUCATI theksoi se ai dhe të tjerët kanë protestuar kundër DHS-së që prej krijimit të saj më 2015.<sup>328</sup> GUCATI deklaroi se do t'i publikonte të gjitha dosjet që mund t'i vinin dhe ai e të tjerët janë kundër DHS-së sepse është raciste, e njëanshme dhe nuk vlente fare, duke theksuar se ruajtja e dokumenteve nuk ishte detyrë e tij.<sup>329</sup> GUCATI

---

<sup>322</sup> 082106-03-TR-ET, f.15; 082106-03, min.00:15:02-00:18:18.

<sup>323</sup> 082106-03-TR-ET, f.18; 082106-03, min.00:21:08-00:22:51.

<sup>324</sup> 081358-03-TR-ET Rishikuar, f.3; 081358-03, min.00:04:16-00:05:55.

<sup>325</sup> 081358-03-TR-ET Rishikuar, f.56; 081358-03, min.01:14:00-01:14:06.

<sup>326</sup> 082106-02-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 082106-02, min.00:03:29-00:04:17.

<sup>327</sup> 082106-01-TR-ET, f. 2-3; 082106-01, min.00:01:36-00:03:08.

<sup>328</sup> 082106-01-TR-ET, f.2; 082106-01, min.00:01:36-00:03:08.

<sup>329</sup> 082106-01-TR-ET, f. 7-8; 082106-01, min.00:08:55-00:10:20.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

deklaroi se dokumentet i kishin ardhur në zyrë dhe përgjegjësi e tij ishte të minonte DHS-së.<sup>330</sup> Ai shtoi se nëse do të ishte e mundshme për atë dhe të tjerët, ata do ta hiqnin dhe do ta shpërbënin DHS-në.<sup>331</sup>

128. Më 22 shtator 2020, GASHI, në prani të GUCATIT dhe HARADINAJT, deklaroi: “Ne mendojmë që në të ardhmen, nëse aktakuzat e ngritura kundër pjesëtarëve të UÇK-së të konfirmohen, atëherë mund të jenë materiale që mund të përdoren dhe mund të dëmtohet dhe të sulmohet kredibiliteti i Gjykatës Speciale”.<sup>332</sup> GASHI gjithashtu deklaroi se premtimi i OVL-UÇK-së “është gjithmonë, çfarëdo që marrin në raport me Dhomat e Specializuara, do ta njoftojnë opinionin sepse ne jemi kundër kësaj gjykate”.<sup>333</sup>

129. Më 25 shtator 2020, gjatë një interviste me një gazetar jashtë selisë së OVL-UÇK-së, HARADINAJ deklaroi se ai nuk do t’i zbatonte urdhrat e kësaj Gjykate dhe nuk e njihnte dhe se ai dhe të tjerë kishin detyrë të punonin kundër Gjykatës, duke theksuar sërish se nëse do të merrte dokumente të tjera, ai do t’ua shpërndante ato mediave.<sup>334</sup>

130. Gjatë një interviste tjetër atë ditë, HARADINAJ deklaroi: “Detyra e tyre është t’i ruajn sekretet e veta. Nuk i kam faj unë atje pse kanë shti ata njerëz pa shkollë, kanë shti naiva, dhe kan rrejt kta naivat tonë që ne e mbajmë sekretin. Asht dasht me i rujt arkivat e veta”.<sup>335</sup> HARADINAJ deklaroi: “Sa të jetojmë e të jemi me frymë ne jemi kundër kësaj gjykate. Fund. Kena me punu kundër kësaj gjykate. Fund. ...Ne na i ka prit ai që na i ka sjell ato. Ishallah na bjen apert”, duke shtuar se kjo nuk do të thoshte

<sup>330</sup> 082106-01-TR-ET, f. 8-9; 082106-01, min.00:10:20-00:13:16.

<sup>331</sup> 082106-01-TR-ET, f.11; 082106-01, min.00:14:47-00:16:12.

<sup>332</sup> 081931-01-TR-ET, f.2; 081931-01, min.00:01:31-00:04:33.

<sup>333</sup> 081931-01-TR-ET, f. 4-5; 081931-01, min.00:09:45-00:13:18.

<sup>334</sup> 081991-03-TR-ET Rishikuar, f. 2, 4-5; 081991-03, min.00:06:32-00:07:30, 00:09:29-00:10:50. Të akuzuarit dhe KLINAKU deklaruan se ata nuk e njihnin dhe/ose nuk do të bashkëpunonin me DHS-në edhe në disa raste të tjera, *shih* 081355-01-TR-ET Rishikuar, f.1; 081355-01, min.00:00:01-00:00:08; 081931-03-TR-ET Rishikuar, f. 1, 5; 081931-03, min.00:03:19-00:03:30, 00:06:53-00:07:04; 081979-01-TR-ET Rishikuar, f. 1-2; 081979-01, min. 00:00:37-00:00:52, 00:01:53-00:02:05; 081979-05-TR-ET, f.1; 081979-05, min.00:00:25-00:01:38; 082106-05-TR-ET Rishikuar, f. 1-2; 082106-05, min. 00:00:00-00:02:01; 083988-083991 RED, f.083989, para. 9; 082010-082013 RED, f.082011, para. 5.

<sup>335</sup> 081931-04-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081931-04, min.00:03:24-00:04:59.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

se vetëm HARADINAJ, GUCATI, ose KLINAKU do t'i jepnin dokumente medias, meqenëse edhe anëtari me rang më të ulët i UÇK-së mund ta bënte këtë dhe se: "Kemi me e qit në media".<sup>336</sup>

c. *Të akuzuarit dhe të tjerët i kishin këqyrur dokumentet përpara se t'i bënin publike*

131. Të akuzuarit dhe të tjerët pranuan publikisht që kishin këqyrur dokumentet përpara se t'i bënin ato publike dhe shfaqën një shkallë të lartë njohurie të përmbajtjes së tyre, veçanërisht për emrat e personave të përmendur në to.

132. Gjatë konferencës së parë për shtyp, GUCATI deklaroi se HARADINAJ i kishte parë dhe analizuar dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë me "Fatonin"- duke iu referuar KLINAKUT- dhe me persona të tjerë.<sup>337</sup> HARADINAJ deklaroi se ata kishin vënë re shumë gjëra në dokumente.<sup>338</sup> Ai gjithashtu deklaroi se atij dhe të tjerëve u ishte dukur se dokumentet ishin origjinale.<sup>339</sup>

133. Gjatë një programi televiziv i cili u transmetua më 7 shtator 2020 pas konferencës së parë për shtyp, GUCATI deklaroi se ai dhe të tjerë nuk kishin mundur t'i shqyrtonin të gjitha dokumentet, por i kishin parë dhe ua kishin dhënë disa mediave.<sup>340</sup>

134. Më 9 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se ai dhe të tjerët i kishin shqyrtuar dokumentet për një periudhë prej katër orësh dhe më tej dhanë informacion të hollësishëm rreth përmbajtjes së tyre.<sup>341</sup>

135. Më 11 shtator 2020, HARADINAJ sërish deklaroi se ai dhe të tjerët i kishin shqyrtuar dokumentet për një periudhë prej katër orësh, e kishin lexuar emra dëshmitarësh dhe ish-dëshmitarësh.<sup>342</sup>

---

<sup>336</sup> 081931-04-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081931-04, min.00:03:24-00:04:59.

<sup>337</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.1; 081344-01, min.00:00:01-00:01:22.

<sup>338</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30.

<sup>339</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 4-5; 081344-01, min.00:09:43-00:11:21.

<sup>340</sup> 081358-01-TR-ET, f.6; 081358-01, min.01:01:00-01:02:33.

<sup>341</sup> 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 7-8; 081991-01, min.00:13:22-00:13:47, 00:14:24-00:15:51; *Shih gjithashtu* SPOE00220813-0020813 (SPOE00220813-SPOE0020813-ET).

<sup>342</sup> 081979-11-TR-ET Rishikuar, f. 4-5; 081979-11, min.00:07:17-00:11:53.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

136. Më 16 shtator 2020, HARADINAJ, deklaroi se ai dhe të tjerët i kishin shqyrtuar dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë për tri orë, e gjatë kësaj kohe ai dhe të tjerët kishin marrë çfarë u nevojitej.<sup>343</sup>

137. Më 17 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte pasur kohë të lexonte dokumentet që u kishte sjellë personi i panjohur.<sup>344</sup>

138. Më 20 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se kishte lexuar dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë sa kishte mundur brenda orarit të punës së OVL-UÇK-së.<sup>345</sup>

139. Menjëherë para mbajtjes së konferencës së tretë për shtyp, GUCATI dhe të tjerët lexuan pjesë nga dokumentet që sapo kishin marrë.<sup>346</sup> Gjatë konferencës së tretë për shtyp, GUCATI deklaroi se HARADINAJ i kishte lexuar dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë për rreth 30 minuta.<sup>347</sup>

140. Më 22 shtator 2020, GASHI pranoi se GUCATI, HARADINAJ dhe të tjerë i kishin parë dokumentet të cilat ishin përmendur gjatë të tri konferencave për shtyp “për çështje të veta”.<sup>348</sup>

141. Faktet e përmendura më sipër tregojnë se nuk është e mundur që të akuzuarit të mos kishin njohuri mbi përmbajtjen konkrete të dokumenteve që ata zgjedhën të bënin publike. Faktikisht, ata e këqyrën informacionin që përmbanin dokumentet dhe zgjedhën t’i shpërndanin ato për shkak të përmbajtjes së tyre.

*d. Dokumentet që të akuzuarit bënë publike ishin shënuar si konfidenciale [REDAKTUAR]*

142. Duke pasur parasysh kohën që të akuzuarit kaluan duke parë dhe treguar dokumentet që ata i bënë publike, do të ishte e pamundshme të besohej se ata nuk i

---

<sup>343</sup> 081979-07-TR-ET, f. 3-4; 081979-07, min.25:32-26:20.

<sup>344</sup> 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f.3; 082106-06, min.00:05:02-00:07:52.

<sup>345</sup> 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f.9; 081355-04, min.00:37:46-00:37:48.

<sup>346</sup> 093457-093458 (093457-093458-ET).

<sup>347</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.2; 082136-01, min.00:03:15-00:06:04.

<sup>348</sup> 081931-01-TR-ET, f.3; 081931-01, min.00:07:18-00:08:24.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

vunë re shënimet e shumta që tregojnë se dokumentet ishin konfidenciale [REDAKTUAR].

143. Shumica e kërkesave të përfshira në paketën 1 përbëhen nga një letër përcjellëse dhe shtojcat, të përmendura shprehimisht në letrën përcjellëse si shtojca “konfidenciale”.<sup>349</sup> Kërkesat dhe dokumentet e tjera që janë pjesë e paketës 1, që përfshinin letërkëmbime lidhur me masat logjistike për kryerjen e intervistave, e përmendin shprehimisht konfidencialitetin e hetimeve të TFHS-së.<sup>350</sup>

144. Shenjat konkrete në dokumentet e shumta që ishin pjesë e paketës 1, si dhe natyra e informacionit që ato përmbanin, tregojnë qartësisht natyrën konfidenciale të dokumenteve të paketës 1.<sup>351</sup> Ndër treguesit e konfidencialitetit përfshihen: (i) stema dhe kreu i dokumenteve të TFHS-së dhe autoriteteve të ndryshme serbe; (ii) referencat e numrave të çështjeve; (iii) vulat e pranimit të Prokurorisë Serbe të Krimeve të Luftës (“PSKL”); (iv) shënimet e ndryshme, përfshirë shkurtesat që lexonin “konfidencial” ose “rreptësisht konfidencial” në anglisht dhe serbisht; (v) nënshkrimet e ushtruesit të detyrës së kryeprokurorit të TFHS-së, zv/kryeprokurorit të TFHS-së, zyrtarëve serbë dhe autoriteteve gjyqësore; dhe; (vi) listat e dëshmitarëve të shënuara “KONFIDENCIALE”. Disa nga këta tregues janë përfshirë në pamjet e dokumenteve që janë pjesë e paketës 1, të publikuara në Internet pas dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë.<sup>352</sup>

145. Në gjashtë faqet e paketës 2 të cilat nuk janë aktgjykime të disponueshme për publikun dhe në dokumentet e lidhura me to, ka letra përcjellëse të kërkesave që u referohen shtojcave të klasifikuara si konfidenciale, që nuk janë të përfshira në paketën

<sup>349</sup> 084015-084026, f.084016, para. 8; 093492-093590, f.093492, para. 3-4, shtojcat 1-2.

<sup>350</sup> 084015-084026, f.084016, para. 8; 091791-091792, f.091791, para. 7; 093492-093590, f.093492, para. 3-4, shtojcat 1-2.

<sup>351</sup> 093492-093590, f.093492, para. 3-4, shtojcat 1-2.

<sup>352</sup> Krahaso: (i) 093492-093590, shtojca 2(a) me 081361-081378, f. 081362, 081365-081367, dhe 081915-081919, f. 081915-081916, 081918-081919; (ii) shtojca 2(b) me 081361-081378, f.081362, dhe 081915-081919, f. 081918-081919.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

2.<sup>353</sup> Dokumentet serbe të përfshira në paketën 2, në gjuhën serbe, përmbajnë informacione konfidenciale.<sup>354</sup> Treguesit në vijim vërtetojnë më tej natyrën konfidenciale të këtyre gjashtë faqeve të paketës 2; <sup>355</sup> (i) stema dhe/ose kreu i dokumenteve të TFHS-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë; (ii) referencat e numrave të çështjeve; (iii) vulat zyrtare të pranimit të dokumenteve nga autoritetet serbe; (iv) nënshkrimet e ushtruesit të detyrës së kryeprokurorit të TFHS-së dhe të zyrtarëve serbë; dhe (v) referencat për konfidencialitetin e hetimit.

146. Në shumicën e 489 faqeve që përmban paketa 3 është e pamundshme të mos vihet re kreu dhe fundi i faqeve; në kreun e dokumenteve që përmban paketa 3 është simboli i ZPS-së, fraza “Zyra e Prokurorit të Specializuar” si dhe fjalët “KONFIDENCIALE, [REDAKTUAR]; në fund të faqes shkruhet “Konfidenciale”.<sup>356</sup> Versione të plota dhe të pjesshme të kreut dhe/ose fundit të këtyre faqeve tregohen në disa pamje të dokumenteve që janë pjesë e paketës 3 të publikuara në Internet pas nxjerrjes së tretë të dokumenteve.<sup>357</sup>

<sup>353</sup> 084015-084026, f. 084018-084019, para. 23, 25; 093492-093590, f. 093492-093493, para. 5-6, shtojcat 3-4.

<sup>354</sup> 084015-084026, f.084019, para. 26-27; 093492-093590, f. 093492-093493, para. 5-6, shtojcat 3-4. Gjatë konferencës së parë për shtyp, HARADINAJ vuri në dukje se dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë ishin në anglishte dhe në serbokroatishte dhe se ai kupton disi anglisht dhe mund të lexojë shumë mire në serbokroatisht, 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 4-5; 081344-01, min.00:09:43-00:11:21. GUCATI deklaroi se e njihnte mirë stemën dhe vulën serbe në shkrimin cirilik dhe se ende mund të lexojë pak serbisht, 081358-01-TR-ET, f.6; 081358-01, min.01:01:00-01:02:33.

<sup>355</sup> 093492-093590, f. 093492-093493, para. 5-6, shtojcat 3-4.

<sup>356</sup> 084015-084026, f.084021, para. 35; 093492-093590, f. 093493-093495, para. 7-10, shtojca 5.

<sup>357</sup> Krahaso: (i) 093492-093590, shtojca 5(a) me 081381-081391 (ff.081384, 081386-081391), 081395-081404 (ff.0813995-081404), 081414-081422 (ff.081414, 081416-081421), SPOE00220819-00220826 (ff.SPOE00220824-SPOE00220825), SPOE00220830-00220837 (ff.SPOE00220835-SPOE00220836), SPOE00220845-00220850 (ff.SPOE00220846-SPOE00220850), SPOE00220851-00220857 (ff.SPOE00220852-SPOE00220855), SPOE00220858-00220865 (ff.SPOE00220859-SPOE00220860, SPOE00220862-SPOE00220863), SPOE00220866-00220871 (ff.SPOE00220867-SPOE00220868, SPOE00220870-SPOE00220871), SPOE00220873-00220878 (ff.SPOE00220875-SPOE00220878), SPOE00220879-00220885 (ff.SPOE00220881-SPOE00220882); (ii) 093492-093590, shtojca 5(b)(2) me 081381-081391 (ff.081384-081385), SPOE00220819-00220826 (f.SPOE00220824), SPOE00220827-00220829 (SPOE00220828), SPOE00220851-00220857 (f.SPOE00220855), SPOE00220858-00220865 (f.SPOE00220863), SPOE00220866-00220871 (f.SPOE00220871), SPOE00220886-00220888 (f.SPOE00220887); dhe (iii) 093492-093590, shtojca 5(c) me 081395-081404 (ff.081399-081400, 081402, 081404), 081414-081422 (ff.081414, 081417-081418, 081421), SPOE00220819-00220826 (f.SPOE00220824),

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

e. *Të akuzuarit i përshkruan publikisht si konfidenciale dokumentet që bënë publike*

147. Vetë të akuzuarit i përshkruan dokumentet që ata bënë publike si konfidenciale, ose ndryshe përdorën një gjuhë që tregonte se ata ishin plotësisht të vetëdijshëm për natyrën e ndjeshme të dokumenteve që ata vendosën të shpërndanin.

148. Gjatë konferencës së parë për shtyp, HARADINAJ tregoi me dorë dokumentet në tavolinë dhe deklaroi: "...këtu janë emnat e të gjithë dëshmitarëve që ata thonë i kemi në mbrojtje. Të gjithëve".<sup>358</sup> Ai gjithashtu iu referua dokumenteve si "konfidenciale" dhe "top sekrete".<sup>359</sup>

149. Më 17 shtator 2020, HARADINAJ doli në një program televiziv e i cilësoi dokument "Janë për gjykatën e Hagës që bashkëpunon me Serbinë sensitive. Për mu s"janë."<sup>360</sup> Në të njëjtën ditë, HARADINAJ deklaroi gjithashtu se dokumentet "kanë vulën origjinale" dhe shënimin "top sekret."<sup>361</sup>

150. Më 19 shtator 2020, HARADINAJ iu referua dosjeve të marra dhe të publikuara nga OVL-UÇK-ja si "...dëshmitar për ndërtimin e një aktakuze kundër djemve të luftës" dhe i quajti ato konfidenciale.<sup>362</sup>

151. Më 20 shtator 2020, HARADINAJ tha se dokumentet ishin marrë prej depove sekrete<sup>363</sup>

152. Më 21 shtator 2020, në orën 08:21, GUCATI publikoi një postim në profilin e tij në Facebook ku deklaroi se dosjet që kishin ardhur në zyrat e OVL-UÇK-së, ishin dokumente zyrtare të DHS-së të cilat përmbanin shumicën e emrave të dëshmitarëve;

---

SPOE00220830-00220837 (f.SPOE00220835), SPOE00220845-00220850 (ff.SPOE00220846, SPOE00220848-SPOE00220850), SPOE00220851-00220857 (f.SPOE00220852), SPOE00220858-00220865 (f.SPOE00220859), SPOE00220866-00220871 (f.SPOE00220867), SPOE00220873-00220878 (ff.SPOE00220875-SPOE00220876, SPOE00220878), SPOE00220879-00220885 (f.SPOE00220881).

<sup>358</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.2; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30.

<sup>359</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f.3; 081344-01, min.00:06:31-00:09:09.

<sup>360</sup> 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f.20; 081355-02, min.00:39:29-00:39:36.

<sup>361</sup> 081979-08-TR-ET, f.2; 081979-08, min.00:02:48-00:04:05.

<sup>362</sup> 081979-05-TR-ET, f.2; 081979-05, min.00:02:10-00:06:38, 00:18:58-00:19:24.

<sup>363</sup> 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f.24; 081355-04, min.00:49:08-00:49:27.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

ai tha se dokumentet kishin dalë nga zyrat e DHS-së dhe i cilësoi “tepër sekrete dhe shumë të ndjeshme”.<sup>364</sup>

153. Më 22 shtator 2020, GUCATI deklaroi se dokumentet përmbanin vula zyrtare, numra reference, nënshkrime të prokurorëve ndërkombëtarë dhe vula e emblemën e DHS-së.<sup>365</sup>

154. Më 22 shtator 2020, GASHI theksoi se materiali që ishte pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së tretë “është origjinal” dhe “duket që është material me ndjeshmëri të lartë, ku ka të bëjë me hetimin penal të personave që janë hetuar nga Gjykata për vite të tëra”.<sup>366</sup>

155. Në një numër rastesh, GUCATI,<sup>367</sup> HARADINAJ,<sup>368</sup> KLINAKU,<sup>369</sup> dhe GASHI<sup>370</sup> deklaruan se dokumentet përfshinin emrat dhe të dhënat personale të dëshmitarëve që ata dhe/ose shtypi nuk lejohej t’i bënin publike. Sidoqoftë, siç u tregua më lart, të akuzuarit nuk ua vunë veshin paralajmërimeve që ata dhe të tjerët morën në lidhje me këtë, duke nxjerrë kohë pas kohe informacione të tilla dhe pastaj duke mohuar se kishin bërë një gjë të tillë pas vetëm disa çastesh.<sup>371</sup> Përmendja sa për sy e faqe e këtij parimi mund të interpretohet vetëm si një përpjekje e dëshpëruar për t’u distancuar nga ajo që ata e dinin se ishte veprimtari kriminale.

<sup>364</sup> 081983-081988; 081983-081988-ET Rishikuar, f. 081983-081986.

<sup>365</sup> 082106-01-TR-ET, f.14; 082106-01, min.00:17:50-00:19:36.

<sup>366</sup> 081931-01-TR-ET, f.2; 081931-01, min.00:01:31-00:04:33.

<sup>367</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 1-2; 082136-01, min.00:03:15-00:06:04; *Shih gjithashtu* 082106-01-TR-ET, f. 1-3; 082106-01, min.00:00:00-00:03:08.

<sup>368</sup> 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 2-4; 081344-02, min.00:02:40-00:09:49; 081979-07-TR-ET, f.3; 081979-07, min.24:45-25:32; 082106-03-TR-ET, f. 8-9, 21-22; 082106-03, min.00:08:22-00:09:39, 00:25:41-00:26:44.

<sup>369</sup> 081931-02-TR-ET Rishikuar, f.1; 081931-02, min.00:12:22-00:12:49.

<sup>370</sup> 081347-01-TR-ET Rishikuar, f. 3-9; 081347-01, min.00:04:00-00:07:52,00:08:25-00:11:45, 00:14:32-00:15:21, 0:17:40-00:20:04; 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f.4; 081355-03, min.00:07:39-00:08:25; 081931-01-TR-ET, f.3; 081931-01, min.00:07:18-00:08:24. Gabimisht, GASHI gjithashtu deklaroi se, nga ana tjetër, publikimit i komunikimeve ndërmjet institucioneve nuk është kurrfarë vepër penale dhe kurrkush nuk e ka të ndaluar t’i publikojë, 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f.14-15; 081355-03, min.00:25:12-00:25:38.

<sup>371</sup> Disa sekonda pasi HARADINAJ përmendi [REDAKTUAR] në një program televiziv, një i ftuar tjetër në atë program vuri në dukje se do të ishte problematike nëse përmendeshin emrat e dëshmitarëve të mbrojtur, e kësaj HARADINAJ iu përgjigj se as ai, as të tjerët nuk kishin përmendur e nuk do të përmendnin emra dëshmitarësh, 081358-03-TR-ET Rishikuar, f.30; 081358-03, min.00:39:20-00:40:08.



KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

*f. Të akuzuarit pranuan shprehimisht pasojat e mundshme të veprimeve të tyre*

156. Me anë të veprimeve të tyre, këqyrjes së informacionit që ishte shënuar qartë si konfidencial para se ta shpërndanin, dhe e cilësuan publikisht informacionin si konfidencial, të akuzuarit nuk shprehën thjesht publikisht synimin e tyre për të penguar punën e DHS/ZPS-së. Ata dhe të tjerët gjithashtu pranuan shprehimisht pasojat e mundshme të veprimeve të tyre të qëllimshme, si për dëshmitarët ashtu edhe për procesin gjyqësor, duke pohuar që jeta e dëshmitarëve mund të rrezikohej dhe se procesi gjyqësor mund të dëmtohej. Ata pranuan gjithashtu edhe rreziqet që po i krijonin vetes së tyre, duke pohuar se këto veprime mund të çonin në burgosjen e tyre.

157. Gjatë një programi televiziv i cili u transmetua vetëm disa orë pas mbajtjes së konferencës së parë për shtyp, në të cilën HARADINAJ, në prani të GUCATIT, përmendi konkretisht emrat e disa dëshmitarëve, GUCATI deklaroi: “Jo, me emna nuk lëshojm, a di pse nuk lëshojm me emna, se nuk e njoh gjinin, po dhe t’lëshojm emna nuk i njoh” dhe shtoi se kishte gjithfarë njerëzish ndër të cilët serbë, romë dhe turq dhe se “këto janë emna dëshmitarësh edhe intervistime”.<sup>372</sup> I pyetur nëse kishte bërë mirë që i kishte publikuar dokumentet, GUCATI deklaroi se besonte se kishin vepruar mirë dhe se ishte diskutuar me kryesinë dhe njerëz të tjerë.<sup>373</sup> Kur prezantuesi tha se mund të ndodhnin gjëra se dokumentet përmbanin emra, GUCATI deklaroi se kjo mund të ndodhte.<sup>374</sup>

158. Më 9 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se nëse do të merrte sërish një material të tillë, ai do ta bënte publik dhe, edhe nëse OVL-UÇK-ja do të bënte shkelje të ligjit, ajo kishte detyrë që të bënte çdo gjë që të provonte moskorrektësinë e DHS-së sepse është raciste dhe selektive.<sup>375</sup>

---

<sup>372</sup> 081358-01-TR-ET, f. 6-7; 081358-01, min.01:01:00-01:02:33.

<sup>373</sup> 081358-01-TR-ET, f. 8-9; 081358-01, min.01:03:52-01:05:00.

<sup>374</sup> 081358-01-TR-ET, f.8; 081358-01, min.01:03:52-01:05:00.

<sup>375</sup> 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f.8; 081991-01, min.00:13:54-00:15:51.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

159. Gjatë një interviste më 16 shtator 2020, në përgjigje të pyetjes nëse ishte i vetëdijshëm që kjo që po ndodhte mund të dëmtonte procesin gjyqësor, HARADINAJ deklaroi se këtë donte që të ndodhte.<sup>376</sup>

160. Gjatë sekuestrimit të paketës 2, HARADINAJ deklaroi se ishte i vetëdijshëm se publikimi i emrave të dëshmitarëve mund të rrezikonte jetën e tyre.<sup>377</sup>

161. Më 18 shtator 2020, GASHI deklaroi se ai dhe të tjerë e dinin se dokumentet mund të përdreshin për të shantazhuar dikë dhe se keqpërdorimi i dokumenteve përbën vepër penale, por nuk ishte problem i GASHIT.<sup>378</sup>

162. Më 20 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se nuk e njihte Gjykatën Speciale dhe se ai do të ishte krenar dhe i nderuar nëse do të arrestohej për veprimet e tij.<sup>379</sup>

163. Më 21 shtator 2020, GUCATI publikoi një postim në profilin e tij në Facebook në të cilin deklaroi se publikimi i dosjeve ishte punë e ndjeshme, se dosjet përfshinin dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët kundër UÇK-së dhe ata që kishin zgjedhur OVL-UÇK për t'i lënë dosjet e kishin ngarkuar me një përgjegjësi të madhe, mirëpo OVL-UÇK-ja nuk ishte për të ndrequr gabimet e të tjerëve.<sup>380</sup>

164. Gjatë konferencës së tretë për shtyp, kur u tha se publikimi i dokumenteve ishte i ndaluar me ligj dhe i dënueshëm me deri në dhjetë vjet burgim, HARADINAJ u përgjigj se nuk e dinte.<sup>381</sup> Kur personi që bëri këtë pyetje më tej deklaroi se kështu ishte ligji i DHS-së, HARADINAJ u përgjigj: “Në këtë rast po shkoj edhe unë në burg”,<sup>382</sup> duke shtuar më pas: “tash ti je ka më tut me dhjetë vjet. 300 vjet të më japshin për qitë

---

<sup>376</sup> 081979-07-TR-ET, f. 5-6; 081979-07, min.28:52-29:38.

<sup>377</sup> 082010-082013 RED, f. 082011-082012, para. 9.

<sup>378</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 8-9; 081355-03, min.00:15:33-00:16:08.

<sup>379</sup> 081991-02-TR-ET, f. 1-2; 081991-02, min.00:01:01-00:04:03.

<sup>380</sup> 081983-081988; 081983-081988-ET Rishikuar, f. 081983-081986.

<sup>381</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.12; 082136-01, min.00:24:06-00:24:10.

<sup>382</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.12; 082136-01, min.00:24:11-00:24:15.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

punë, unë e qes. Unë, unë, jam ka foli unë edhe me Kryesia komplet....na jena të përgatitun 300-vjet...Ne jemi kanë të përgatitun me vdek".<sup>383</sup>

165. Gjatë një programi televiziv që u transmetua më 22 shtator 2020, HARADINAJ deklaroi se OVL-UÇK-ja nuk i publikoi dokumentet sepse media është "forca e katërt n"ket shtet", dhe kur prezantuesi i programit tha se publikimi i dokumenteve do të ishte i kundërligjshëm, HARADINAJ u përgjigj me pyetjen se pse duhej t'i publikonte ai e nëse prezantuesi donte që ai të shkelte ligjin<sup>384</sup>

166. Më 22 shtator 2020, GUCATI, duke gënjyer hapur ndërkohë që bëhej gjithmonë e më i vetëdijshëm për pasojat e veprimeve të tij, deklaroi se ishte e padrejtë që ai dhe të tjerët akuzoheshin se po tentonin të minonin administrimin e drejtësisë dhe se ai dhe të tjerët kishin ruajtur çdo emër të përmendur në dokumente dhe kishin mundësuar që të ishin të ruajtur<sup>385</sup> Ai deklaroi se ai dhe të tjerët e dinin se nuk kishin shkelur ligjin, sepse nuk kishin treguar emrat dhe mbiemrat e dëshmitarëve, kishin treguar vetëm dokumentacionin."<sup>386</sup>

167. I pyetur nëse kishte ndonjë përgjegjësi lidhur me çfarë ndodhi duke pasur parasysh faktin që ai publikoi dokumentet, GUCATI deklaroi se ai dhe të tjerët nuk kishin përgjegjësi sepse nuk kishin bërë publik emra dëshmitarësh dhe nuk kishin deklaruar çfarë shkruhej në dokumente.<sup>387</sup> I pyetur nëse do të pendohej për publikimin e dokumenteve nëse do të kishte pasoja penale, GUCATI deklaroi se nuk do t'i vinte aspak keq edhe sikur të dënohej me pesë vjet burgim.<sup>388</sup> GUCATI deklaroi se ai dhe të tjerët nuk dinin si mund t'i akuzonte DHS-ja, si mund të ngrinte aktakuzë kundër tyre kur ata nuk kishin nxjerrë asnjë emër dëshmitari.<sup>389</sup>

<sup>383</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f.13; 082136-01, min.00:24:44-00:25:16.

<sup>384</sup> 081358-03-TR-ET Rishikuar, f. 28-29; 081358-03, min.00:37:46-00:38:13.

<sup>385</sup> 082106-01-TR-ET, f. 1-2; 082106-01, min.00:00:00-00:03:08.

<sup>386</sup> 082106-01-TR-ET, f.2; 082106-01, min.00:00:00-00:03:08.

<sup>387</sup> 082106-01-TR-ET, f.11; 082106-01, min.00:13:16-00:14:47.

<sup>388</sup> 082106-01-TR-ET, f.12; 082106-01, min.00:14:47-00:16:12.

<sup>389</sup> 082106-01-TR-ET, f. 12-13; 082106-01, min.00:16:12-00:17:50.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

g. *Urdhrrat e DHS-së dhe ZPS-së i njoftuan të akuzuarit se informacioni që ata po bënë publik ishte i ndjeshëm, jopublik dhe nuk duhej përhapur më tej*

168. Këqyrja e dokumenteve nga të akuzuarit, referencat e qarta për natyrën konfidenciale të dokumenteve që përmbanin dosjet, cilësimi i dokumenteve si konfidenciale prej vetë të akuzuarve dhe paralajmërimet që ata morën nga gazetarët se veprimet e tyre ishin kriminale, nuk ishin aspak të vetmet mjete me anë të të cilëve të akuzuarit u informuan se informacioni që ata po publikonin kishte natyrë të ndjeshme, jopublike dhe se nuk duhej përhapur më tej. Kjo thuhej qartë në urdhrat që iu dorëzuan OVL-UÇK-së më datat 8,<sup>390</sup> 17<sup>391</sup> dhe 22<sup>392</sup> shtator 2020.

169. Megjithëse KLINAKU ishte personi i pranishëm kur u sekuestrua paketa 1 dhe u dorëzua urdhri i parë,<sup>393</sup> brenda disa orësh, HARADINAJ u vu në dijeni të sekuestrimit dhe iu dha një kopje e dokumentit që kishte nënshkruar KLINAKU ku pranohej sekuestrimi i dokumenteve, të cilin HARADINAJ e publikoi në profilin e tij në Facebook.<sup>394</sup> Të nesërmen, HARADINAJ publikoi në profilin e tij në Facebook një pamje të kopjes së legalizuar të urdhrat të parë, me klasifikimin rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.<sup>395</sup>

170. Të dy të akuzuarit ishin të pranishëm kur u sekuestrua paketa 2 dhe u dorëzua urdhri i dytë, ku GUCATI nënshkroi dokumentin në të cilin pranohej se dokumentet ishin sekuestruar.<sup>396</sup> Pas këtij sekuestrimi, GUCATI pohoi se anëtarët e personelit të ZPS-së i kishin dorëzuar atij një kopje të urdhrat të dytë dhe se ata i kishin thënë se nuk lejohej shumëfishimi ose shpërndarja e atyre dokumenteve, as nxjerrja e emrave të dëshmitarëve.<sup>397</sup> HARADINAJ pranoi se gjatë sekuestrimit të paketës 2,

<sup>390</sup> 091971-091980; 092028-092038.

<sup>391</sup> 092017-092027; 091981-091991.

<sup>392</sup> SPOE00220914-00220914.

<sup>393</sup> 083988-083991 RED; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00008.

<sup>394</sup> SPOE00220798-00220798 (SPOE00220798-SPOE00220798-ET Rishikuar); SPOE00220799-00220799 (SPOE00220799-SPOE00220799-ET Rishikuar).

<sup>395</sup> SPOE00222202-00222288, f.SPOE00222202.

<sup>396</sup> 082010-082013 RED, f.082012, para. 10, 12-13; 079500-079500; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00028.

<sup>397</sup> 081347-01-TR-ET Rishikuar, f. 3, 8; 081347-01, min.00:02:27-00:03:57, 00:16:42-00:17:19.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

përfaqësuesit e ZPS-së kishin konfirmuar natyrën e ndjeshme të materialit të sekuestruar.<sup>398</sup>

171. Gjatë një interviste televizive më 19 shtator 2020, HARADINAJ tregoi para kamerës një version të legalizuar të urdhrin të dytë, i cili ishte klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, si dhe një dokument të ZPS-së që vërtetonte marrjen e materialit të sekuestruar,<sup>399</sup> dhe, duke iu referuar urdhrin të dytë, pohoi se ai përfshinte një obligim për HARADINAJN dhe të tjerët për të mos publikuar dokumentet, e pastaj shtoi: “Po ne s’kemi nevojë me i publiku. Ne i kemi dhanë kush i publikon. Tani janë kompetencat e atyne, a dojnë me i [publiku] apo s’dojnë me i [publiku].”<sup>400</sup>

172. Të dy të akuzuarit ishin të pranishëm edhe kur u sekuestrua paketa 3 dhe u dorëzua urdhri i tretë, ku HARADINAJ nënshkroi një dokument ku pranonte se dokumentet ishin sekuestruar.<sup>401</sup>

B. Duke vepruar bashkërisht në një grup, të akuzuarit penguan personat zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (Pika 2)

173. Provat e parashtruara në paraqitjen e fakteve,<sup>402</sup> përfshirë ato tashmë të shtjelluara në Pikat 1 dhe 3-6<sup>403</sup>, vërtetojnë gjithashtu se midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të akuzuarit u bënë pjesë e një grupi personash, të përbërë nga vetë të akuzuarit, KLINAKU, GASHI dhe të tjerë, duke përfshirë edhe anëtarë dhe përfaqësues të tjerë të OVL-UÇK-së, veprimet e përbashkëta të cilëve penguan ose tentuan të pengonin një ose më shumë persona zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare.

<sup>398</sup> 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f.1; 082106-06, min.00:00:19-00:03:50; 081979-05-TR-ET, f. 1, 4-5; 081979-05, min.00:01:38-00:02:06, 00:06:48-00:11:44; 081979-09; 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f.3; 081355-03, min.00:01:20-00:01:58, 00:03:22-00:04:38. Më vonë po atë ditë, HARADINAJ nxori një lidhje me këtë intervistë në profilin e tij në Facebook, *shih* SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220739 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220739).

<sup>399</sup> 081979-05, min.00:12:44-00:15:00; *Shih* 079500-079500; 092017-092027; 092028-092038.

<sup>400</sup> 081979-05-TR-ET, f.6; 081979-05, min.00:13:25-00:13:47.

<sup>401</sup> 082014-082016; SPOE00220915-00220915; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00010/A01.

<sup>402</sup> *Shih* Pjesa II.

<sup>403</sup> *Shih* Pjesa III A, C-F.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

174. Këto prova tregojnë se, në cilësinë e tyre, përkatësisht si kryetar dhe nënkryetar të OVL-UÇK-së,<sup>404</sup> GUCATI dhe HARADINAJ bashkërenduan dhe organizuan grupin në ndërmarrjen e këtyre veprimeve, të cilat u kryen kundër zyrtarëve të ZPS-së, ndër të cilët prokurorët, hetuesit dhe anëtarët e tjerë të personelit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare, konkretisht gjatë hetimeve penale në vazhdim të ZPS-së. Veprimet e grupit në fjalë u drejtuan gjithashtu edhe kundër zyrtarëve të DHS-së, duke përfshirë gjykatësit dhe të tjerë

175. Në veçanti, të akuzuarit, KLINAKU, GASHI dhe të tjerët u përfshinë në këqyrjen e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë, të dytë dhe të tretë.<sup>405</sup> Të akuzuarit, KLINAKU dhe të tjerët morën pjesë në organizimin e konferencës së parë, të dytë dhe/ose të tretë për shtyp, në të cilat ata bënë publike dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë, të dytë dhe të tretë.<sup>406</sup> Të akuzuarit folën në këto konferenca shtypi, në të cilat morën pjesë edhe anëtarë të tjerë të OVL-UÇK-së që qëndronin të ulur pranë tyre në kohën që ata u drejtoheshin të pranishmëve.<sup>407</sup> Një ose më shumë nga të akuzuarit, KLINAKU dhe GASHI, nganjëherë të gjithë së bashku, përfaqësuan OVL-UÇK-në në mbi pesëmbëdhjetë paraqitje mediatike që u mbajtën në lidhje me dokumentet e

---

<sup>404</sup> *Shih, p.sh.* 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 7-8; 081344-01, min.00:14:48-00:15:02; 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 1-2; 081344-02, min.00:00:01-00:02:31; 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.2; 081347-01, min.00:02:00-00:02:26.

<sup>405</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-3; 081344-01, min.00:00:01-00:06:30; 081979-11-TR-ET Rishikuar, f. 3-5; 081979-11, min.00:07:17-00:11:53; 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f.9; 081355-04, min.00:37:46-00:37:48; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 1-2; 082136-01, min.00:03:15-00:06:03; 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 3-5; 081355-03, min.00:04:59-00:08:25.

<sup>406</sup> *Shih, p.sh.* 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-3; 081344-01, min.00:00:01-00:06:30; 082014-082016, f.082015, para. 9; 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 1-4; 081344-02, min.00:00:01-00:09:49; 093457-093458 (093457-093458-ET); 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 1-3; 082136-01, min.00:03:15-00:10:28.

<sup>407</sup> *Shih* 081344-01-TR-ET Rishikuar 1; 081344-01; 081344-02-TR-ET Rishikuar; 081344-02; 082136-01-TR-ET Rishikuar; 082136-01.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

nxjerra gjatë herës së parë, të dytë dhe/ose të tretë,<sup>408</sup> përfshirë paraqitjet e të akuzuarve në rastet kur informacioni konfidencial u shpërnda më tej.<sup>409</sup>

176. Të akuzuarit dhe GASHI lavdëruan publikisht burimet e paidentifikuara të cilat sollën dokumentet në selinë e OVL-UÇK-së dhe/ose u shprehën se do të mirëprisnin sjelljen e dokumenteve të tjera nga këto burime në të ardhmen.<sup>410</sup> Më tej, të akuzuarit kërcënuan në mënyrë të përsëritur se do të vazhdonin shpërndarjen e informacionit të hetimeve konfidenciale, duke përfshirë identitetet e dëshmitarëve, dhe se do të pengonin mandatin e DHS/ZPS-së.<sup>411</sup> Të akuzuarit dhe GASHI bënë komente nënçmuese dhe/ose kërcënime në adresë të dëshmitarëve.<sup>412</sup>

177. Provat e përshkruara më lart<sup>413</sup> vërtetojnë se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm dhe dëshironin të merrnin pjesë në një grup me qëllim që të pengonin personat zyrtarë në

<sup>408</sup> 081358-01-TR-ET; 081358-01; 081931-02-TR-ET Rishikuar; 081931-02; 081991-01-TR-ET Rishikuar 1; 081991-01; 081979-11-TR-ET Rishikuar; 081979-11; 081979-07-TR-ET; 081979-07; 081347-01-TR-ET Rishikuar; 081347-01; 082106-06-TR-ET Rishikuar 2; 082106-06; 081979-08-TR-ET; 081979-08; 081355-03-TR-ET Rishikuar 1; 081355-03; 081979-05-TR-ET; 081979-05; 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2; 081355-04; 081931-01-TR-ET; 081931-01; 081358-03-TR-ET Rishikuar; 081358-03; 082106-03-TR-ET; 082106-03; 081981-02-TR-ET Rishikuar; 081981-02; 081991-04-TR-ET; 081991-04; 081991-03-TR-ET Rishikuar; 081991-03.

<sup>409</sup> 081358-01-TR-ET, f. 5-8; 081358-01, min.00:59:42-01:03:52; 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f.8; 081991-01, min.00:14:24-00:15:51; 081979-07-TR-ET, f. 2-3; 081979-07, min.09:30-11:01; 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f. 1-2; 082106-06, min.00:00:19-00:03:50; 081358-03-TR-ET Rishikuar, f. 29-30; 081358-03, min.00:39:20-00:39:58.

<sup>410</sup> 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f.4; 081355-02, min.00:24:40-00:25:12; 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f. 3-4; 081355-04, min.00:32:59-00:33:30; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 2-3, 8; 082136-01, min.00:06:54-00:10:28, 00:19:14-00:19:30; 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 7-8; 081991-01, min.00:13:54-00:15:51; 082106-07-TR-ET Rishikuar, f.2; 082106-07, min.00:06:24-00:08:04; 082106-01-TR-ET, f. 12-13; 082106-01, min.00:16:12-00:17:50; 082106-04-TR-ET Rishikuar, f.2; 082106-04, min.0:28:46-0:30:37; 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 4-5; 081355-03, min.00:08:26-00:09:47.

<sup>411</sup> 081979-11-TR-ET Rishikuar, f. 3-5; 081979-11, min.00:06:03-00:06:55, 00:09:41-00:11:53; 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 2-4; 081344-02, min.00:02:40-00:09:49; 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.3; 081347-01, min.00:02:27-00:03:57; 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f.6; 081355-04, min.00:32:59-00:34:11; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 2-3; 082136-01, min.00:03:15-00:11:45; 081991-03-TR-ET Rishikuar, f. 4-5; 081991-03, min.00:09:29-00:10:50.

<sup>412</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 2-6; 081344-01, min.00:01:26-00:09:09, 00:11:27-00:13:16; 081358-01-TR-ET, f. 10-14; 081358-01, min.01:06:42-01:10:49; 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f. 7, 26; 081355-04, min.00:34:48-00:35:22, 00:50:33-00:51:07; 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 5-6; 081355-03, min.00:09:48-00:10:22.

<sup>413</sup> *Shih* Pjesa III A(i).

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

kryerjen e detyrave zyrtare; si alternativë, të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se pjesëmarrja e tyre në këtë grup mund të shkaktonte këtë pasojë të ndaluar me ligj dhe ata u pajtuan me shkaktimin e kësaj pasoje të ndaluar. KLINAKU<sup>414</sup> dhe GASHI<sup>415</sup> gjithashtu bënë të qartë se synimi i tyre ishte i njëjtë me atë të të akuzuarve.

C. Të akuzuarit frikësuan dëshmitarët gjatë procedurës penale (Pika 3)

178. Provat e parashtruara në paraqitjen e fakteve,<sup>416</sup> përfshirë ato tashmë të shtjelluara në Pikat 1-2 dhe 4-6,<sup>417</sup> vërtetojnë gjithashtu se midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre, përfshirë KLINAKUN dhe GASHIN, përdorën kërcënime të rënda për të nxitur ose për të tentuar të nxisnin dëshmitarët që të mos jepnin deklaratat, ose të jepnin deklaratat të rreme për ZPS-në dhe/ose DHS-në.

179. Në veçanti, të akuzuarit njoftuan se dokumentet që përmbanin emra, të dhëna personale dhe deklaratat të mëparshme të dëshmitarëve të ZPS-së ishin vënë në dispozicion të shtypit.<sup>418</sup> Ata përmendën emra dëshmitarësh konkretë dhe vendbanimet e tyre, bashkë me të dhëna të tjera personale,<sup>419</sup> dhe bënë të qartë se

---

<sup>414</sup> 081931-02-TR-ET Rishikuar, f.1; 081931-02, min.00:12:22-00:12:49.

<sup>415</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 3-6, 16-17; 081355-03, min.00:04:59-00:08:25, 00:27:52-00:28:49, 00:29:03-00:30:22; 081931-01-TR-ET, f. 2, 4-6; 081931-01, min. 00:01:31-00:04:33, 00:09:45-00:13:18.

<sup>416</sup> *Shih* Pjesa II.

<sup>417</sup> *Shih* Pjesa III A-B, D-F.

<sup>418</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-6; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30, 00:09:43-00:13:16; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 1-3, 5-7; 082136-01, min.00:03:15-00:10:28, 00:15:30-00:16:18. KLINAKU dhe GASHI konfirmuan se OVL-UÇK-ja u kishte dhënë dokumente mediave, 081931-02-TR-ET Rishikuar, f.1; 081931-02, min.00:12:22-00:12:49; 081931-01-TR-ET, f.2; 081931-01, min.00:01:31-00:04:33.

<sup>419</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 2-3; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30; 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 1-3; 081344-02, min.00:00:01-00:02:31; 081979-07-TR-ET, f.3; 081979-07, min.24:45-25:32; 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f. 1-2; 082106-06, min.00:00:19-00:03:50; 081979-08-TR-ET, f. 1, 3-4; 081979-08, min.00:00:13-00:01:49, 00:06:33-00:08:53; 081979-05-TR-ET, f. 2-3; 081979-05, min.00:02:10-00:06:38; 081979-05-TR-ET, f. 6-8; 081979-05, min.00:14:21-00:17:28; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 2-3; 082136-01, min.00:06:54-00:10:28; 081358-03-TR-ET Rishikuar, f.30; 081358-03, min.00:39:20-00:39:58.



KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

dokumentet që ata po publikonin përmbanin këtë informacion<sup>420</sup> dhe se njerëzit do të mësonin se kush ishin ata dëshmitarë.<sup>421</sup> Këtij kërcënimi i bëri jehonë edhe GASHI.<sup>422</sup>

180. Përmes deklarimeve të tyre publike se ata kishin njohur disa nga emrat që përmbanin dokumentet<sup>423</sup>, të akuzuarit synonin t'i bënin të qartë kujt do që bashkëpunonte me ZPS-në dhe që mund të njihej nga të akuzuarit se tani bashkëpunimi i tyre ishte diçka që dihej. Këto deklarime duhet të kuptohen në kuadrin e roleve të të akuzuarve si drejtues të OVL-UÇK-së, sepse në këtë cilësi ata pa dyshim njohin qindra ish-anëtarë të UÇK-së. Në fakt, HARADINAJ deklaroi se ai dhe të tjerët po bënin publike emrat, mbiemrat dhe vendbanime të mëparshme dhe të tashme të personave që kishin dhënë deklaratat "për me u ditë"<sup>424</sup>, dhe se qëllimi i nxjerrjes së dokumenteve gjatë herës së parë ishte që t'u bënte të qartë dëshmitarëve se askush nuk i mbronte veç i shfrytëzonte dhe shtoi se personat të cilët kishin dhënë informacion nuk janë mbrojtur, por janë vrarë, diskredituar ose turpëruar<sup>425</sup>

181. Të akuzuarit dhe të tjerët u përpoqën të mundësonin përhapjen më të madhe të mundshme të informacionit që ata publikuan dhe ushtruan trysni të vazhdueshme mbi median që të publikonte më tej këtë informacion.<sup>426</sup> Gjatë një paraqitjeje në një

<sup>420</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-6; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30, 00:09:43-00:13:16; 081358-01-TR-ET, f. 6-8; 081358-01, min.01:01:00-01:03:52; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 2-3; 082136-01, min.00:06:54-00:10:28.

<sup>421</sup> 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f. 26, 30-31; 081355-04, min. 00:50:33-00:51:07, 00:59:42-00:59:50; 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 3-4; 081344-01, min.00:06:31-00:09:09.

<sup>422</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 5, 8-9; 081355-03, min.00:09:48-00:10:22, 00:15:33-00:16:08; 081931-01-TR-ET, f.2; 081931-01, min.00:01:31-00:04:33.

<sup>423</sup> 081358-01-TR-ET, f. 9-10; 081358-01, min.01:05:00-01:06:42. Në një program tjetër televiziv, duke iu referuar dosjeve, HARADINAJ deklaroi: "Normal, qe atij që ja kam lexu emrin, e kam njoft, e kam njoft. Qe atij që s'jam kam lexu emrin prapë e kam njoft çka është. Ose ja kam njoft rajonin", 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f.11; 081355-04, min.00:38:39-00:38:51.

<sup>424</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 4-5; 081344-01, min.00:09:43-00:13:16.

<sup>425</sup> 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f.26; 081355-04, min.00:50:33-00:51:07.

<sup>426</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 5-6, 11-13; 082136-01, min.00:14:19-00:15:30, 00:23:40-00:25:41; 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 3, 10; 081991-01, min.00:04:44-00:05:37, 00:20:23-00:21:06; 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f.3; 082106-06, min.00:05:02-00:07:52; 081979-08-TR-ET, f.2; 081979-08, min.00:04:24-00:05:16; 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.8; 081347-01, min.00:17:26-00:17:40; SPOE00220800-00220800 (SPOE00220800-SPOE00220800-ET); *Shih gjithashtu* 081931-02-TR-ET Rishikuar, f.1; 081931-02, min.00:12:22-00:12:49.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

program televiziv më 17 shtator 2020, HARADINAJ i tha një gazetari nga gazeta “Infokus” [REDAKTUAR] se ai gazetar i kishte marrë dosjet, por nuk i kishte publikuar e nuk e kishte realizuar detyrën.<sup>427</sup> HARADINAJ i tha gjithashtu gazetarit se ai dhe të tjerët do ta paguanin për publikimin e dokumenteve dhe kur gazetari tha se kjo do të ishte shkelje ligjore për të cilën mund të shkoje në burg, HARADINAJ iu përgjigj me fjalët “po lenë mor ti shkeljen ligjore tonin. Ti don me më kallxue mue?”<sup>428</sup>

182. Gjatë paraqitjes si i ftuar në një program tjetër televiziv, HARADINAJ deklaroi se i kishte sfiduar mediat që të publikonin dosjet dhe se OVL-UÇK-ja nuk i kishte “publiku” sepse ishte organizatë joqeveritare dhe mendonte se mediat janë “fuqia e katërt” ose “forca e katërt”, me fjalë të tjera se OVL-UÇK-ja mendonte se media ishte më profesionale, më e guximshme, dhe kishte mbrojtje ligjore.<sup>429</sup>

183. Së fundmi, GUCATI dhe HARADINAJ bënë disa komente dhe akuza nënçmuese ndaj dëshmitarëve, në kuadër të të cilave GUCATI i quajti ata “shqipfolësa” ose “tradhtarë” që gënjejnë,<sup>430</sup> dhe HARADINAJ i përshkroi ata si “kriminelë, gjakpirës”<sup>431</sup> dhe spiunë që tradhtuan popullin e tyre.<sup>432</sup> GUCATI akuzoi dëshmitarët se kishin bashkëpunuar me qëllimin për të përfituar dokumentet e azilit.<sup>433</sup>

184. Me kryerjen e këtyre veprimeve GUCATI dhe HARADINAJT kishin objektiva të qarta. Ata vetë e pohuan se këto veprime i kishin ndërmarrë në kuadër të përpjekjeve të tyre për të penguar punën e DHS/ZPS-së.<sup>434</sup>

<sup>427</sup> 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f.6; 081355-02, min.00:27:21-00:27:53.

<sup>428</sup> 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f.15; 081355-02, min.00:35:33-00:35:48.

<sup>429</sup> 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f. 21-22; 081355-04, min.00:44:46-00:45:53; *Shih gjithashtu* 081358-03-TR-ET Rishikuar, f.4, 28, 31; 081358-03, min.00:05:55-00:07:34, 00:37:46-00:37:58, 00:40:19-00:40:41.

<sup>430</sup> 081358-01-TR-ET, f. 6-7, 12-13; 081358-01, min.01:01:00-01:02:33, 01:09:36-01:10:49.

<sup>431</sup> 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f.7; 081355-04, min.00:34:48-00:35:22.

<sup>432</sup> 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f.26; 081355-04, min.00:50:33-00:51:07.

<sup>433</sup> 081358-01-TR-ET, f. 10-12; 081358-01, min.01:06:42-01:09:36; *Shih gjithashtu* 089185-06-TR-ET, f.1; 089185-06 min.08:01-08:54.

<sup>434</sup> *Shih* Pjesa III A(i)(b).

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

185. Provat e përshkruara më lart<sup>435</sup> vërtetojnë se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm dhe dëshironin të nxisnin dëshmitarët që të mos jepnin deklaratë, apo të jepnin deklaratë të rreme, ose të mos i jepnin informacion të vërtetë ZPS-së dhe/ose DHS-së; si alternativë, të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se veprimet e tyre mund të shkaktonin këtë pasojë të ndaluar me ligj dhe ata u pajtuan me shkaktimin e kësaj pasaje të ndaluar. Synimet e KLINAKUT<sup>436</sup> dhe GASHIT<sup>437</sup> ishin të njëjta me ato të të akuzuarve.

D. Të akuzuarit kryen hakmarrje kundër dëshmitarëve (Pika 4)

186. Provat e parashtruara në paraqitjen e fakteve,<sup>438</sup> përfshirë ato tashmë të shtjelluara në Pikat 1-3 dhe 5-6,<sup>439</sup> vërtetojnë gjithashtu se midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre, përfshirë KLINAKUN dhe GASHIN, ndërmoren ose tentuan të ndërmorenin veprime të dëmshme ndaj dëshmitarëve, me synimin e hakmarrjes për dhënien ZPS-së të informacionit të besueshëm në lidhje me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprave penale.

187. Në veçanti, me qëllimin e deklaruar të pengimit të punës së DHS/ZPS-së,<sup>440</sup> gjatë tri konferencave për shtyp, mbi pesëmbëdhjetë paraqitjeve në media që kishin lidhje me dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë, të dytë dhe/ose të tretë, në të cilat morën pjesë të akuzuarit, KLINAKU dhe/ose GASHI, në disa raste të gjithë së bashku, dhe në postimet e nxjerra në mediat sociale, të akuzuarit bënë akuza dhe komente nënçmuese ndaj dëshmitarëve,<sup>441</sup> duke bërë të njohur në mënyrë të përsëritur identitetet, të dhënat personale dhe dëshmitë e tyre, duke njoftuar për këtë

---

<sup>435</sup> *Shih* Pjesa III A(i).

<sup>436</sup> 081931-02-TR-ET Rishikuar, f.1; 081931-02, min.00:12:22-00:12:49.

<sup>437</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 5, 8-9; 081355-03, min.00:09:48-00:10:22, 00:15:33-00:16:08.

<sup>438</sup> *Shih* Pjesa II.

<sup>439</sup> *Shih* Pjesa III A-C, E-F.

<sup>440</sup> *Shih* Pjesa III A(i)(b).

<sup>441</sup> 081358-01-TR-ET, f. 6-7, 12-13; 081358-01, min.01:01:00-01:02:33, 01:09:36-01:10:49; 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f. 7, 26; 081355-04, min.00:34:48-00:35:22, 00:50:33-00:51:07; 081358-01-TR-ET, f. 10-12; 081358-01, min.01:06:42-01:09:36; *Shih gjithashtu* 089185-06-TR-ET, f.1; 089185-06, min.08:01-08:54.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

shpërndarje<sup>442</sup> dhe duke inkurajuar vazhdimisht të tjerët që të përhapnin këtë informacion.<sup>443</sup>

188. Kur prezantuesi i një programi televiziv në të cilin GUCATI ishte i pranishëm, tha se mund të ndodhnin gjëra sepse dokumentet përmbanin emra, GUCATI, qartësisht i pashqetësuar nga pasojat e mundshme të veprimeve të tij, u përgjigj se mund të ndodhnin.<sup>444</sup>

189. Veprimet e të akuzuarve ishin faktikisht të dëmshme për dëshmitarët dhe shkelën të drejtat themelore të dëshmitarëve të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në Konventën Evropiane për Të Drejtat e Njeriut. Dëshmitarët u ndjenë të shqetësuar, të stresuar, të pasigurt, të kërcënuar dhe/ose të frikësuar pas veprimeve të të akuzuarve.<sup>445</sup>

---

<sup>442</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-3; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30; 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 1-2; 081344-02, min.00:00:01-00:02:31; 081979-07-TR-ET, f.3; 081979-07, min.24:45-25:32; 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f. 1-2; 082106-06, min.00:00:19-00:03:50; 081979-08-TR-ET, f. 1, 3-4; 081979-08, min.00:00:13-00:01:49, 00:06:33-00:08:53; 081979-05-TR-ET, f. 6-7; 081979-05, min.00:14:21-00:17:28; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 2-3; 082136-01, min.00:06:54-00:10:28; 081358-03-TR-ET Rishikuar, f.30; 081358-03, min.00:39:20-00:39:58; *Shih:* (i) SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220752 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, p.SPOE00220752), 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f.8, 081991-01, min.00:14:24-00:15:51; dhe (ii) SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220731 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220731), 081979-05-TR-ET, f. 2-3, 081979-05, min.00:02:10-00:06:38.

<sup>443</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 5-6, 11-13; 082136-01, min.00:14:19-00:15:30, 00:23:40-00:25:41; 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 3, 10; 081991-01, min.00:04:44-00:05:37, 00:20:23-00:21:06; 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f.3; 082106-06, min.00:05:02-00:07:52; 081979-08-TR-ET, p.2; 081979-08, min.00:04:24-00:05:16; 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.8; 081347-01, min.00:17:26-00:17:40; SPOE00220800-00220800 (SPOE00220800-SPOE00220800-ET); *Shih gjithashtu* 081931-02-TR-ET Rishikuar, f.1; 081931-02, min.00:12:22-00:12:49; 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f.15; 081355-02, min.00:35:33-00:35:48; 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f. 21-22; 081355-04, min.00:44:46-00:45:53; 081358-03-TR-ET Rishikuar, f. 4-5; 081358-03, min.00:05:55-00:07:34.

<sup>444</sup> 081358-01-TR-ET, f.8; 081358-01, min.01:03:52-01:05:00.

<sup>445</sup> 084008-084010, f. 084008-084009, para. 6; *Shih gjithashtu* 088301-088301 RED; 090025-090025 RED; 084249-084250 RED; 082102-082103 RED; 089940-089941 RED; 090177-090177 RED; 089946-089947 RED; 089938-089939 RED; 084247-084248 RED; 085880-085883 RED; 084236-084242 RED; 089936-089937 RED; 089953-089954 RED; 089955-089956 RED; 089988-089988 RED; 089991-089992 RED; 090004-090005 RED; 090006-090007 RED; 090052-090053 RED; 090175-090176 RED; 091216-091217 RED; 084303-084303 RED; 092911-092912 RED; 093383-093383 RED; 093386-093387 RED; 093388-093388 RED.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

190. Një nga dëshmitarët deklaroi se pasi mësoi për publikimin e informacionit konfidencial, e kapi paniku dhe u shqetësua për sigurinë e tij, [REDAKTUAR].<sup>446</sup> Një dëshmitar tjetër deklaroi se kishte frikë për sigurinë e tij dhe se ishte fshehur në shtëpinë e tij.<sup>447</sup> Një dëshmitar deklaroi se ishte shumë i frikësuar për faktin që OVL-UÇK-ja kishte publikuar dokumentet konfidenciale dhe se ishte i sigurt se kjo ishte bërë me qëllimin për të kërcënuar dëshmitarët.<sup>448</sup>

191. Një dëshmitar vuri në dukje se, për shkak të nxjerrjes publike të informacionit konfidencial, rrethi i njerëzve që potencialisht mund të dëmtonte familjen e tij ishte zgjeruar.<sup>449</sup> Një dëshmitar tjetër deklaroi se ishte informuar nga miq të tij se emri i tij ishte në dokumentet konfidenciale dhe se ai kishte marrë masa pa humbur kohë për rritjen e sigurisë së fëmijëve të tij.<sup>450</sup> Ky dëshmitar theksoi se kishte nisur të ndjente se njerëzit po e izolonin atë dhe familjen e tij dhe se dukej sikur nuk bënin ndonjë dallim midis dëshmitarëve dhe spiunëve, duke shtuar që mendonte se familja e tij ishte e rrezikuar.<sup>451</sup> Një dëshmitar tjetër deklaroi se duke qenë se emri i tij ishte në dokumentet konfidenciale, njerëzit kishin filluar ta shihnin atë dhe familjen e tij ndryshe [REDAKTUAR].<sup>452</sup>

192. Provat e përshkruara më lart<sup>453</sup> vërtetojnë se të akuzuarit ishin të vetëdijshëm dhe dëshironin të ndërmerren veprime të dëmshme ndaj dëshmitarëve me synimin e hakmarrjes për dhënien ZPS-së të informacionit të besueshëm në lidhje me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprave penale; si alternativë, të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se veprimet ose mosveprimet e tyre mund shkaktonin këtë pasojë të

---

<sup>446</sup> 084008-084010, f.084009, para. 7; 093386-093387 RED.

<sup>447</sup> 084008-084010, f.084009, para. 8; 089946-089947 RED.

<sup>448</sup> 084008-084010, f.084009, para. 9; 090177-090177 RED.

<sup>449</sup> 084008-084010, f.084009, para. 10; 089938-089939 RED.

<sup>450</sup> 084008-084010, f.084009, para. 11; 084247-084248 RED.

<sup>451</sup> 084008-084010, f.084009, para. 11; 084247-084248 RED.

<sup>452</sup> 084008-084010, f.084009, para. 12; 085880-085883 RED.

<sup>453</sup> *Shih* Pjesa III A(i).

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

ndaluar me ligj dhe ata u pajtuan me shkaktimin e kësaj pasoje të ndaluar. Synimet e KLINAKUT<sup>454</sup> dhe GASHIT<sup>455</sup> ishin të njëjta me ato të të akuzuarve.

*E. Përmes nxjerrjes së paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare, të akuzuarit shkelën fshehtësinë e procedurave ligjore (Pika 5)*

193. Provat e përshkruara në paraqitjen e fakteve,<sup>456</sup> përfshirë ato tashmë të shtjelluara në Pikat 1-4 dhe 6,<sup>457</sup> vërtetojnë gjithashtu se midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre, përfshirë KLINAKUN, pa autorizimin e ZPS-së, DHS-së, apo të ndonjë autoriteti tjetër kompetent,<sup>458</sup> zbuluan informacionin konfidencial, përshkrime të hollësishme të të cilit janë bërë më lart.<sup>459</sup>

194. Në veçanti, këto prova tregojnë se gjatë tri konferencave për shtyp, mbi pesëmbëdhjetë paraqitjeve në media në lidhje me dokumentet e nxjerra gjatë herës së

<sup>454</sup> 081931-02-TR-ET Rishikuar, f.1; 081931-02, min.00:12:22-00:12:49.

<sup>455</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 5, 8-9; 081355-03, min.00:09:48-00:10:22, 00:15:33-00:16:08.

<sup>456</sup> *Shih* Pjesa II.

<sup>457</sup> *Shih* Pjesa III A-D, F.

<sup>458</sup> Në këtë drejtim, konstatohet se: (i) ZPS-ja ka kompetencë për t'i dhënë "status të mbrojtur konfidencial" dokumentacionit apo informacionit (nenet 35(2)(f), 54(8), 61(4) dhe 62(2) të Ligjit); (ii) dokumentet, letrat, procesverbalet dhe arkivat, e ZPS-së, ndër të tjera, nuk janë dokumente publike të Kosovës dhe nuk ekziston një e drejtë e përgjithshme qasjeje në to, sipas nenit 62 të Ligjit, *shih gjithashtu* rregulla 106 e Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020, 2 qershor 2020 ("Rregullorja"; termi "rregulla" ose "rregullat" i referohen Rregullores, përveç nëse specifikohet ndryshe) në lidhje me dokumentet e brendshme; (iii) ZPS-ja ka kompetencë të marrë masat e nevojshme apo të kërkojë që të merren masat e nevojshme, për të siguruar konfidencialitetin e informacionit, mbrojtjen e çdo personi apo ruajtjen e provave (neni 23, 35(2)(f) i Ligjit; *Shih gjithashtu* rregulla 30 e Rregullores); (iv) ofruesit e informacionit, përfshirë, shtetet e treta dhe institucionet ndërkombëtare, mund të lidhin marrëveshje me ZPS-në, përfshirë në lidhje me konfidencialitetin dhe përdorimin e një informacioni të tillë (neni 4(2), 35(2)(d)-(e) i Ligjit; *Shih gjithashtu* neni 58 i Ligjit; rregulla 107 e Rregullores); (v) Gjykatësi i Vetëm kishte vendosur se dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë dhe herës së dytë përfshinin informacione të ndjeshme që normalisht nuk janë publike (091971-091980, f.091976, para.12; 092028-092038, f.092033, para.12; 092017-092027, f.092022, para.12; 091981-091991, ff.091986-091987, para.12); dhe (vi) paketa 2 përfshinte kopje të dokumenteve që ndërkohë ishin edhe në paketën 1 (084015-084026, ff.084018-084019, para. 22-26; 093492-093590, ff.093492-093493, para. 5-6, shtojcat 3-4), për të cilat, më 7 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm kishte lëshuar një urdhër konkret për mosnxjerrjen e tyre (091971-091980; 092028-092038). *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00074, para.36 (që përcakton se hetimet e ZPS-së cilësohen si "procedura zyrtare" sipas nenit 392(1) të KPK-së) dhe 37 (që jep përkufizimin e "informacionit të mbrojtur" sipas nenit 392(1) të KPK-së në kuadër të kornizës ligjore të DHS-së).

<sup>459</sup> *Shih* Pjesa II, para. 25-29, 49, 81, dhe Pjesa III A(i)(d).

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

parë, të dytë dhe/ose të tretë, në të cilat morën pjesë të akuzuarit, KLINAKU dhe/ose GASHI, në disa raste së bashku, dhe në postimet e nxjerra në mediat sociale, të akuzuarit publikuan në mënyrë të përsëritur informacion konfidencial dhe/ose bënë të njohur përmbajtjen e tij, duke përfshirë identitetin, të dhënat personale dhe dëshmitë e dëshmitarëve, para përfaqësuesve të shtypit, teleshikuesve dhe të tjerëve nga publiku.<sup>460</sup>

195. Fakti që të akuzuarit nuk ishin të autorizuar nga ZPS-ja, DHS-ja apo nga ndonjë autoritet tjetër kompetent, për të zbuluar informacionin që përmbanin dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë, të dytë dhe të tretë, dëshmohet qartë nga veprimi i menjëhershëm i ndërmarrë nga DHS-ja dhe ZPS-ja për të ndaluar përhapjen e mëtejshme të informacionit konfidencial.<sup>461</sup>

196. Provat e parashtruara më lart<sup>462</sup> vërtetojnë se të akuzuarit vepruan me vetëdije dhe dëshirë për nxjerrjen e paautorizuar të informacionit konfidencial, ose më së paku, ishin të vetëdijshëm se veprimet ose mosveprimet e tyre mund të shkaktonin këtë pasojë të ndaluar me ligj dhe se ata u pajtuan me shkaktimin e saj.

*F. Përmes nxjerrjes së paautorizuar të identiteteve dhe të të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, të akuzuarit shkelën fshehtësinë e procedurave (Pika 6)*

---

<sup>460</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-3; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30; 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 1-3; 081344-02, min.00:00:01-00:02:31; 081979-07-TR-ET, f.3; 081979-07, min.24:45-25:32; 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f. 1-2; 082106-06, min.00:00:19-00:03:50; 081979-08-TR-ET, f. 1, 3-4; 081979-08, min.00:00:13-00:01:49, 00:06:33-00:08:53; 081979-05-TR-ET, f. 6-7; 081979-05, min.00:14:21-00:17:28; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 2-3; 082136-01, min.00:03:15-00:10:28; 081358-03-TR-ET Rishikuar, f. 29-30; 081358-03, min.00:39:20-00:39:58; Pjesa II, para. 55, 59, 66; *Shih*: (i) SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220752 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220752), 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f.8, 081991-01, min.00:14:24-00:15:51; dhe (ii) SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220731 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220731), 081979-05-TR-ET, f. 2-3; 081979-05, min.00:02:10-00:06:38.

<sup>461</sup> *Shih* Pjesa II, para. 22-24, 47-48, 79-80.

<sup>462</sup> *Shih* Pjesa III A(i).

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

197. Provat e parashtruara në paraqitjen e fakteve,<sup>463</sup> përfshirë ato tashmë të shtjelluara më tej në Pikat 1-5,<sup>464</sup> vërtetojnë gjithashtu se midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, të akuzuarit dhe ndihmësit e tyre, përfshirë KLINAKUN, pa autorizim nga ZPS-ja, DHS-ja ose ndonjë autoritet tjetër kompetent, zbuluan ose tentuan të zbulonin identitetet dhe të dhënat personale të dëshmitarëve të mbrojtur në procedurat e DHS-së dhe në procedurat e mëparshme penale në Kosovë.

198. Identitetet dhe të dhënat personale të [REDAKTUAR] dëshmitarëve të përfshirë në paketat 1, 2 dhe 3 ishin të mbrojtura dhe të klasifikuara si konfidenciale nga ZPS-ja.<sup>465</sup> Dokumentet e paketave 1, 2 dhe 3 që përmbanin një informacion të tillë, ishin shënuar si konfidenciale, në to thuhej se ato kishin lidhje me hetime konfidenciale dhe se kishin të bënin me dëshmitarë, identitetet, të dhënat personale dhe dëshmitë e të cilëve ishin klasifikuar paraprakisht si konfidenciale dhe ishin trajtuar me konfidencialitet nga TFHS-ja/ZPS-ja.<sup>466</sup>

199. Urdhri i parë, ndër të tjera, njihte natyrën konfidenciale dhe jopublike të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë (dhe paketës 1) dhe ndalonte shpërndarjen e mëtejshme të përmbajtjes së atyre dokumenteve (dhe paketës 1), përfshirë të dhënat personale të dëshmitarëve që përmendeshin në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë (dhe në paketën 1).<sup>467</sup> Paketa 2 përfshinte kopjet e gjashtë faqeve, të cilat përmbajnë identitetet e dëshmitarëve që tashmë ishin pjesë e paketës 1<sup>468</sup> dhe për këtë arsye ishin objekt i urdhrin të parë.

200. Paketa 3 përfshin identitetet e dëshmitarëve [REDAKTUAR].<sup>469</sup>

---

<sup>463</sup> *Shih* Pjesa II.

<sup>464</sup> *Shih* Pjesa III A-E.

<sup>465</sup> 084015-084026.

<sup>466</sup> 084015-084026.

<sup>467</sup> 091971-091980; 092028-092038.

<sup>468</sup> 084015-084026, ff.084018-084019, para. 22-26; 093492-093590, ff.093492-093493, para. 5-6, shtojcat 3-4.

<sup>469</sup> 084015-084026, f.084020, para. 32; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-05/F00008/RED, KSC-BC-2020-05/F00043/A02, KSC-BC-2020-06/F00139/A02, KSC-BC-2020-06/F00005/RED.



KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

201. Paketa 3 përfshin përmendje të emrave, [REDAKTUAR] të dëshmitarëve, [REDAKTUAR].<sup>470</sup>

202. Paketa 3 gjithashtu përfshin përmendje të deklaratave të dëshmitarëve dhe dokumenteve e informacioneve të tjera të dhëna ZPS-së nga organizata ndërkombëtare dhe subjekte të tjera, me kusht që të mbaheshin konfidenciale dhe të përdreshin me kufizime.<sup>471</sup> Këto përfshijnë deklaratat e dëshmitarëve dhe dokumentet e dhëna ZPS-së, me kushtin që materialet të trajtoheshin si konfidenciale dhe të përdreshin vetëm për hetime dhe procedura gjyqësore.<sup>472</sup> Informacioni tjetër i përmendur është dhënë mbi bazë konfidenciale dhe vetëm për të siguruar prova të reja; çdo përdorim ose nxjerrje e atij informacioni për qëllime të tjera kërkon miratimin e dhënësit të tyre.<sup>473</sup>

203. Fakti që të akuzuarit nuk ishin të autorizuar nga ZPS-ja, DHS-ja apo nga ndonjë autoritet tjetër kompetent për nxjerrjen e informacionit që përmbanin dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë, të dytë dhe të tretë, duket qartë nga veprimi i menjëhershëm i DHS-së dhe ZPS-së për të ndaluar përhapjen e mëtejshme të informacionit konfidencial.<sup>474</sup>

204. Siç u përshkrua më lart,<sup>475</sup> nxjerrja e informacionit në fjalë shkaktoi pasoja të rënda për personat e mbrojtur, ose pengoi ndjeshëm procedimin penal.

205. Provat e parashtruara më lart,<sup>476</sup> vërtetojnë se të akuzuarit vepruan me vetëdije dhe dëshirë për nxjerrjen e paautorizuar të identitetit apo të dhënave personale të dëshmitarëve [REDAKTUAR], ose më së paku, ishin të vetëdijshëm se mund të ndodhte kjo pasojë e ndaluar me ligj dhe ata u pajtuan me shkaktimin e saj. Të njëjtat

---

<sup>470</sup> 084015-084026, f.084020, para. 33; SITF00372142-00372153.

<sup>471</sup> 084015-084026, f.084020, para. 34.

<sup>472</sup> 084015-084026, f.084020, para. 34.

<sup>473</sup> 084015-084026, f.084020, para. 34.

<sup>474</sup> *Shih* Pjesa II, para. 22-24, 47-48, 79-80.

<sup>475</sup> *Shih* Pjesa III D dhe poshtëshënimi.281.

<sup>476</sup> *Shih* Pjesa III A(i).

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

prova gjithashtu vërtetojnë se të akuzuarit duhet të kenë ditur ose kishin arsye të dinin se ata po zbulonin identitetin ose të dhënat personale të dëshmitarëve [REDAKTUAR].

#### **IV. Të akuzuarit mbajnë përgjegjësi penale individuale për veprimet e tyre**

##### A. Të akuzuarit i kryen veprat penale

206. Veprimet e përshkruara më lart<sup>477</sup> vërtetojnë se të akuzuarit, kryen me synimin e nevojshëm,<sup>478</sup> veprat penale të pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare me anë të kërcënimit të rëndë (Pika 1) dhe duke vepruar bashkërisht në një grup (Pika 2), frikësimit të dëshmitarëve gjatë procedurës penale (Pika 3), hakmarrjes (Pika 4), dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurave ligjore përmes nxjerrjes së paautorizuar të informacionit të mbrojtur (Pika 5) dhe përmes nxjerrjes së identiteteve dhe të të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur (Pika 6).

##### B. Të akuzuarit tentuan të kryenin veprat penale

207. Në qoftë se përfundimisht konstatohet se veprat penale të përshkruara në Pikat 1-4 dhe 6 nuk u përfunduan, ose se elementët e veprave që synojnë të kryeshin nuk u përmbushën, gjithsesi veprimet e përshkruara më lart<sup>479</sup>, vërtetojnë se të akuzuarit, ndërmoren veprime për kryerjen e këtyre veprave penale me synimin e nevojshëm<sup>480</sup>, dhe për rrjedhojë, tentuan t'i kryenin ato.

##### C. Të akuzuarit i kryen veprat penale bashkërisht

208. Veprimet e përshkruara më lart<sup>481</sup> vërtetojnë se të akuzuarit, duke pasur synimin e nevojshëm,<sup>482</sup> së bashkë dhe/ose me të tjerë, si KLINAKU, GASHI dhe anëtarë e

---

<sup>477</sup> *Shih* Pjesët II, III.

<sup>478</sup> *Shih* Pjesa III A(i).

<sup>479</sup> *Shih* Pjesët II, III A-D, F.

<sup>480</sup> *Shih* Pjesa III A(i).

<sup>481</sup> *Shih* Pjesët II, III A, C-F.

<sup>482</sup> *Shih* Pjesa III A(i).

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

përfaqësues të tjerë të OVL-UÇK-së, morën pjesë ose dhanë kontribut të konsiderueshëm në mënyra të tjera, në kryerjen e veprave penale të përshkruara në Pikat 1 dhe 3-6.

209. Fakti që ka pasur një marrëveshje të shprehur ose të nënkuptuar për të kryer vepër penale demonstrohet nga qëllimi i përbashkët i të akuzuarve, i KLINAKUT, GASHIT dhe të tjerëve, për të penguar punën e DHS/ZPS-së.<sup>483</sup> Marrëveshja e shprehur ose e nënkuptuar për të kryer vepër penale demonstrohet gjithashtu edhe nga natyra e bashkërenduar e veprimeve të të akuzuarve që vërtetohet, ndër të tjera, nga veprimet e mëposhtme, të cilat gjithashtu vërtetojnë që ata morën pjesë në kryerjen e veprave penale të përshkruara në Pikat 1 dhe 3-6, ose dhanë kontribut të konsiderueshëm në kryerjen e atyre veprave penale:

- i. këqyrja e informacionit konfidencial;<sup>484</sup>
- ii. vendimmarrja dhe/ose pjesëmarrja në vendime nëse dhe si të shpërndahej informacioni konfidencial;<sup>485</sup>
- iii. organizimi dhe pjesëmarrja në ngjarje, duke përfshirë konferencat për shtyp dhe paraqitjet publike, në të cilat u shpërnda dhe u diskutua publikisht informacioni konfidencial;<sup>486</sup>

<sup>483</sup> *Shih* Pjesa III A(i)(b).

<sup>484</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-3; 081344-01, min.00:00:01-00:06:30; 081979-11-TR-ET Rishikuar, f. 3-5; 081979-11, min.00:07:17-00:11:53; 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f.9; 081355-04, min.00:37:46-00:37:48; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 1-2; 082136-01, min.00:03:15-00:06:03; 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 3-5; 081355-03, min.00:04:59-00:08:25.

<sup>485</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-6, 8; 081344-01, min.00:00:01-00:09:09, 00:11:27-00:13:16, 00:16:02-00:16:11; 081358-01-TR-ET, f. 6-13; 081358-01, min.01:01:00-01:02:33, 01:03:52-01:06:42, 01:07:54-01:10:49; 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 5-6; 081991-01, min.00:07:42-00:08:04, 00:08:42-00:08:58, 00:10:15-00:11:29; 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 1-4; 081344-02, min.00:00:01-00:02:31, 00:02:40-00:09:49; 093457-093458 (093457-093458-ET); 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 1-2, 4; 082136-01, min.00:03:15-00:06:04, 00:12:02-00:12:10.

<sup>486</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-3; 081344-01, min.00:00:01-00:06:30; 082014-082016, f.082015, para. 9, 11; 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 1-4; 081344-02, min.00:00:01-00:09:49; 093457-093458 (093457-093458-ET); 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 1-3; 082136-01, min.00:03:15-00:10:28; 081358-01-TR-ET, f. 5-9; 081358-01, min.00:59:42-01:03:52; 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f.8; 081991-01, min.00:14:24-00:15:51; 081979-07-TR-ET, f. 2-3; 081979-07, min.09:30-11:01; 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f. 1-2; 082106-06, min.00:00:19-00:03:50; 081358-03-TR-ET Rishikuar, f. 29-30; 081358-03, min.00:39:20-00:39:58.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

- iv. shpërndarja e informacionit konfidencial;<sup>487</sup>
- v. zbulimi i identiteteve dhe të dhënave personale të dëshmitarëve, ndër të cilët dëshmitarët e mbrojtur;<sup>488</sup>
- vi. akuzat kundër dëshmitarëve dhe komentet nënçmuese në lidhje me dëshmitarët;<sup>489</sup>
- vii. inkurajimi dhe këshillimi i personave me qasje në informacionin konfidencial në lidhje procedurat e DHS-së që të vazhdonin t'i jepnin informacion të tillë OVL-UÇK-së, si dhe premtimet se do të vazhdonin të shpërndanin informacion të tillë konfidencial;<sup>490</sup> dhe/ose

---

<sup>487</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-3; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30; 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 1-3; 081344-02, min.00:00:01-00:02:31; 081979-07-TR-ET, f.3; 081979-07, min.09:30-11:01, 24:45-25:32; 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f. 1-2; 082106-06, min.00:00:19-00:03:50; 081979-08-TR-ET, f. 1, 3-4; 081979-08, min.00:00:13-00:01:49, 00:06:33-00:08:53; 081979-05-TR-ET, f. 6-7; 081979-05, min.00:14:21-00:17:28; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 2-3; 082136-01, min.00:06:54-00:10:28; 081358-03-TR-ET Rishikuar, f. 29-30; 081358-03, min.00:39:20-00:39:58; Pjesa II, para. 55, 59, 66; *Shih:* (i) SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220752 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220752), 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f.8, 081991-01, min.00:14:24-00:15:51; dhe (ii) SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220731 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220731), 081979-05-TR-ET, f. 2-3; 081979-05, min.00:02:10-00:06:38.

<sup>488</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 2-3; 081344-01, min.00:01:26-00:06:30; 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 1-3; 081344-02, min.00:00:01-00:02:31, 00:02:40-00:09:49; 081979-07-TR-ET, f.3; 081979-07, min.24:45-25:32; 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f. 1-2; 082106-06, min.00:00:19-00:03:50; 081979-08-TR-ET, f. 1, 3-4; 081979-08, min.00:00:13-00:01:49, 00:06:33-00:08:53; 081979-05-TR-ET, f. 6-7; 081979-05, min.00:14:21-00:17:28; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 2-3; 082136-01, min.00:06:54-00:10:28; 081358-03-TR-ET Rishikuar, f.30; 081358-03, min.00:39:20-00:39:58; Pjesa II, para. 55, 59, 66; *Shih:* (i) SPOE00220724-00220752, f. SPOE00220752 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220752), 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f.8, 081991-01, min.00:14:24-00:15:51; dhe (ii) SPOE00220724-00220752, f.SPOE00220731 (SPOE00220724-SPOE00220752-ET, f.SPOE00220731), 081979-05-TR-ET, f. 2-3; 081979-05, min.00:02:10-00:06:38.

<sup>489</sup> 081358-01-TR-ET, f. 6-7, 10-13; 081358-01, min.01:01:00-01:02:33, 01:06:42-01:10:49; 081355-04-TR-ET Rishikuar 2, f. 7, 26; 081355-04, min.00:34:48-00:35:22, 00:50:33-00:51:07.

<sup>490</sup> 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f.4; 081355-02, min.00:24:40-00:25:12; 081355-04-TR-ET Rishikuar 2, f. 3-4; 081355-04, min.00:32:59-00:33:30; 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 2-3, 7-8; 082136-01, min.00:06:54-00:10:28, 00:19:14-00:19:30; 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 7-8; 081991-01, min.00:13:54-00:15:51; 082106-07-TR-ET Rishikuar, f. 2-3; 082106-07, min.00:06:24-00:08:04, 00:10:49-00:10:55; 082106-01-TR-ET, f. 12-13; 082106-01, min.00:16:12-00:17:50; 082106-04-TR-ET Rishikuar, f.2; 082106-04, min.0:28:46-0:30:37; 081979-11-TR-ET Rishikuar, f. 3-5; 081979-11, min.00:06:03-00:06:55, 00:09:41-00:11:53; 081344-02-TR-ET Rishikuar, f. 2-4; 081344-02, min.00:02:40-00:09:49; 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.3; 081347-01, min.00:02:27-00:03:57.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

viii. inkurajimi, udhëzimi dhe këshillimi i përfaqësuesve të mediave dhe publikut që të merrnin dhe/ose incizonin informacion konfidencial dhe ta shpërndanin më tej.<sup>491</sup>

210. Pjesëmarrja dhe/ose kontributi i KLINAKUT në kryerjen e veprave penale, si dhe synimi i tij janë të njëjta me ato të të akuzuarve sepse midis 7 dhe 25 shtatorit 2020 ai:

(i) këqyri dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë përpara mbajtjes së konferencës së parë për shtyp;<sup>492</sup> (ii) përfaqësoi OVL-UÇK-në, ndër të tjera, në komunikimet me ZPS-në<sup>493</sup> dhe gjatë programeve televizive;<sup>494</sup> (iii) mori pjesë në shpërndarjen e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë mediave dhe/ose më së paku kishte dijeni për shpërndarjen e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë mediave dhe i inkurajoi mediat që t'i shpërndanin më tej dokumentet;<sup>495</sup> (iv) deklaroi publikisht se, për atë dhe të tjerë, DHS-ja ishte “inekzistente” dhe se ai dhe të tjerët nuk e kishin pranuar kurrë atë;<sup>496</sup> dhe (v) mori pjesë në organizimin së paku të konferencës së tretë për shtyp.<sup>497</sup>

211. Pjesëmarrja dhe/ose kontributi i GASHIT në kryerjen e veprave penale, si dhe synimi i tij, janë gjithashtu të njëjta me ato të të akuzuarve sepse midis 7 dhe 25 shtatorit 2020 ai: (i) këqyri dokumentet që ishin pjesë e një apo më shumë paketave me dokumente të nxjerra gjatë herës së parë, të dytë dhe të tretë dhe pranoi publikisht

<sup>491</sup> 082136-01-TR-ET Rishikuar, f. 5-6, 11-13; 082136-01, min.00:14:19-00:15:30, 00:23:40-00:25:41; 081991-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 3, 10; 081991-01, min.00:04:44-00:05:37, 00:20:23-00:21:06; 082106-06-TR-ET Rishikuar 2, f.3; 082106-06, min.00:05:02-00:07:52; 081979-08-TR-ET, f.2; 081979-08, min.00:04:24-00:05:16; 081347-01-TR-ET Rishikuar, f.8; 081347-01, min.00:17:26-00:17:40; SPOE00220800-00220800 (SPOE00220800-SPOE00220800-ET); 081355-02-TR-ET Rishikuar 1, f. 6, 15; 081355-02, min.00:27:21-00:27:53, 00:35:33-00:35:48; 081355-04-TR-ET-Rishikuar 2, f. 21-22; 081355-04, min.00:44:46-00:45:53.

<sup>492</sup> 081344-01-TR-ET Rishikuar 1, f. 1-3; 081344-01, min.00:00:01-00:06:30.

<sup>493</sup> 083988-083991 RED, f.083989, para. 7; 091927-091930, f.091928, para. 10; 081340-081340 (081340-081340-ET); *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00008, para. 4.

<sup>494</sup> 081931-02-TR-ET Rishikuar; 081931-02; 081981-02-TR-ET Rishikuar; 081981-02.

<sup>495</sup> 083988-083991 RED, f.083989, para. 7; 081931-02-TR-ET Rishikuar, f.1; 081931-02, min.00:12:22-00:12:49; 081981-02-TR-ET Rishikuar, f.6; 081981-02, min.00:10:04-00:10:07; *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07/F00008, para. 4.

<sup>496</sup> 081931-02-TR-ET Rishikuar, f.1; 081931-02, min.00:12:22-00:12:49; *Shih gjithashtu* 081981-02-TR-ET Rishikuar, f.7; 081981-02, min.00:10:57-00:11:04.

<sup>497</sup> 082014-082016, f.082015, para. 9.

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

natyrën e tyre të ndjeshme;<sup>498</sup> (ii) deklaroi publikisht se nxjerrja publike e informacionit konfidencial do të thoshte se gjykatësi duhet të mendojë edhe njëherë para se të vendosë për konfirmimin apo jo të aktakuzës ndaj Presidentit THAÇI dhe të tjerëve dhe se ai shpresonte që me ndihmën e rrjedhjeve të dokumentacionit të mos konfirmohej aktakuza kundër Presidentit THAÇI<sup>499</sup> dhe se dokumentet mund të përdroreshin për të sulmuar besueshmërinë e DHS-së;<sup>500</sup> (iii) kërcënoi dëshmitarët gjatë paraqitjeve televizive duke deklaruar se po vërtetohej teoria që nuk është mundshme të mbrohen dëshmitarët në Kosovë dhe pyeti nëse me të vërtetë po mbrohen në Hagë duke theksuar më tej se ai dhe të tjerë e dinin se dokumentet mund të përdroreshin për të shantazhuar dikë;<sup>501</sup> (iv) lavdëroi veprimin e personit të pidentifikuar i cili kishte sjellë dokumentet në selinë e OVL-UÇK-së;<sup>502</sup> dhe (v) përsëriti publikisht synimet e të akuzuarve dhe OVL-UÇK-së për të nxjerrë çdo informacion që u sillej, edhe për arsyen se ata ishin kundër DHS-së.<sup>503</sup>

*D. Të akuzuarit ranë në marrëveshje për kryerjen e veprave penale*

212. Veprimet e përshkruara më lart<sup>504</sup> vërtetojnë se të akuzuarit, duke pasur synimin e nevojshëm,<sup>505</sup> ranë në marrëveshje, bashkërisht dhe/ose me të tjerë, si KLINAKU, GASHI dhe përfaqësues të tjerë të OVL-UÇK-së, për kryerjen e veprave penale të shtjelluara në Pikat 1-6 dhe ndërmorën veprime të konsiderueshme për kryerjen e këtyre veprave penale.

213. Marrëveshja ndërmjet dy ose më shumë të akuzuarve, KLINAKUT, GASHIT dhe të tjerëve për kryerjen e veprave penale, si dhe marrëveshja që një ose më shumë

<sup>498</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 3-5; 081355-03, min.00:04:59-00:08:25; 081931-01-TR-ET, f.2; 081931-01, min.00:01:31-00:04:33.

<sup>499</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 16-17; 081355-03, min.00:27:52-00:28:49, 00:29:03-00:30:22; *Shih gjithashtu* 081931-01-TR-ET, f. 2-3; 081931-01, min.00:01:31-00:04:33, 00:04:42-00:06:21.

<sup>500</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 3-5; 081355-03, min.00:04:59-00:09:47.

<sup>501</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 5, 8-9; 081355-03, min.00:09:48-00:10:22, 00:15:33-00:16:08.

<sup>502</sup> 081355-03-TR-ET Rishikuar 1, f. 4-5; 081355-03, min.00:08:26-00:09:47.

<sup>503</sup> 081931-01-TR-ET, f. 2-5; 081931-01, min.00:01:31-00:06:21, 00:09:45-00:13:18.

<sup>504</sup> *Shih* Pjesët II, III.

<sup>505</sup> *Shih* Pjesa III A(i).

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

persona të tillë të ndërmerrnin veprime të konsiderueshme për kryerjen e veprave penale, dëshmohet më tej nga provat dhe faktorët e përshkruar që kanë lidhje me bashkëkryerjen.<sup>506</sup>

E. Të akuzuarit nxitën kryerjen e veprave penale

214. Veprimet e përshkruara më lart<sup>507</sup> vërtetojnë se të akuzuarit, duke pasur synimin e nevojshëm,<sup>508</sup>: (i) nxitën kryerjen e veprave penale të shtjelluara në Pikat 1-6, dhe këto vepra penale u kryen; (ii) nxitën tentimin e kryerjes së veprave penale të shtjelluara në Pikat 1-6; dhe/ose (iii) nxitën kryerjen e veprave penale të shtjelluara në Pikat 1-3 dhe 6 dhe këto vepra penale as nuk u kryen, e as nuk u tentua të kryheshin.

215. Në veçanti, të akuzuarit nxitën njëri-tjetrin dhe disa të tjerë, përfshirë KLINAKUN, GASHIN dhe anëtarë e përfaqësues të tjerë të OVL-UÇK-së, që të kryenin veprat penale të paraqitura në aktakuzë, ndër të tjera nëpërmjet njëres apo më shumë prej mënyrave të mëposhtme:<sup>509</sup>

- i. vendimmarrjes dhe/ose pjesëmarrjes në vendime nëse dhe si të shpërndahej informacioni konfidencial;
- ii. organizimit dhe pjesëmarrjes në ngjarje, duke përfshirë konferenca për shtyp dhe paraqitje publike, në të cilat informacioni konfidencial u shpërnda dhe u diskutua publikisht;
- iii. shpërndarjes së informacionit konfidencial;
- iv. zbulimit të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve, ndër të cilët edhe dëshmitarët e mbrojtur;
- v. akuzave kundër dëshmitarëve dhe komenteve nënçmuese në lidhje me dëshmitarët;
- vi. inkurajimit dhe këshillimit të personave me qasje në informacion konfidencial në lidhje me procedurat e DHS-së, që të vazhdonin t'i jepnin

<sup>506</sup> *Shih* Pjesa IV C.

<sup>507</sup> *Shih* Pjesët II, III.

<sup>508</sup> *Shih* Pjesa III A(i).

<sup>509</sup> Provat në lidhje me pikat (i)-(vii) janë parashtruar në Pjesën IV C, para. 209 (ii)-(viii).

KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

informacion të tillë OVL-UÇK-së, si dhe premtimeve se do të vazhdonin të shpërndanin informacion të tillë konfidencial; dhe/ose

- vii. inkurajimit, udhëzimit dhe këshillimit të përfaqësuesve të mediave dhe publikut që të merrnin dhe/ose incizonin informacionin konfidencial dhe ta shpërndanin më tej.

216. Gjithashtu, siç u përshkrua më lart, të akuzuarit nxitën përfaqësuesit e mediave dhe publikut që të kryenin veprat penale në fjalë, ndër të tjera nëpërmjet njëjës apo më shumë prej mënyrave të përshkruara në pikat (i)-(vii) më lart, veçanërisht përmes:

- i. inkurajimit dhe këshillimit të personave me qasje në informacion konfidencial në lidhje me procedurat e DHS-së, që të vazhdonin t'i jepnin informacion të tillë OVL-UÇK-së, si dhe premtimeve se do të vazhdonin të shpërndanin informacion të tillë konfidencial; dhe/ose
- ii. inkurajimit, udhëzimit dhe këshillimit të përfaqësuesve të mediave dhe publikut që të merrnin dhe/ose incizonin informacionin konfidencial dhe ta shpërndanin më tej.

*F. Të akuzuarit ndihmuan në kryerjen e veprave penale*

217. Veprimet e përshkruara më lart<sup>510</sup> vërtetojnë se të akuzuarit, duke pasur synimin e nevojshëm,<sup>511</sup> ndihmuan në kryerjen e veprave penale të shtjelluara në Pikat 1-6. Dhënia e ndihmës nga të akuzuarit, mori formën, ndër të tjera, të një ose më shumë prej veprimeve të përshkruara më lart në lidhje me bashkëkryerjen.<sup>512</sup>

**V. Përfundim**

218. Provat e parashtruara më lart tregojnë se brenda një periudhe prej 19 ditësh, gjatë tri konferencave për shtyp, paraqitjeve në mbi pesëmbëdhjetë programe televizive dhe përmes postimeve të shumta në mediat sociale, të akuzuarit dhe të tjerët zbatuan

<sup>510</sup> *Shih* Pjesët II, III.

<sup>511</sup> *Shih* Pjesa III A(i).

<sup>512</sup> *Shih* Pjesa IV C, para. 209 (i)-(viii).



KSC-BC-2020-07, *Prokurori i Specializuar kundër Hysni GUCATIT dhe Nasim HARADINAJT*  
Dosja paraprake sipas rregullës 95(4)(a)

një praktikë të njëjtë të veprimtarisë kriminale, e cila dëmtoi dëshmitarët dhe pengoi procedurat e DHS-së.

219. Të akuzuarit ndërmorën secilin prej veprimeve në një kohë kur ishin në dy postet më të larta të një organizate që kishte në përbërje të saj qindra, për të mos thënë mijëra ish-anëtarë të UÇK-së.

220. Të akuzuarit duhet të vihen para përgjegjesisë penale për krimet e rënda që ata kryen, provat për të cilat gjenden kryesisht dhe qartësisht në materialet e incizuara nga videokamerat. Këto dhe provat e tjera që do të paraqiten në gjykim, do të vërtetojnë përtej dyshimit të arsyeshëm përgjegjësinë e të akuzuarve në lidhje me akuzat për këto vepra penale.